



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Inxhinieri Biomjekësore”

ofruar nga

Universiteti "Western Balkans"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Dafina Xhako

Dr. Erinda Ndreçka

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: "Inxhinieri Biomjekësore"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Western Balkans"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: "Inxhinieri Biomjekësore"
4	Urdhëri/VKM i licensimit:	Urdhër MAS Nr. 422, datë 14.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze / shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022 – 2023 13 PAE / 5 PAK Viti akademik 2023 – 2024 12 PAE / 4 PAK Viti akademik 2024 – 2025 22 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022 – 2023 13 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 4 studentë; Viti akademik 2024 – 2025 8 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Western Balkans" (WBU), është institucion i arsimit të lartë, i krijuar me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 679, datë 10.11.2021 "Për hapjen e Institucionit të Arsimit të Lartë jo publik "Universiteti Western Balkans". Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" i cili po i nënshtrohet procesit të akreditimit ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), pranë këtij institucioni. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore", është licensuar sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 422, datë 14.07.2022, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore". Ky program studimi nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi. Gjithashtu është programi i vetëm në këtë lloj në Shqipëri.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar, në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe nga vizita në institucion, rezultojnë se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore", është program studimi i ciklit të parë, me formë studimi me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën angleze, në auditor dhe i përket nivelit të 6^{të} të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, gjithsej 180 kredite ECTS. Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" në thelbin e tij ka si objekt kryesor t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore që ofrojnë sektorët e ndryshëm që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e teknologjive të fundit të informacionit dhe komunikimit me aftësi profesionale të duhura në kontekstin e inxhinierisë biomjekësore. Ai përgatit studentë duke përdorur metodat më inovative në mësimdhënie si rrjedhim i thellimit të njohurive teorike me ato praktike dhe profesionale nëpërmjet strukturës bashkëkohore laboratorike dhe teknologjike që zotëron ky institucion.

Në përfundim të programit të studimit, inxhinieri biomjekësor i ardhshëm pajiset me njohuri mbi: aplikimin e metodave inxhinierike dhe mjeteve teknologjike në kujdesin shëndetësor, duke zhvilluar bazat e njohurive shkencore dhe teknike, integrimin e teknologjive në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor, zhvillimin e biomaterialeve të avancuara dhe përmirësimin e pajisjeve biomjekësore. Si rrjedhim, studentët e diplomuar në këtë program studimi janë profesionistë të aftë për të dhënë kontributin e tyre në industrinë e pajisjeve biomjekësore, laboratorët kërkimorë, si dhe institucionet që zhvillojnë teknologji inovative për përmirësimin e kujdesit shëndetësor. Përmes kësaj synohet t'u ofrohen studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës. Gjithashtu përgatitja e ofruar i lejon studentit të diplomuar në këtë program studimi vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master. Nga takimet në dekanat e departament, si edhe nga dokumentat e shqyrtuara, rezultojnë që ky program ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të industrisë në Shqipëri.

Infrastruktura dhe teknologjia e viteve të fundit e vënë në dispozicion për këtë program studimi, përfshirja e lektorëve të huaj me eksperiencë në këtë profil si dhe niveli i kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi është një garanci më shumë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 21.05.2024, Universiteti "Western Balkans" ka aplikuar pranë ASCAL për akreditimin për herë të parë të programit të studimit bachelor në: "Inxhinieri Biomjekësore" i cili ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. ASCAL bazuar në *"Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017"* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti "Western Balkans", për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. GVJ përbëhet nga: **Prof. Asoc. Dafina Xhako** dhe **Dr. Erinda Ndreçka**. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është MSc.Majlinda Demirneli.

Në datën 13.03.2025, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 24 dhe 25 Prill 2025 në ambjentet e Universitetit "Western Balkans". Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 06.05.2025.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brendshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm (DVB) e përbërë nga 151 dokumenta që shoqëronin këtë raport.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit bachelor "Inxhinieri Biomjekësore".

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVB, si dhe të informacionit të mbledhur dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Universiteti "Western Balkans" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 05.06.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/23 Prot, datë 05.06.2025. Universiteti "Western Balkans" njofton më datë 09.06.2025, nëpërmjet sistemit që nuk kanë komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti "Western Balkans" ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. Në <i>Nenin 2</i> të Statutit perfrazohet se Statuti i Universiteti "Western Balkans" mbështetet në Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", dhe vendimin nr. 679, datë 10.11.2021 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e Institucionit të arsimit të lartë jopublik, universiteti "Western Balkans". Universiteti "Western Balkans" organizohet dhe funksionon si një universitet jopublik me karakter akademik dhe shkencor, duke ofruar 21 programe studimi, nga të cilat 15 janë programe të ciklit të parë "Bachelor", përfshirë programin në "Inxhinieri Biomjekësore", 3 programe të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe 3 programe të integruara të nivelit të dytë. Në përputhje me prioritetet kombëtare dhe objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit të lartë, Universiteti "Western Balkans" angazhohet në promovimin, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, duke kontribuar gjithashtu në rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekësore" - Statuti i Universitetit Western Balkans - Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është konceptuar në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara në <i>Nenin 3</i> të Statutit të Universitetit "Western Balkans" dhe në <i>Nenet 4 dhe 14</i> të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ky program mbështet zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve duke

përqendruar vëmendjen në ndërtimin e një baze të fortë njohurish dhe kompetencash në një fushë të avancuar dhe strategjike si inxhinieria biomjekësore. Universiteti "Western Balkans" ka për qëllim të konsolidohet si një qendër ekselence në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e Shqipërisë, të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. Nëpërmjet ofrimit të programeve akademike të standardeve të larta, institucioni synon të edukojë dhe formojë profesionistët e së ardhmes në të gjitha fushat e mbuluara nga programet e tij studimore. Programi "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" synon të zhvillojë njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të studentëve në këtë disiplinë ndërdisiplinore, duke ofruar një kombinim të balancuar të teorisë me aplikimet praktike. Programi përgatit profesionistë të kualifikuar, të aftë për të kontribuar në:

- Projektimin dhe zhvillimin e teknologjive biomjekësore;
- Implementimin e pajisjeve dhe sistemeve të avancuara për diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të pacientëve;
- Zbatimin e inovacioneve teknologjike për përmirësimin e kujdesit shëndetësor;

Programi siguron një formim të thelluar në:

- Shkencat inxhinierike;
- Shkencat biologjike dhe mjekësore;
- Kimisë, fizikës dhe matematikës;
- Elektronikës dhe teknologjisë së informacionit;

Përmes kësaj strukture ndërdisiplinore, studentët pajisen me njohuri gjithëpërfshirëse dhe aftësi praktike të domosdoshme për të vepruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, në sektorin e teknologjisë biomjekësore dhe industrinë e kujdesit shëndetësor. Nëpërmjet programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Universiteti "Western Balkans" kontribuon drejtpërdrejt në përgatitjen e një gjenerate të re inxhinierësh biomjekësorë, të aftë për të avancuar teknologjinë dhe për të përmirësuar sistemet e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në rajon dhe në nivel ndërkombëtar. Studentët e këtij programi formohen si profesionistë të kompletuar, të përgatitur për të ofruar zgjidhje të reja për sfidat shëndetësore të shekullit XXI, duke kombinuar njohuritë teorike me eksperiencën praktike dhe inovacionin teknologjik.

Evidenca:

- Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore"
- Statuti i Universitetit Western Balkans
- Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit

	- <i>Struktura organizative e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, i ofruar nga Universiteti “Western Balkans” (WBU), është hartuar në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren Themelore të institucionit, si dhe me Planin Strategjik të Zhvillimit 2023–2030. Projekti akademik i programit është në harmoni me fushat prioritare dhe drejtimet strategjike të zhvillimit të Universitetit, duke u përqendruar në avancimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në fushën e inxhinierisë biomjekësore. Programi synon të formojë specialistë të aftë për të aplikuar parimet dhe teknikat e inxhinierisë në fushën biomjekësore, duke integruar njohuritë teorike me përvojën praktike. Përmes një qasjeje ndërdisiplinore dhe një kurrikule bashkëkohore, programi përgatit profesionistë të orientuar drejt inovacionit dhe zhvillimit teknologjik në sektorin e shëndetësisë. Kurrikula e programit është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë një ndërthurje efektive të njohurive bazë dhe të specializuara. Ajo përfshin: • Lëndë themelore: Biologji, Kimi, Fizikë dhe Matematikë të Aplikuar. • Module specifike profesionale: Biomekanikë, Bio-materiale, Instrumentacion Biomjekësor, dhe Teknologji të Avancuara në Shëndetësi. • Komponentë praktikë: Laboratorë të specializuar, praktikë profesionale në industrinë biomjekësore dhe institucione shëndetësore. Kjo strukturë garanton zhvillimin e një profili të plotë kompetencash, të cilat u mundësojnë studentëve të përballen me sfidat bashkëkohore në sistemet e kujdesit shëndetësor dhe në industrinë biomjekësore. Evidenca: - <i>Rregullorja e Programit të studimit “Bachelor ne Inxhinieri Biomjekësore”</i> - <i>Struktura organizative e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti “Western Balkans” zotëron përvojën, kapacitetet akademike dhe burimet infrastrukturore të nevojshme për ofrimin me cilësi të lartë të programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”. Institucioni ka ndërtuar një platformë të fuqishme akademike dhe kërkimore, e mbështetur në një filozofi zhvillimi që ndërthur teorinë me praktikën dhe inovacionin. Programi administrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Bioshkencave dhe Inxhinierisë, të cilat janë



strukturat përgjegjëse për ofrimin, zhvillimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi.

Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë:

- Përbëhet nga 8 staf akademik efektiv (PAE), nga të cilët 6 mbajnë grada shkencore / tituj akademikë.
- Ka një eksperiencë të gjerë në fushën e biomjekësisë dhe në fusha të ndërlidhura.
- Ka kontribuar në projekte kërkimore dhe zhvillimore me karakter ndërkombëtar.
- Është përgjegjës për programimin, organizimin, zhvillimin, koordinimin dhe administrimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore në kuadër të programeve që mbulon.

Universiteti "Western Balkans" disponon laboratorë të specializuar dhe të pajisur me teknologji të avancuar, duke përfshirë pajisje moderne për laboratorët mësimorë dhe kërkimorë, si dhe infrastrukturë mbështetëse si smart borde dhe ambiente të dedikuara për praktika dhe projekte shkencore. Në funksion të forcimit të formimit profesional të studentëve dhe të lidhjes së tyre me tregun e punës, Universiteti ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të njohura akademike, kërkimore dhe industriale, ndër të cilat përmenden:

- Grupi i Spitaleve Amerikane (American Hospital Group),
- International Hygea Hospital Sh.A.,
- Cambridge Clinical Laboratories.

Këta partnerë institucionalë luajnë një rol kyç në:

- Mundësimin e praktikave profesionale të studentëve,
- Pjesëmarrjen në laboratorë aplikativë dhe projekte kërkimore,
- Mbështetjen në realizimin e temave të diplomës dhe projekteve të përbashkëta.

Kurrikula e programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe reflekton tendencat dhe zhvillimet më të fundit në fushën e biomjekësisë dhe inxhinierisë biomjekësore. Nëpërmjet integritit të praktikave profesionale dhe moduleve të avancuara, WBU ofron mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, duke ndihmuar në rritjen e potencialit të tyre dhe duke i përgatitur ata për sfidat e tregut global të punës. Të gjitha elementet e sipërpërmendura dëshmojnë angazhimin e Universitetit "Western Balkans" për të ofruar një program studimi të qëndrueshëm, inovativ dhe me cilësi të lartë në fushën e inxhinierisë biomjekësore, duke kontribuar në formimin e profesionistëve të



	rinj dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit të kujdesit shëndetësor. Evidenca: - Lista e personelit akademik që angazhohet për realizimin e programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore" (Tabelat përmbledhëse, Tabelat 1 dhe 2) - Lista e laboratorëve të WBU - Plan shpërndarja e smart boards nëpër klasa - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital S.H.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital S.H.A - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Cambridge Clinical Laboratories - Kurrikula e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit bachelor "Inxhinieri Biomjekësore" është në përputhje me fushën akademike të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit. Programi i studimit përmban lëndë të cilat mundësojnë formimin e specialistëve në fushën e biomjekësisë dhe inxhinierisë biomjekësore. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Përmbajtja dhe struktura e programeve ndjekin udhëzimet dhe direktivat kombëtare dhe evropiane për klasifikimin dhe kodifikimin e fushave të studimit, duke siguruar kështu një harmonizim të plotë me standardet e Arsimit të Lartë Evropian (European Higher Education Area – EHEA). Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është ndërtuar mbi bazën e një analize të kujdesshme të: • Nevojave dhe kërkesave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar, • Zhvillimeve më të fundit teknologjike dhe shkencore, • Prioriteteve të kërkimit dhe inovacionit në fushën biomjekësore, • Kuadrit arsimor dhe direktivave të Bashkimit Evropian. Kjo qasje garanton që programi të mos jetë vetëm në përputhje me kërkesat akademike kombëtare, por të reflektojë gjithashtu tendencat më të avancuara në inovacion dhe teknologji. Nëpërmjet harmonizimit të kurrikulës dhe orientimit drejt standardeve të Bashkimit Evropian, programi "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" kontribuon në forcimin e pjesëmarrjes

	së Universitetit “Western Balkans” në rrjetet e kërkimit dhe zhvillimit shkencor brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kjo i ofron studentëve mundësi të gjera për integrim akademik dhe profesional në një kontekst ndërkombëtar dhe i përgatit ata për të qenë pjesë aktive e zhvillimeve globale në fushën e inxhinierisë biomjekësore. Evidenca: - Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, Neni 15 - Klasifikimi dhe kodifikimi i Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Universiteti “Western Balkans” ofron programe studimi që respektojnë interesat kombëtare dhe kontribuojnë në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programet e studimit hartohen dhe implementohen në përputhje me misionin dhe qëllimet strategjike të institucionit. Institucioni demonstroi në mënyrë të qartë përvojën e nevojshme, kapacitetet organizative dhe burimet njerëzore e infrastrukturore për të ofruar me cilësi programe studimi në fushat akademike specifike përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit,	Çdo njësi akademike dhe administrative merr përsipër përgjegjësitë e saj në bazë të rolit funksional dhe fushës së ekspertizës, duke kontribuar në mënyrë të harmonizuar në procesin e mbarëvajtjes së programeve të studimit. Ky model organizimi siguron një funksionim të integruar dhe një cilësi të qëndrueshme të procesit mësimor dhe kërkimor. Universiteti “Western Balkans” ka vendosur një sistem të institucionalizuar për analizën dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës së njësive akademike dhe administrative. Ky sistem përfshin: • Vlerësimin periodik të funksionimit të njësive;

marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	• Analizimin e të dhënave mbi ecurinë akademike dhe kërkimore; • Identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim; • Zbatimin e masave korrigjuese dhe përmirësuese; Përmes kësaj qasjeje, sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një përmirësim i vazhdueshëm i programit të studimit, duke ruajtur standardet e larta akademike dhe kërkimore. Proceset e rregullta të vlerësimit të brendshëm dhe analiza e vazhdueshme e punës së njësive ndihmojnë në: • Rritjen e efikasitetit institucional, • Konsolidimin e një kulture të hapur të komunikimit dhe reflektimit, • Promovimin e një mjedisi akademik inovativ dhe gjithëpërfshirës. Këto mekanizma kontribuojnë në menaxhimin efektiv të programit dhe sigurojnë që ai të përmbushë nevojat dinamike të studentëve dhe të tregut të punës, duke garantuar një përvojë mësimore cilësore dhe të orientuar drejt zhvillimeve bashkëkohore. Evidenca: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 11-12, 26, 27, 51, 52, 55, 56 - Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit - Rregullorja mbi organizimin akademik të Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans"
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në funksion të realizimit të objektivave të veta strategjike në procesin mësimor dhe formues, Universiteti "Western Balkans" ka ndërtuar një rrjet të gjerë marrëdhëniesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të rëndësishëm të sektorit të biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto marrëveshje bashkëpunimin dihojnë në pasurimin e përvojës akademike dhe praktike të studentëve. Ato ofrojnë mundësi për shkëmbime akademike dhe profesionale. Lehtësojnë zhvillimin e projekteve kërkimore të përbashkëta dhe organizimin e trajnimeve profesionale. Në strategjinë e zhvillimit institucional 2023–2030, Universiteti "Western Balkans" ka përcaktuar qartë prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit, të cilat përfshijnë: • Forcimin e lidhjeve me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, • Rritjen e bashkëpunimeve me institucione kërkimore prestigjioze,




	• Krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me sektorin privat dhe me organizatat e industrisë. Këto prioritete zbatohen përmes marrëveshjeve konkrete bashkëpunimi, duke ofruar platforma për shkëmbim njohurish, zhvillim projektsh kërkimore dhe nxitje të ndërkombëtarizimit të universitetit. Në tre vitet e fundit, falë këtyre bashkëpunimeve të strukturuar, Universiteti “Western Balkans” ka realizuar dhe organizuar një sërë aktiviteteve kërkimore-shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. WBU ka qenë njëkohësisht organizator kryesor dhe partner në projekte të shumta kërkimore, duke përfshirë aplikime të suksesshme për projekte të financuara nga fondet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në kuadër të përpjekjeve për të ndërlidhur arsimin me tregun e punës dhe inovacionin, WBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione prestigjioze si: • Shoqëria American Hospital SH.A, • International Hygea Hospital SH.A, • Cambridge Clinical Laboratories, ndër të tjera. Këto partneritete: • Lehtësojnë identifikimin dhe kuptimin e nevojave të tregut të punës, • Ofron mundësi për praktika profesionale të studentëve, • Mbështesin zhvillimin e projekteve kërkimore dhe temave të diplomës, • Fuqizojnë angazhimin e studentëve në proceset e inovacionit dhe në zgjidhjen e problemeve praktike në sektorin e shëndetësisë dhe teknologjisë biomjekësore. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve strategjike, Universiteti “Western Balkans” synon të garantojë një edukim cilësor, të lidhur ngushtë me realitetin e tregut të punës, duke përgatitur studentët për karriera të suksesshme në fushën e inxhinierisë biomjekësore dhe më gjerë Evidenca: - <i>Plani Strategjik 2023-2025</i> - <i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të WBU</i> - <i>Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe Shoqërinë International Hygea Hospital SH.A</i> - <i>Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Cambridge Clinical Laboratories</i>
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute	Programi “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) Departamenti:

kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	• Koordinon aktivitetet akademike dhe kërkimore të lidhura me programin, • Siguron cilësinë e proceseve mësimore dhe të praktikave profesionale, • Mbështet zhvillimin individual dhe profesional të studentëve. Praktikat profesionale organizohen dhe mbikëqyren nga: • Personeli përgjegjës nga Universiteti “Western Balkans”, • Një mbikëqyrës i dedikuar në institucionin partner ku zhvillohet praktika, • Një përfaqësues akademik nga WBU që monitoron dhe vlerëson progresin e studentëve. Në përfundim të praktikës, përpilohet dokumentacioni përkatës vlerësues, duke garantuar që çdo student të përfitojë udhëzim të personalizuar dhe mbështetje profesionale gjatë gjithë periudhës së praktikës. Studentët e programit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” angazhohen në projekte kërkimore shkencore dhe në realizimin e temave të diplomës, nën mbikëqyrjen e stafit akademik të Departamentit. WBU, në kuadër të bashkëpunimeve të tij kombëtare dhe ndërkombëtare, ofron mundësi për: • Pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në aktivitete kërkimore-shkencore, • Trajnime dhe kualifikime të vazhduara, • Leksione të hapura dhe seminare profesionale, të organizuara sipas një kalendari të miratuar institucionalisht. Në zbatim të Programit “EPIC” (Education – Practice Integrated Curriculum) (https://ëëë.edu.al/sq/epic), WBU u ofron studentëve mundësinë për të kryer praktika dhe internship-e të paguara pranë institucioneve partnere. Ky program: • Përforon lidhjen midis arsimit teorik dhe përvojës praktike, • Siguron një tranzicion të suksesshëm nga auditorët universitarë në tregun real të punës, • Mundëson zhvillimin e kompetencave praktike që kërkohen nga industria biomjekësore dhe teknologjia e shëndetësisë. Universiteti “Western Balkans” synon të jetë një universitet i gjeneratës së katërt, ku përveç formimit akademik cilësor dhe kërkimit shkencor të avancuar, angazhohet aktivisht në: • Përdorimin e njohurive të fituara për zhvillim ekonomik dhe inovacion, • Kontributin në përmirësimin e jetës shoqërore dhe ekonomike të vendit dhe rajonit,
---	---

	- Krijimin e lidhjeve të forta midis arsimit të lartë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Evidenca: - Marreveshja me NanoAlb - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 11-12, 26, 27, 51, 52, 55, 56 - Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit - Manuali i praktikës profesionale për programin "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Përfshirja e studentëve të programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" në projekte kërkimore diplome - Kalendari i veprimtarive dhe trajnimeve vjetore ekstrakurrikulare të realizuara me studentët gjatë periudhës 2023-2024
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (ish-Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit), si njësi bazë akademike dhe përgjegjëse për administrimin e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", ushtron funksione të vazhdueshme të monitorimit dhe vlerësimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit që mbështesin programin. Në mënyrë periodike, Departamenti harton raporte analitike, në të cilat analizohen: - Përfitimet e realizuara nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet institucionale, - Ndikimi i këtyre bashkëpunimeve në cilësinë e procesit mësimor dhe praktikave profesionale, - Kontributi i marrëveshjeve në përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional. Këto raporte përbëjnë një komponent të rëndësishëm të analizës vjetore të punës së Departamentit dhe Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI). Procesi i monitorimit dhe vlerësimit synon: - Identifikimin e mundësive për përmirësim të bashkëpunimeve ekzistuese, - Përcaktimin e prioritetëve për zgjerimin dhe thellimin e partneriteteve të reja, - Sigurimin që programi i studimit të mbetet i harmonizuar me standardet më të larta akademike dhe kërkesat aktuale të tregut të punës, - Mbështetjen e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë në të gjitha aspektet e programit. Evidenca: - Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit (Me emërtimin e ri Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë) për vitin akademik 2023-2024

	- Raporti i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Biznesit (FETI) vitin akademik 2023-2024			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Universiteti "Western Balkans" ka krijuar mekanizma efektivë për hartimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e programeve të studimit, përfshirë edhe programin "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore". Institucioni ka siguruar një bashkëpunim të frytshëm të brendshëm. Në funksion të mbështetjes së realizimit të programit të studimit dhe pasurimit të përvojës akademike dhe praktike të studentëve, WBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Trans-	Struktura e programeve të studimit të ofruara në Universitetin "Western Balkans" bazohet në përbërësit thelbësorë akademikë, të cilët përfshijnë: • Sistemin e krediteve, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), • Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit të njohurive, • Objektivat formues dhe kompetencat profesionale që synohen të fitohen, • Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit, • Kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë çdo program,



ferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

- Planin mësimor, kuotat e pranimiit dhe ndarjen në grupe mësimore,
- Programet lëndore (syllabuset), profilin akademik të programit,
- Diplomën dhe suplementin e diplomës.

Këto elementë janë të përcaktuara në përputhje me dispozitat e Rregullores “Për programet e studimit të ciklit të dytë”, konkretisht në Nenin 14. Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” është ndërtuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), siç përcaktohet në Nenin 11 të Rregullores për programet e studimit.

Karakteristikat kryesore të programit janë:

- Vlerësim total: 180 kredite ECTS;
- Kohëzgjatja: 3 vite akademike (6 semestra), me 32 javë për vit (përfshirë javët e provimeve);
- Komponentët e veprimtarive formuese: Kurse teorike, laboratorë praktikë, kërkime shkencore dhe aktivitete të tjera të lidhura me fushën e inxhinierisë biomjekësore;

Organizimi i përmbajtjes dhe veprimtarive është projektuar për të mundësuar transferimin dhe njohjen ndërkombëtare të krediteve, duke mbështetur mobilitetin akademik të studentëve.

Plani mësimor i programit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” përfshin:

Kategoria e Veprimtarisë Formuese	Numri i Lëndëve/Moduleve	Kredite ECTS	% e Totalit të Krediteve
A. Lëndë bazë	6	34	19%
B. Lëndë karakterizuese	17	90	50%
C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese	5	25	14%
D. Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	5	24	13%
E. Detyrime përmbyllëse (tezë diplome)	1	7	4%

Në total, programi përbëhet nga 34 lëndë/module, duke përfshirë praktikën profesionale dhe tezën e diplomës. Programi është konceptuar për të formuar studentë me kompetenca të avancuara në fushën e inxhinierisë biomjekësore, përmes:

- Kuptimit kritik të teorive dhe teknologjive të avancuara në biomjekësi,

	• Zhvillimit të aftësive praktike për projektimin dhe krijimin e pajisjeve biomjekësore, • Aftësimin për zhvillimin e biomaterialeve dhe sistemeve të diagnostikimit dhe rehabilitimit. Nëpërmjet një formimi ndërdisiplinor, studentët përgatiten të adresojnë sfida të ndërlikuara në fushat e teknologjisë së shëndetësisë dhe kërkimit biomjekësor. Programi promovon: • Pjesëmarrjen aktive të studentëve në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, • Lidhjen e ngushtë mes teorisë dhe praktikës përmes përdorimit të laboratorëve të avancuar dhe praktika profesionale, • Nxitjen e aftësive analitike, inovative dhe kërkimore, • Integrimin e studentëve në bashkëpunime ndërinstitucionale dhe partneritete me industrinë biomjekësore. Këto elementë kontribuojnë në përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për të punuar në sektorët akademikë, kërkimorë dhe industrialë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca: - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 10
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorisë dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e	Rregullorja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përcakton qartë strukturën organizative të programit, objektivat e tij formues si dhe kompetencat që studentët pritet të fitojnë gjatë dhe në përfundim të studimeve. Programi është projektuar për të ofruar një formim akademik dhe profesional cilësor, të harmonizuar me zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjive biomjekësore dhe disiplinave të ndërlidhura. Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" synon: • Të pajisë studentët me aftësi të specializuara për të ushtruar një gamë të gjerë profesionistësh dhe specializimesh në sektorin biomjekësor; • Të ofrojë një arsimim cilësor dhe inovativ, duke ndërtuar një kuptim kritik mbi teoritë, parimet dhe teknologjitë e avancuara të kësaj fushe; • Të përgatisë studentët për të përballuar sfidat teknologjike dhe shëndetësore të së ardhmes nëpërmjet një qasjeje ndërdisiplinore;

problemeve komplekse dhe të paparashi-kueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Fushat e theksuara të formimit përfshijnë pajisjet biomjekësore, biomaterialet, bioinstrumentacionin dhe teknologjitë inteligjente të kujdesit shëndetësor. Nëpërmjet ndjekjes së këtij programi, studentët zhvillojnë: • Aftësi të avancuara në projektimin dhe krijimin e pajisjeve biomjekësore, • Kompetenca në zhvillimin e materialeve inovative për aplikime në mjekësi dhe industrinë biomjekësore, • Aftësi për dizajnimin dhe zhvillimin e sistemeve të avancuara për diagnostikim dhe rehabilitim, • Aftësi analitike dhe problem-zgjidhëse për të adresuar sfida komplekse në fushën e kujdesit shëndetësor. Programi i inkurajon studentët të angazhohen në zhvillimin e ideve inovative dhe në zbatimin praktik të tyre përmes projekteve kërkimore dhe aplikative. Një komponent i rëndësishëm i programit është promovimi i kërkimit shkencor dhe zhvillimit të teknologjive të reja. Studentët inkurajohen: • Të marrin pjesë në projekte kërkimore nën mbikëqyrjen e stafit akademik, • Të bashkëpunojnë me institucione akademike dhe industriale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, • Të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe të përfshihen në transferimin e njohurive dhe teknologjive. Për të garantuar përgatitjen e plotë të studentëve: • Zhvillohen praktika profesionale në laboratorë të avancuar, • Theksohet ndërlidhja mes njohurive teorike dhe eksperiencës praktike, • Promovohet angazhimi në projekte ndërdisiplinore. Kjo qasje forcon aftësitë analitike, kreative dhe inovative të studentëve, duke formuar specialistë të kualifikuar për të kontribuar në mjediset akademike, kërkimore dhe industriale në sektorin biomjekësor. Evidenca: - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë	Në përputhje me përcaktimet e parashtruara në kriterin 1 të këtij standardi, plani mësimor i programit të studimit "Bachelor" në

formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

“Inxhinieri Biomjekësore” është i organizuar në bazë të kategorive të veprimtarive formuese (A–E), si më poshtë:

Kategoria e Veprimtarisë Formuese	Përshkrimi	Numri i Lëndëve/Moduleve	Kredite ECTS	Përqindja ndaj totalit të krediteve
A. Lëndë bazë	Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	6	34	19%
B. Lëndë karakterizuese	Përgatitje për disiplinën shkencore specifike	17	90	50%
C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese	Nëndisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje	5	25	14%
D. Lëndë plotësuese	Praktika profesionale	5	24	13%
E. Detyrime përmbyllëse	Tezë diplome	1	7	4%

- *Lëndët bazë (A):* Ofrimi i njohurive të përgjithshme dhe zhvillimi i aftësive metodologjike, duke përgatitur studentët për një kuptim të gjerë të fushës shkencore.
- *Lëndët karakterizuese (B):* Fokusi kryesor në përgatitjen profesionale dhe shkencore specifike për inxhinierinë biomjekësore.
- *Lëndët ndërdisiplinore/integruese (C):* Thellimi i njohurive në fushat ndihmëse dhe orientimi drejt specializimeve të zgjedhura.
- *Lëndët plotësuese (D):* Praktikat profesionale që përforcojnë lidhjen midis teorisë dhe praktikës.
- *Detyrimet përmbyllëse (E):* Finalizimi i studimeve me përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së diplomës.

Kjo strukturë garanton një balancim të mirëfilltë midis njohurive teorike, aftësive praktike dhe kompetencave të avancuara, duke përgatitur studentët për një integrim të suksesshëm në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, si dhe për angazhim në fushën kërkimore dhe inovative. Programi i studimit përbëhet nga

	gjithsej 34 lëndë/module, përfshirë praktikën mësimore dhe përgatitjen e tezës së diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programit akademik. Evidenca: - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar planit mësimor të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si një komponent integral i formimit akademik të studentëve. Praktika profesionale: • Vlerësohet me notë, njësoj si lëndët e tjera akademike të programit, • Përbën një element thelbësor në lidhjen e njohurive teorike me përvojën praktike në fushën e inxhinierisë biomjekësore, • Realizohet në bashkëpunim me institucione dhe kompani partnere të fushës përkatëse. Kjo veprimtari mbështet zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve dhe përgatitjen e tyre për sfidat e tregut të punës. Në kuadër të detyrimeve përmbyllëse të programit, është parashikuar realizimi i Temës së Diplomës, e cila është e integruar në planin mësimor si një komponent akademik i detyrueshëm. Specifikat e Temës së Diplomës janë: • Kodi i lëndës: BME 350, • Ngarkesa akademike: 15 orë seminare dhe 160 orë punë individuale, • Ngarkesa në kredite: 0.5 kredite të brendshme dhe 7 ECTS. • Tema e diplomës zhvillohet në semestrin e gjashtë, në përputhje me temat e përcaktuara dhe të miratuara në fillim të semestrit akademik. Çdo temë diplome realizohet nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë dhe supervizorëve akademikë të caktuar përkatësisht për secilin student. Temat e diplomave si dhe anëtarët dhe kryetarët e komisioneve të mbrojtjes së diplomave propozohen nga njësia bazë akademike (Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë) dhe miratohen zyrtarisht nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI). Ky proces siguron integritetin akademik dhe garanton standardet e cilësisë në përgatitjen dhe mbrojtjen e temave të diplomës, si përfundim i ciklit të parë të studimeve universitare.



	Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" ne "Inxhinieri Biomjekesore", Neni 10 - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Kreu 13 cikli i parë "Bachelor" në "Bioteknologji" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" ne "Inxhinieri Biomjekesore" - Kurrikula e Programit të studimit cikli i parë "Bachelor" ne "Inxhinieri Biomjekesore" - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - Statuti i Universitetit "Western Balkans", Neni 26, pikat p dhe q, Neni 52, pika e dhe n - Manual për punimin e tezës së diplomës
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	WBU nuk është IAL me status të veçantë.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" është i hartuar nga lëndë të cilat përmbajnë njohuri të nevojshme dhe të përditësuara për kompletimin e njohurive në fushën e inxhinierisë Biomjekësore. Ky program studimi: • Është organizuar dhe realizuar në tërësi nga Universiteti "Western Balkans"; • Nuk ofrohet nga asnjë institucion tjetër i arsimit të lartë (IAL) në vend, as në të njëjtën fushë studimi, dhe as në të njëjtën emërtësë; • Përfaqëson një ofertë unike akademike në fushën e inxhinierisë biomjekësore brenda sistemit të arsimit të lartë shqiptar; Kjo e bën programin një mundësi të veçantë dhe të pakrahueshme në kontekstin kombëtar. Ka përputhshmeri deri në 70 % me programe të ngjashme në Itali, Gjermani etj.
	Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans"

	- Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përfaqëson një degë studimi ndërdisiplinore, e cila kombinon njohuritë nga inxhinieria, teknologjia, biologjia dhe shkencat mjekësore. Programi ofrohet në nivelin e ciklit të parë të studimeve universitare dhe i përket kategorisë Bachelor (63BA), me një ngarkesë totale prej 180 kredite ECTS për të tri vitet akademike të studimit. Programi klasifikohet sipas standardeve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe përdor sistemin e kodifikimit si më poshtë: • Kodi 07: I përcaktuar për programe studimi të lidhura me fushat e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimit. • Shkronja A: Tregon që programi ofrohet në gjuhën angleze, duke garantuar qasje ndërkombëtare dhe lehtësi për mobilitet akademik. • Kodi 88: Identifikon programin si pjesë të fushës së inxhinierisë biomjekësore, duke sanksionuar statusin e tij si një program që ofron arsimim dhe kualifikim profesional. Kodi i plotë i programit të studimit është 63BA0788A. Kjo strukturë kodi reflekton: • Ciklin e studimit (Bachelor), • Fushën kryesore akademike (Inxhinieri), • Nënfishën e specializuar (Inxhinieri Biomjekësore), • Gjuhën e ofrimit të programit (Anglisht). Kodi dhe karakteristikat e programit janë të konfirmuara në dokumentin zyrtar të Universitetit "Western Balkans" të dërguar më 24.03.2023, me Nr. 1/1, i cili paraqet detajet e klasifikimit dhe përputhshmërisë me udhëzimet dhe aktet nënligjore në fuqi. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Klasifikimi dhe kodifikimi i Programit të studimit cikli i parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është organizuar dhe realizohet në mënyrë të pavarur nga Universiteti "Western Balkans", në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Ky program: • Ofron një formim të plotë akademik dhe profesional sipas standardeve kombëtare dhe evropiane;

	- Nuk realizohet në formën e një programi të përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë, qoftë vendas apo ndërkombëtar; - Është zhvilluar dhe implementuar ekskluzivisht nga Universiteti "Western Balkans", duke garantuar një autonomi të plotë akademike dhe organizative në menaxhimin e tij; Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programet e studimit në Universitetin "Western Balkans" janë të organizuara në mënyrë të strukturuar në lëndë dhe module akademike. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë dhe janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar në fuqi për arsimin e lartë. Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përfaqëson një ofertë akademike unike në Shqipëri, duke qenë i vetmi program i këtij lloji i ofruar aktualisht në vend. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, të përcaktuar sipas: Fushës së studimit, Sistemit të klasifikimeve zyrtare të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në Shqipëri. Ky klasifikim garanton përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe lehtëson njohjen akademike dhe profesionale të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike,	Njësia kryesore / bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë" ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI),

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

stafet akademike vlerësim dhe akreditimin.

përbëhet nga:

1. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë;
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës;
3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
4. Qendra Kërkimore- Shkencore SMTI;

Njësia kryesore / bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin në mënyrë të plotë të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke garantuar:

- Strukturimin akademik të programit në përputhje me normat dhe standardet e Ministrisë së Arsimit,
- Përzgjedhjen dhe menaxhimin e stafit akademik,
- Zbatimin e proceseve të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të studentëve,
- Zhvillimin e procedurave për akreditimin e programit të studimit.

Në Fakultetin e Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit në vitin akademik 2024 – 2025, janë angazhuar gjithsej 47 staf akademik, nga ku 31 janë staf akademik efektiv (PAE dhe 16 staf akademikme kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	2
Prof.Asoc	3	2
Dr/PhD	17	7
Msc	9	5
Gjithsej	31	16

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	1
Prof. Asoc.	1	1	1	2	-	1



	Dr./PhD.	2	3	4	2	5	4
	Msc.	6	2	4	-	2	2
	Totali	9	6	9	4	8	8
	Evidenca: - <i>Struktura organizative e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</i> - <i>Lista e personelit akademik që angazhohet për realizimin e programit të studimit "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore" (Tabelat përmbledhëse, Tabelat 1 dhe 2)</i>						
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Përveç angazhimit të personelit akademik të kualifikuar, Fakulteti dhe Departamenti kanë përfshirë në mënyrë aktive: • Personel ndihmës akademik; • Personel administrative; me qëllim mbështetjen e suksesshme të realizimit të objektivave akademike dhe praktike të programit. Në funksion të përmbushjes së objektivave të programit, janë angazhuar: • Asistentë lektorë dhe personel ndihmës akademik, të cilët mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin e mësimdhënies, zhvillimin e praktikave laboratorike dhe klinike, si dhe realizimin e projekteve praktike; • Personel ndihmës administrativ, i cili siguron mbështetje logjistike, teknike dhe organizative për funksionimin e rregullt të veprimtarive akademike dhe kërkimore; Ky personel garanton mbarëvajtjen e të gjitha aspekteve të nevojshme për zhvillimin e mësimave teorike dhe praktike, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të studentëve në eksperimente, kërkime shkencore dhe praktika profesionale. Personeli ndihmës-akademik me karakter akademik është integruar si pjesë e njësisë bazë dhe ka funksione të drejtpërdrejta në: • Mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, • Realizimin e praktikave laboratorike dhe eksperimentale. Në këtë kategori përfshihen: • Asistentë mësimorë dhe kërkimorë, • Laborantë, • Teknikë laboratorikë dhe teknikë të specializuar, • Si dhe personel tjetër mbështetës, në përputhje me rregulloret e brendshme të institucionit. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ përfshin strukturat e specializuara të Universitetit "Western Balkans", të angazhuara në:						

	• Menaxhimin e kurrikulave dhe projekteve kërkimore, • Promovimin akademik dhe publikimet shkencore, • Marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, • Sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe mbështetjen e karrierës së studentëve, • Shërbimet e bibliotekës dhe teknologjisë së informacionit, • Burimet njerëzore, shërbimet ligjore, arkiv-protokollin dhe asistencën e rektoratit. Ky personel siguron funksionalitetin efektiv të infrastrukturës akademike dhe administrative, duke kontribuar në cilësinë e përgjithshme të programit dhe duke ndihmuar në përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit. Evidenca: - Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik/administrativ i angazhuar për realizimin e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 10, Nenet 78-79 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 4, Neni 30-35
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Departamentin e Bioshkencave dhe Inxhinierisë si njësia bazë përgjegjëse, ka caktuar një koordinator akademik të dedikuar për programin e studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore". Koordinatori akademik: • Është pjesë e personelit akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë, • Është përgjegjës për ecurinë, zhvillimin dhe monitorimin e programit të studimit dhe të praktikave profesionale, në përputhje me objektivat akademike dhe standardet e përcaktuara. Koordinatori akademik ka përgjegjësi të gjera, që përfshijnë: • Koordinimin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës akademike, • Monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të objektivave të programit, • Planifikimin dhe mbikëqyrjen e performancës së programit në përputhje me standardet institucionale, • Ndërveprimin me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm për të ndërtuar dhe mbështetur zhvillimin dhe përmirësimin e programit. Ky rol kërkon ekspertizë të avancuar akademike dhe aftësi të forta menaxheriale për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e



	përgjithshëm të programit. Përveç rolit të koordinatorit, Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë ka caktuar: Një këshilltar akademik për çdo grup studentësh, i cili është anëtar i stafit akademik me kohë të plotë. Ky model organizimi dhe koordinimi siguron një mbështetje të plotë akademike dhe administrative për studentët dhe përforcon efektivitetin dhe cilësinë e programit të studimit në "Inxhinieri Biomjekësore". Evidenca: - Vendimi i Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë për përcaktimin e koordinatorit dhe këshilltarit akademik të programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 60 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"			
Konkluzione	GVJ nga vizita në institucion dhe shyrtyri i dosjes së vetëvlerësimit konkludoi se: Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet baze të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, si edhe angazhon personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. GVJ sugjeron ti jepet perparesi dhe motivim kualifikimit të stafit që të ketë në anetaresinë e tij me teper staf me statusin profesor/professor i asociuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, si njësi përgjegjëse për administrimin dhe zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me: • Organizimin e programit, • Strukturën akademike, • Përmbajtjen dhe zhvillimin e tij. Të gjitha informacionet janë të dokumentuara dhe të qasshme për palët e interesuara, duke garantuar transparencë dhe standarde të larta në administrimin akademik. Organizimi, struktura

	dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me: • Legjislacionin kombëtar në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, • Dispozitat e përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, konkretisht në Nenin 4, • Përmbajtjen dhe kriteret e specifikuar në Kurrikulën e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, • Udhëzimet dhe normat e përcaktuara në Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”. Ky harmonizim i plotë me kuadrin ligjor siguron cilësinë akademike dhe respektimin e standardeve të kërkuara për akreditimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të programit. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, Neni 4 - Kurrikula e Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor (kurrikula) i programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” përmban të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me: • Ndarjen e lëndëve dhe moduleve sipas semestreve akademike, • Ngarkesën mësimore të çdo lënde/moduli, • Numrin e orëve të zhvilluara në auditor dhe jashtë auditorit. Plani mësimor është i organizuar në një strukturë trevjeçare: • 3 vite akademike, • 6 semestra, • Çdo vit përbëhet nga 32 javë akademike, përfshirë javët e provimeve, • Çdo javë parashikon të paktën 20 orë leksione, seminare dhe laboratorë të zhvilluara në auditor. Programi është i organizuar në bazë të sistemit të krediteve, në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Parimet themelore të këtij organizimi janë: • 1 kredi i korrespondon 25 orëve të punës së studentit (përfshirë orët në auditor dhe punën individuale),



	• Ngarkesa vjetore për një student me kohë të plotë është 60 kredite ECTS, që përfaqëson rreth 1500 orë pune në vit. Në total, programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” përbëhet nga 180 kredite ECTS. Lista e disipinave dhe veprimtarive të tjera formuese të programit është ndarë sipas llojit të orëve dhe krediteve të përcaktuara: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Shkurtesa</th><th>Përshkrimi</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>L</td><td>Orë Teorike Leksioni</td></tr> <tr> <td>S</td><td>Orë Teorike Seminari</td></tr> <tr> <td>Lab</td><td>Orë Praktike Laboratorike</td></tr> <tr> <td>P</td><td>Orë Praktike</td></tr> <tr> <td>K</td><td>Kredite sipas sistemit amerikan</td></tr> <tr> <td>ECTS</td><td>Kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve</td></tr> </tbody> </table> Organizimi, struktura dhe ngarkesa akademike e programit janë ndërtuar në përputhje me: • Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” (nenet 4, 5, 10, 11), • Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” (nenet 4 dhe 9), • Kurrikulën zyrtare të Programit, e publikuar në faqen zyrtare të universitetit: <u>Kurrikula e Programit “Bachelor” në Inxhinieri Biomjekësore</u> Ky përputhshmëri garanton integritetin akademik dhe siguron respektimin e standardeve të përcaktuara për ofrimin dhe administrimin e programeve të ciklit të parë. Evidenca: - Kurrikula e Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Rregullorja e Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, Neni 3 dhe Neni 4 - Kurrikula e Programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”	Shkurtesa	Përshkrimi	L	Orë Teorike Leksioni	S	Orë Teorike Seminari	Lab	Orë Praktike Laboratorike	P	Orë Praktike	K	Kredite sipas sistemit amerikan	ECTS	Kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve
Shkurtesa	Përshkrimi														
L	Orë Teorike Leksioni														
S	Orë Teorike Seminari														
Lab	Orë Praktike Laboratorike														
P	Orë Praktike														
K	Kredite sipas sistemit amerikan														
ECTS	Kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve														
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme dhe të detajuara për studentët, duke përfshirë: • Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,														

kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	• Proceset dhe kriteret e transferimit të krediteve akademike, • Procedurat për ekuivalentimin dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme akademike. Të gjitha informacionet janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe transparente, duke i mundësuar studentëve të kuptojnë në mënyrë të plotë kërkesat dhe procedurat për pranimin, vijimin ose përfundimin e studimeve të tyre në këtë program. Programi parashikon: • Kualifikimet minimale të nevojshme për pranimin në studime, sipas standardeve kombëtare dhe evropiane, • Procedurat e transferimit të krediteve, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), • Proceset e ekuivalentimit të diplomave dhe krediteve për studentët që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Kjo qasje siguron një rrugë të qartë, të drejtë dhe të standardizuar për të gjithë studentët që synojnë të hyjnë ose të vazhdojnë studimet në programin e inxhinierisë biomjekësore. Kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në aktet e brendshme rregullatore të Universitetit “Western Balkans”, konkretisht në: • Rregulloren Themelore të WBU (nenet 54–71), • Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” (nenet 4, 5, 9, 12, 13), • Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” (nenet 6–10). Këto rregullore përcaktojnë në mënyrë të hollësishme: • Kriteret e pranimi dhe regjistrimit të studentëve, • Rregullat për regjistrimin e lëndëve dhe menaxhimin e ngarkesës akademike, • Procedurat e transferimit të studimeve dhe njohjen e krediteve ECTS, • Kohëzgjatjen e studimeve dhe strukturën e aktiviteteve mësimore, • Gjuhën e mësimdhënies dhe elementët përbërës të programit akademik Ky sistem rregullator garanton respektimin e standardeve të cilësisë, përputhjen me kuadrin ligjor kombëtar dhe evropian, si dhe sigurimin e transparencës dhe barazisë në trajtimin e të gjithë studentëve.
--	--

	Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 54-71 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore", Nenet 9-10
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" ofron të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë të përfshirë në kurrikulë. Syllabuset janë hartuar në përputhje me: • Formatet e miratuara institucionale, • Kërkesat e legjislacionit në fuqi (VKM nr. 41, i ndryshuar). Ky dokumentacion garanton transparencë dhe standardizim të informacionit të ofruar për çdo komponent formues të programit. Çdo syllabus përmban në mënyrë të strukturuar informacionin e mëposhtëm: • Emërtimi i lëndës dhe kodi përkatës, • Lektori përgjegjës dhe asistenti (nëse është i angazhuar), • Gjuha e mësimdhënies, • Komponentët e mësimdhënies dhe shpërndarja e tyre në orë fizike javore dhe semestrale, • Numri i krediteve ECTS për secilin komponent, • Përshkrimi i lëndës, • Objektivat mësimore dhe kompetencat e synuara për t'u zhvilluar, • Fjalët kyçe dhe njohuritë paraprake të nevojshme, • Planifikimi i tematikave javore, i shoqëruar me literaturën përkatëse (të detyrueshme dhe të rekomanduara), • Frekuentimi i kërkuar, detyrimet e studentit dhe metodat e vlerësimit, • Komponentët e vlerësimit, përfshirë peshën përkatëse në pikë dhe përqindje (%), • Sistemi i notimit, sipas: Praktikat profesionale, seminarin dhe laboratorët përbëjnë komponentë thelbësorë të procesit formues në këtë program studimi. Këto aktivitete: • Ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive praktike, • Mundësojnë një kuptim të thelluar dhe aplikativ të teorisë të inxhinierisë biomjekësore, • Plotësojnë kurrikulën akademike me eksperiencë konkrete laboratorike dhe praktike. Struktura e detajuar e syllabuseve siguron që:

	• Studentët të kenë një kuptim të plotë të përmbajtjes së secilit modul, • Pritshmëritë akademike dhe praktike të jenë të qarta që në fillim të çdo lënde, • Studentët të përgatiten në mënyrë efektive për të përmbushur kërkesat akademike dhe profesionale gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ky organizim rrit cilësinë e procesit mësimor dhe përgatitjen profesionale të studentëve në fushën e inxhinierisë biomjekësore. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore" - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Universiteti "Western Balkans" (WBU) ka institucionalizuar një procedurë të rregullt për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, me fokus në formimin profesional të studentëve për tregun kombëtar, rajonal dhe global të punës. Në këtë kuadër, përmbajtja akademike e programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" i nënshtrohet rishikimeve dhe përditësimeve të vazhdueshme, me qëllim ruajtjen e përputhjes me zhvillimet më të fundit shkencore, teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik: • Miratohen ndryshimet eventuale në përmbajtjen e programit, • Dosja e plotë e programit arkivohet në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. Vlerësimi i programit realizohet përmes një procesi të strukturuar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, të monitoruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Proces i vlerësimit përfshin: • Analizën vjetore të departamentit dhe të programeve të ofruara, ku shqyrtohen aktivitetet akademike dhe kërkimore-shkencore të vitit akademik të mëparshëm, • Vlerësimet e studentëve për lëndët e ndjekura gjatë vitit akademik, • Vlerësimet e studentëve në prag diplomimi, për të marrë feedback mbi përmbushjen e objektivave të programit,

	- Vlerësimin periodik të të diplomuarve (Alumni), të realizuar jo më shpesh se një herë në tre vite, mbi përgatitjen dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës, Të gjitha të dhënat dhe vlerësimet e mbledhura: - Diskutohen në mbledhjet e hapura të stafit akademik të departamentit dhe fakultetit, - Përdoren për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe për të hartuar propozime konkrete për përditësimin e programit. Pas miratimit, versioni i përditësuar i dosjes së programit arkivohet në shqip dhe në anglisht, duke garantuar ruajtjen e integritetit dhe transparencës së dokumentacionit akademik. Ky sistem i strukturuar për vlerësim, përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm garanton përputhshmërinë e programit të studimit me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe siguron përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe të zhvillimit teknologjik. Evidenca: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Vizita ne Institucion			
Konkluzione	GVJ konkludon se: FETI dhe DBI disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Përmbajtja e tij është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Emërtimi,
përmbajtja e veprimtarive,
shpërndarja e lëndëve dhe
praktikave, mundësojnë,
thellim të njohurive dhe
aftësive për studime të
mëtejshme dhe/ose punësi-
min e studentëve.

Programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”,
përmes emërtimit, përmbajtjes së veprimtarive akademike dhe
shpërndarjes së balancuar të lëndëve teorike dhe praktike,
mundëson:

- Thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale,
- Përgatitjen e studentëve për vijimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e dytë,
- Përshtatjen dhe integrimin e tyre të suksesshëm në tregun e punës, në sektorin publik dhe privat, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Programi është ndërtuar në bazë të një strukture të qartë të ndarjes së lëndëve dhe praktikave, duke respektuar standardet akademike bashkëkohore. Programi përmban një shpërndarje të mirëstrukturuar të krediteve dhe komponentëve formues, si më poshtë:

Kategoria e Vepri- mtarisë	Përmbajtja	Kredite ECTS	Përqindja ndaj to- talit të krediteve
A. Lëndë bazë	Përgatitje metod- ologjike dhe kul- turë e përgjithshme	34 ECTS	19%
B. Lëndë karakteri- zuese	Formim specifik për disiplinën shkencore	90 ECTS	50%
C. Lëndë ndër- isiplinore/in- tegruese	Formim nëndisipli- nar dhe lëndë me zgjedhje	25 ECTS	14%
D. Lëndë plotësuese	Formim praktik dhe profesional (praktika)	24 ECTS	13%
E. Detyrime përm- byllëse	Përgatitja dhe mbrojtja e diplo- mës	7 ECTS	4%

Në total, programi përmban 180 kredite ECTS, të realizuara gjatë tre viteve akademike (gjithsej gjashtë semestra). Mësimdhënia në këtë program zhvillohet në gjuhën angleze, duke siguruar një përgatitje akademike konkurruese në tregun ndërkombëtar. Më shumë informacion mund të gjendet në faqen zyrtare të programit. Të diplomuarit e këtij programi kanë

	mundësi të vazhdojnë studimet në nivel Master në fusha të tilla si: ○ Inxhinieri Biomjekësore, ○ Bioteknologji, ○ Nanoteknologji, ○ Shkencat e Materialeve, ○ Disiplina të tjera të afërta, Përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara për integrim të suksesshëm në tregjet e punës kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi është konceptuar për të qenë i përputhshëm me shumë programe ndërkombëtare të ngjashme, duke mundësuar: Transferimin e krediteve, vijimin e studimeve në institucione kërkimore dhe universitete jashtë vendit, Integrimin në projekte kërkimore ndërkombëtare. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 10 - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Sipas Planit mësimor mënyra e shpërndarjes së lëndëve dhe moduleve, siguron që secili komponent akademik të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në: - Arritjen e objektivave formues të programit; - Përmbushjen e rezultateve të pritshme të të nxënit; - Nxitjen dhe zhvillimin e aftësive kërkimore-shkencore të studentëve; Kjo qasje ka synuar të sigurojë një balancë optimale midis njohurive teorike, aftësive praktike dhe kapaciteteve kërkimore. Plani mësimor është ndërtuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për arsimin e lartë dhe ka këto karakteristika: • Ngarkesë totale: 180 kredite ECTS, • Kohëzgjatja: 3 vite akademike, • Organizimi: 6 semestra, • Çdo vit akademik përbëhet nga 32 javë, duke përfshirë edhe javët e provimeve. Çdo lëndë/modul zhvillohet përmes kombinimit të formave të ndryshme të aktivitetit akademik: • L – Leksione, • S – Seminare, • Lb – Laboratorë praktikë, • P – Praktikë profesionale, • I – Punë individuale e studentit. Puna individuale zë një rol të veçantë në procesin e formimit akademik të studentëve, duke kontribuar ndjeshëm në:

	• Thellimin e njohurive të fituara gjatë leksioneve dhe praktikave, • Përvetësimin e metodave të kërkimit shkencor, • Arritjen e rezultateve të synuara të të nxëniet në mënyrë të pavarur dhe kritik. Ky model organizimi i planit mësimor siguron një zhvillim të balancuar akademik, duke përgatitur studentët jo vetëm për tregun e punës, por edhe për sfida të mëtejshme akademike dhe kërkimore. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 4, Neni 5, Neni 7 - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"								
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura akademike e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" është ndërtuar në përputhje të plotë me: • Profilin e përcaktuar të programit, • Standardet e legjislacionit kombëtar për arsimin e lartë, • Praktikën më të mira të ndjekura nga programe të ngjashme ndërkombëtare në këtë fushë. Ky program përfaqëson iniciativën e parë të këtij lloji në Shqipëri, duke ofruar një qasje të integruar ndërdisiplinore dhe duke garantuar përgatitjen e studentëve për sfidat akademike dhe profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në ndërtimin e planit mësimor, është mbajtur një balancë e kujdesshme ndërmjet: • Komponentit teorik (leksione dhe seminare), • Komponentit praktik (laboratorë dhe praktikë profesionale), • Punës individuale të pavarur të studentit. Struktura e ngarkesës akademike në çdo semestër favorizon në mënyrë të theksuar punën praktike dhe individuale, duke synuar thellimin e njohurive të përftuara në auditor dhe aplikimin e tyre në mënyrë të pavarur. Për ilustrim, në Vitin e Parë, Semestrin e Parë, ngarkesa akademike shpërndahet si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Aktiviteti Akademik</th><th>Numri i Orëve</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td><td>195 orë</td></tr> <tr> <td>Seminare</td><td>90 orë</td></tr> <tr> <td>Laboratorë</td><td>45 orë</td></tr> </tbody> </table>	Aktiviteti Akademik	Numri i Orëve	Leksione	195 orë	Seminare	90 orë	Laboratorë	45 orë
Aktiviteti Akademik	Numri i Orëve								
Leksione	195 orë								
Seminare	90 orë								
Laboratorë	45 orë								

	<table><tr><td>Punë individuale</td><td>420 orë</td></tr></table> Ky raport ndërmjet teorisë dhe praktikës ruhet gjatë gjithë periudhës trevjeçare të studimeve, duke garantuar një përgatitje të plotë dhe të balancuar për studentët. Ky organizim siguron që të diplomuarit të jenë të aftë të aplikojnë në mënyrë efektive njohuritë teorike në situata praktike reale dhe të jenë të përgatitur për sfidat akademike të mëtejshme ose për integrimin e drejtpërdrejtë në tregun e punës. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 4, Neni 5, Neni 7	Punë individuale	420 orë																		
Punë individuale	420 orë																				
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Bazuar në analizën e sylabuseve të lëndëve, planit mësimor dhe ndarjes së lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese, vlerësohet se struktura dhe organizimi aktual i programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore": • Mbështet në mënyrë të plotë arritjen e objektivave formues të parashikuara në program, • Favorizon transferimin e studimeve dhe mobilitetin akademik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, • Siguron përgatitjen profesionale të nevojshme për integrimin e të diplomuarve në tregun e punës. Ky organizim reflekton standardet më të mira të arsimit të lartë dhe është në linjë me kërkesat e kuadrit kombëtar dhe evropian të kualifikimeve. Ndarja e veprimtarive formuese në këtë program është realizuar si më poshtë: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Përshkrimi</th><th>Nr i Lëndëve/Moduleve</th><th>ECTS</th><th>% ndaj totalit të krediteve</th></tr><tr><td>A. Lëndë bazë</td><td>Përgatitje metodologjike dhe kulturre e përgjithshme</td><td>6 lëndë/module (5 ose 6 kredite secila)</td><td>34 ECTS</td><td>19%</td></tr><tr><td>B. Lëndë karakterizuese</td><td>Përgatitje për disiplinën shkencore</td><td>17 lëndë/module</td><td>90 ECTS</td><td>50%</td></tr><tr><td>C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese</td><td>Njohuri nga nëndisiplina, profile dhe</td><td>5 lëndë/module</td><td>25 ECTS</td><td>14%</td></tr></table>	Kategoria	Përshkrimi	Nr i Lëndëve/Moduleve	ECTS	% ndaj totalit të krediteve	A. Lëndë bazë	Përgatitje metodologjike dhe kulturre e përgjithshme	6 lëndë/module (5 ose 6 kredite secila)	34 ECTS	19%	B. Lëndë karakterizuese	Përgatitje për disiplinën shkencore	17 lëndë/module	90 ECTS	50%	C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese	Njohuri nga nëndisiplina, profile dhe	5 lëndë/module	25 ECTS	14%
Kategoria	Përshkrimi	Nr i Lëndëve/Moduleve	ECTS	% ndaj totalit të krediteve																	
A. Lëndë bazë	Përgatitje metodologjike dhe kulturre e përgjithshme	6 lëndë/module (5 ose 6 kredite secila)	34 ECTS	19%																	
B. Lëndë karakterizuese	Përgatitje për disiplinën shkencore	17 lëndë/module	90 ECTS	50%																	
C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese	Njohuri nga nëndisiplina, profile dhe	5 lëndë/module	25 ECTS	14%																	

		lëndë me zgjedhje			
	D. Lëndë plotësuese	Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	5 lëndë/module	24 ECTS	13%
	E. Detyrime përmbyllëse	Tema e Diplomës	1 lëndë	7 ECTS	4%

Ky strukturim:

- Siguron një balancë optimale midis formimit teorik dhe praktik,
- Promovon zhvillimin gjithëpërfshirës të kompetencave akademike, profesionale dhe kërkimore,
- Ndhmon në ndërtimin e një baze të fortë për studime të mëtejshme dhe për një përgatitje të suksesshme për tregun e punës.

Evidenca:

- Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"

Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Universiteti "Western Balkans" (WBU) ka vendosur si prioritet strategjik përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve dhe të programeve të lëndëve/moduleve, me qëllim: • Sigurimin e një niveli të lartë të njohurive të përditësuara dhe të avancuara për studentët, • Përgatitjen e tyre për të qenë kompetentë në tregun kombëtar, rajonal dhe global të punës, • Integrimin e literaturës bazë dhe ndihmëse më të fundit dhe më të avancuar në programet akademike. Ky proces zhvillohet në përputhje me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Përmirësimi i syllabuseve realizohet në mënyrë të vazhdueshme përmes një serie instrumentesh të brendshme të vlerësimit të cilësisë, të cilat aplikohen në nivel institucional dhe në nivel programi studimi. Këto instrumente përfshijnë: • Vlerësimin e pedagogut nga studentët përmes pyetësorëve të standardizuar,
--	--

	• Vlerësimin e përmbajtjes së lëndëve/moduleve nga studentët, në lidhje me përshtatshmërinë dhe përmbushjen e objektivave akademike, • Analizën vjetore të performancës akademike, të realizuar në nivel të njësisë bazë (departamentit). Të gjitha të dhënat e mbledhura integrohen në analizat vjetore dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje në përmirësimin dhe rishikimin e kurrikulës. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka hartuar dhe vë në zbatim edhe instrumente të tjera vlerësimi, si: • Pyetësorët për studentët në prag diplomimi, ku vlerësohet tërësia e programit akademik të ndjekur dhe jepen sugjerime për përmirësim, • Pyetësorët për Alumni, të zhvilluar çdo tre vjet, për të vlerësuar përshtatjen e të diplomuarve në tregun e punës dhe për të identifikuar nevojat për përditësime të mëtejshme në program, • Vlerësimet nga përfaqësues të industrisë së punës, mbi aftësitë profesionale dhe akademike të të diplomuarve. Këta indikatorë kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në analizën dhe përshtatjen e vazhdueshme të strukturës së syllabuseve dhe të programeve të studimit. Evidenca: - <i>Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen.</i> - <i>Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 31</i> - <i>Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Referuar analizës së përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve të prezantuara përmes syllabuseve dhe planit mësimor të programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, vlerësohet se ky program: • Garanton përftimin e dijeve të thelluara në fushën përkatëse, • Zhvillon aftësitë praktike dhe kërkimore të studentëve, • Siguron formimin e kompetencave të nevojshme profesionale dhe akademike për përballimin e sfidave në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Programi është ndërtuar mbi një strukturë të mirëorganizuar të veprimtarive formuese, të ndara në grupe të lidhura në mënyrë logjike: • Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, • Lëndë karakterizuese: përgatitje e specializuar për disiplinën shkencore të inxhinierisë biomjekësore,

	• Lëndë ndërdisiplinore/integruese: ndërlidhje me nëndisiplina të tjera dhe lëndë me zgjedhje, • Lëndë plotësuese: përfshirje e njohurive në fusha mbështetëse si gjuhët e huaja dhe informatika, si dhe praktika profesionale, • Detyrime përmbyllëse: përgatitja dhe mbrojtja e temës së diplomës. Kjo organizim i strukturuar siguron një progresion të natyrshëm të përvetësimit të njohurive dhe aftësive gjatë gjithë ciklit të studimeve. Përmbajtja e programit i nënshtrohet përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm përmes rishikimit të kurrikulës dhe metodave të mësimdhënies, Bashkëpunimi ndërmjet përbërësve teorikë dhe praktikë të programit siguron zhvillimin e aftësive të aplikueshme dhe praktike të studentëve, Orientimi i qartë drejt aftësimit profesional rrit gatishmërinë e studentëve për integrim në tregun e punës dhe për mobilitet akademik në nivel ndërkombëtar. Në përfundim të programit, studentët diplomohen duke zotëruar: • Njohuri të avancuara dhe të përditësuara në fushën e inxhinierisë biomjekësore, • Aftësi të forta analitike, praktike dhe kërkimore, • Kompetenca që mundësojnë punësim të suksesshëm si në Shqipëri, ashtu edhe në tregjet evropiane dhe globale të punës. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 3 - Kurrikula e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja akademike e programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", e përcaktuar në Rregulloren dhe Kurrikulën përkatëse të programit, është ndërtuar për të siguruar: • Vijimin e suksesshëm të studimeve në nivel më të lartë akademik, • Punësimin e diplomuarve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat dinamike të tregut të punës. Programi synon përgatitjen e studentëve jo vetëm për tregun e punës në Shqipëri, por gjithashtu për një treg më të gjerë rajonal dhe global, duke reflektuar një qasje ndërkombëtare në formimin akademik dhe profesional. Në funksion të ndërtimit të këtij programi, Universiteti "Western Balkans" ka realizuar një studim të posaçëm tregu, duke analizuar: • Pritshmëritë dhe nevojat e sektorit të teknologjisë biomjekësore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,



	• Tendencat e zhvillimit të fushës në sektorin publik dhe privat. Në përputhje me gjetjet e këtij studimi, kurrikula është përshtatur për të garantuar që programi të përmbushë standardet akademike dhe të adresojë nevojat reale të tregut të punës. Të diplomuarit e programit, duke përfituar nga zhvillimi i studimeve në gjuhën angleze, janë të përgatitur për të ndjekur karrierë profesionale në sektorë të ndryshëm, përfshirë: • Spitale dhe institucione shëndetësore: si specialistë të pajisjeve biomjekësore dhe menaxherë të teknologjisë mjekësore, • Industritë e pajisjeve mjekësore: në zhvillimin, testimin dhe mirëmbajtjen e teknologjive biomjekësore të avancuara, • Qendra kërkimore dhe akademike: në fusha të specializuara si biomekanika, biomaterialet dhe inxhinieria e indeve, • Kompanitë e bioteknologjisë dhe farmaceutikës: për zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive të reja shëndetësore, • Startupe dhe sipërmarrje teknologjike në shëndetësi: si zhvillues ose konsulentë të pajisjeve dhe softuerëve mjekësorë. Të diplomuarit e programit kanë gjithashtu mundësi të thelojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre nëpërmjet studimeve të mëtejshme në nivelin Master, në fusha të tilla si: Inxhinieri Biomjekësore, Bioteknologji, Nanoteknologji, Shkencat e Materialeve etj. Programi është ndërtuar në mënyrë që të jetë i përputhshëm me shumë programe ndërkombëtare, duke: • Krijuar mundësi për transferim akademik në universitete dhe institute kërkimore jashtë vendit, • Lehtësuar mobilitetin akademik dhe aksesin në projektet kërkimore ndërkombëtare. Ky organizim dhe orientim strategjik garanton që programi i studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" të shërbejë si një platformë efektive për formim akademik dhe profesional të studentëve në një kontekst të gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 4, Neni 5, Neni 7 - Kurrikula e Programit "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekësore"
Konkluzione	GVJ nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave të sipërpërmenduar konkludon se:

	<i>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</i> <i>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</i> <i>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve apo punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Per përmirësimin e të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, si dhe për përshtatjen sa më efektive të tij me kërkesat reale të tregut të punës, njësitë përgjegjëse: - Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) dhe - Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, kanë ndjekur një proces të strukturuar të konsultimit me aktorët kyç brenda dhe jashtë institucionit. Ky proces përfshinte: - Konsultimin me institucione partnere, - Marrjen në konsideratë të propozimeve nga të diplomuarit (Alumni), - Integrimin e sugjerimeve nga aktorë të tregut të punës. Partnerët strategjikë të WBU, si: - Grupi i Spitaleve Amerikane dhe - International Hygea Hospital,

	kanë dhënë rekomandime të rëndësishme gjatë fazës së hartimit dhe rishikimit të programit, duke theksuar: • Nevojën për specialistë të profilizuar në fushën e inxhinierisë biomjekësore, • Përshtatjen e kurrikulës me kërkesat praktike dhe teknologjike të sektorit shëndetësor. Sugjerimet e tyre janë reflektuar në ndërtimin e lëndëve/moduleve dhe në përcaktimin e objektivave të programit. Konsultimet e rregullta me partnerët institucionalë dhe aktorët e tregut të punës janë një komponent integral i strategjisë së WBU për: • Sigurimin e cilësisë akademike, • Rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve, • Përmirësimin dhe përshtatjen e programeve studimore në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe shoqërore. Ky proces i integruar i konsultimit dhe reflektimit mbi kërkesat e tregut të punës garanton që programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” të mbetet aktual, i përshtatshëm dhe konkurrues në një treg pune dinamik dhe global. Evidenca: - Analiza e tregut të punës për hapjen e programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, - Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. <i>Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 31.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, <i>neni 1</i> qartëson një nga qëllimet e institucionit që është rregullimi i procesit të vlerësimit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe cdo gjë tjetër që lidhet me zhvillimin e cilësisë. Në <i>nenin 4</i> përcaktohet mënyra e arritjes së sigurimit të cilësisë: - Gjithëpërfshirja; - Koherenca; - Objektiviteti; - Efikasiteti dhe përmirësimi; - Përgjegjësitë e transferuara; Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri. GVJ gjatë vizitës në institucion, u takua me



	studentë të këtij programi studimi dhe ata pohuan se bëhen pjesë e përmirësimit të programit të studimit nëpërmjet anketimeve dhe diskutimeve që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, Evidenca: - Pjesëmarrja e studentëve në Senatin akademik - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 62 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 47 <u>Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.</u>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	WBU ka përcaktuar një qasje të strukturuar për përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit. Kjo qasje mbështetet në: • Analizën sistematike të të dhënave të mbledhura nga instrumentet e cilësisë, • Vlerësimin e feedback-ut të studentëve aktualë, të diplomuarve (Alumni), si dhe përfaqësuesve të industrisë dhe institucioneve partnere. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për reflektim dhe për të ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e përmbajtjes, strukturës dhe rezultateve të programit të studimit. WBU synon të pozicionohet si një promotor i zhvillimit të sektorit të shëndetësisë, ekonomisë dhe shoqërisë në nivel kombëtar, duke: • Nxitur përparimin teknologjik dhe inovacionin shkencor, • Promovuar përkujdesjen sociale dhe ndërveprimin me qytetarët, • Bashkëpunuar ngushtë me sistemin ekonomik dhe institucionet publike e private, • Forcuar marrëdhëniet me rrjetet profesionale dhe shoqatat e specializuara, në veçanti ato të fushës së mjekësisë. Megjithëse programi i studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” është aktualisht në fazat e para të zbatimit dhe nuk ka kaluar ende në cikle të riorganizimit, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) dhe Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, njësia bazë përgjegjëse për programin, kanë: • Parashikuar të gjitha instrumentet e nevojshme të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, • Vendosur procedura të qarta për përmirësimin dhe përshtatjen e programit, në përputhje me: ◦ Sugjerimet e studentëve dhe të diplomuarve, ◦ Rekomandimet e përfaqësuesve të industrisë, ◦ Zhvillimet më të fundit akademike dhe teknologjike në fushën e biomjekësisë.



	Përmirësimet e ardhshme të programit do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me rrjete profesionistësh, shoqata profesionale, urdhra dhe institucione kërkimore dhe zhvillimore, duke garantuar kështu një përshtatje dinamike me evolucionin e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore. Përmes këtyre mekanizmave, WBU synon: të sigurojë që programet e studimit të mbeten relevante dhe konkurruese; të përgatisë studentë të aftë për të përballuar sfidat e së ardhmes, të kontribuojë në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve kyç të shoqërisë shqiptare dhe rajonale.			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV konkludon se:</i> <i>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit WBU nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar edhe në dege të tjera për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</i> <i>FETI/DIB përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies,	Format e organizimit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive në Universitetin "Western

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Balkans" (WBU) përcaktohen në: • Rregulloren Themelore të Universitetit, • Rregulloren "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë", • Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore". Këto dokumente përcaktojnë standardet, metodologjitë dhe format pedagogjike që udhëheqin procesin akademik të këtij programi. Në programin e studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", mësimi zhvillohet nëpërmjet një ndërthurjeje të balancuar të elementeve të mëposhtëm: • Leksione: për të zhvilluar bazën teorike të njohurive, • Laboratore: për të forcuar aplikimin praktik të koncepteve të mësuara, • Projekte dhe detyra praktike: për të zhvilluar aftësi kërkimore dhe analitike, • Seminare: për të thelluar diskutimin dhe analizën kritike, • Praktika profesionale dhe stazhe: për të mundësuar përvojë reale në fushën e biomjekësisë. Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e lëndëve/moduleve: • Gëzon të drejtën për të kombinuar në mënyrë fleksibël format e mësimdhënies sipas objektivave të përcaktuara në syllabus-in e lëndës, • Adaptuar metodologjitë mësimore në përputhje me nevojat dhe profilin e studentëve, • Siguron që përmbajtja dhe mënyra e transmetimit të njohurive të jetë në funksion të rritjes së kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve. Ky sistem i kombinuar i metodave të mësimdhënies garanton një formim të plotë teorik dhe praktik të studentëve dhe përgatitjen e tyre të suksesshme për tregun e punës dhe për vijimin e studimeve të mëtejshme. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 75, pikat 4-6 - Rregulloren "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Raport mbi orët e hapura në vitin akademik 2023-2024
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit zhvillon procesin e mësimdhënies duke respektuar: • Larmshmërinë e profileve dhe nevojave të



nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.

studentëve,

- Aplikimin e formave dhe metodave alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- Përdorimin e mënyrave të ndryshme të transmetimit të njohurive për të siguruar përfshirje dhe efektivitet në përvetësimin e kompetencave.

Këto parime janë të përcaktuara në:

- Rregulloren Themelore të WBU (Neni 75, pikat 4-6),
- Rregulloren "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë",
- Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" (Neni 7).

Procesi mësimor në këtë program ndërthur elementë të ndryshëm, të planifikuar në syllabus-in e secilës lëndë:

- Leksione teorike, të zhvilluara nëpërmjet prezantimeve PowerPoint dhe metodave të tjera vizuale të mbështetura nga teknologjitë e avancuara të WBU si Smartboards,
- Punë laboratorike, për zhvillimin e aftësive praktike dhe aplikative,
- Praktika mësimore dhe vizita studimore, në laboratorë ose institucione të tjera relevante,
- Seminare interaktive dhe bashkëbisedime, që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime tematike,
- Detyra kursi dhe projekte individuale, që zhvillojnë pavarësinë, shkathtësitë analitike dhe aftësitë e prezantimit të studentëve,
- Testime të shkurtra, për të monitoruar vazhdimësinë e përvetësimit të njohurive,
- Provime të kursit dhe përgatitje të tezës së diplomës, si forma përfundimtare të vlerësimit të kompetencave.

Puna individuale e studentit:

- Zë një vend të rëndësishëm në sistemin e vlerësimit të përgjithshëm,
- Stimulon mësimnxënien e pavarur, zhvillimin e shkathtësive analitike dhe ndërtimin e kapaciteteve për hulumtim dhe prezantim akademik,
- Realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve të pavarura, analizave dhe raporteve të kërkimit,
- Ndihmon studentët të zhvillojnë kompetenca kyçe për karrierën akademike dhe profesionale.

Evidenca:



	- Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 75, pikat 4-6 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 7 - Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti "Western Balkans" (WBU), mbështet fuqimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik në: • Përmirësimin e kompetencave didaktike, • Përafrimin me rezultatet e pritshme të të nxënit, • Zhvillimin e vazhdueshëm profesional, pavarësisht eksperiencës paraprake të individëve. Institucioni zbaton një politikë integruese që përfshin: • Personelin akademik, • Personelin ndihmës mësimor-shkencor, • Personelin administrativ. WBU ka hartuar dhe zbaton politika të qarta dhe të strukturuar për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, duke ofruar: • Trajnime periodike për rritjen e kompetencave pedagogjike, • Përmirësimin e aftësive për integrimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, • Përshtatjen me standardet më të avancuara të arsimit të lartë. Për këtë qëllim, janë krijuar bashkëpunime aktive me akademikë dhe ekspertë vendas dhe të huaj që ndihmojnë në organizimin e trajnimeve dhe ëorkshopeve të specializuara. Në funksion të modernizimit të procesit mësimor: • Të gjitha auditorët e WBU janë të pajisur me Smartboard-e dhe teknologji të avancuara didaktike, • Janë organizuar seanca trajnime për përdorimin efektiv të këtyre teknologjive me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik, • Kjo nismë synon të përmirësojë cilësinë e transmetimit të njohurive dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor. Evidenca: - Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien - Pyetësor për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik dhe administrativ. Paketa e instrumenteve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

	- <i>Plani i i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 / 2024-2025</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në procesin e mësimdhënies personeli akademik i angazhuar në programin “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”: • Ka eksperiencë të gjerë në fushën përkatëse, • Përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies interaktive, • Inkurajon zhvillimin e mendimit kritik, kreativitetit dhe autonomisë tek studentët. Metodologjitë e zbatuara vendosin studentin në qendër të procesit mësimor dhe nxisin një mjedis aktiv të të nxënit. Formimi akademik dhe profesional i personelit të WBU: • Është realizuar në universitetet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, • Shumica e personelit akademik ka përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkime shkencore, • 33% e personelit akademik të përgjithshëm dhe 53% e personelit të angazhuar në program janë diplomuar ose kanë kryer doktoraturën në vende të zhvilluara jashtë Shqipërisë. Ky profil i lartë akademik garanton aftësi të avancuara komunikimi, transmetimi të njohurive dhe ndërtimi të marrëdhënieve efektive pedagog-student. Mësimdhënia në programin “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” mbështetet në: • Një organizim të mirë-strukturuar të syllabuseve dhe planeve mësimore, • Kombinimin e leksioneve, seminareve dhe punës praktike, • Përdorimin e teknologjive moderne (Smartboard-e, platforma digjitale) për të lehtësuar procesin mësimor dhe menaxhimin e klasës. Në fokus qëndron zhvillimi i seminareve ndërvepruese dhe diskutimeve të hapura, ku studentët angazhohen aktivisht, ndajnë idetë e tyre dhe zhvillojnë aftësi prezantimi dhe argumentimi. Studentët inkurajohen të kontribuojnë në diskutime dhe në vlerësimin e punëve të kolegëve të tyre, duke promovuar një mjedis transparence dhe respekti akademik. Këto marrëdhënie janë thelbësore për suksesin e programit dhe për përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale dhe akademike në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Evidenca: - Personeli akademik i diplomuar jashtë vendit - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 75, pikat 4-6

	- Rregullorja e Programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 7
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë realizon: • Vlerësimin periodik të praktikave të mësimdhënies, • Përmirësimin e metodave të aplikimit të njohurive në procesin mësimor, • Angazhimin aktiv të studentëve në këtë proces reflektimi dhe zhvillimi. Në kuadër të politikave të brendshme për sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) ka hartuar një paketë instrumentesh të posaçme që synojnë ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të mësimdhënies. Instrumentet e vlerësimit përfshijnë: • Pyetësorët e studentëve për vlerësimin e pedagogut në fund të çdo semestri, para provimeve përfundimtare, • Pyetësorët e vlerësimit të lëndës nga studentët në fund të çdo viti akademik, • Pyetësorët e studentëve në prag diplomimi për vlerësimin e gjithë programit të studimit, • Vlerësimin kolegial të personelit akademik përmes pjesëmarrjes në leksione të hapura të organizuara midis anëtarëve të departamentit dhe studentëve. Pyetësorët përmbajnë pyetje të hapura dhe të mbyllura, duke synuar të tërheqin mendime dhe sugjerime të detajuara për një vlerësim sa më objektiv dhe për një përmirësim efektiv të metodologjisë së mësimdhënies. Ky proces garanton që përmirësimi i formave të mësimdhënies të mos jetë i rastësishëm, por i bazuar në analiza të qëndrueshme dhe pjesëmarrje të gjerë të aktorëve të përfshirë. Evidenca: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët - Formulari i vlerësimit të lëndës nga studentët. Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 29 - Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 31 - Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët - Raporti i vlerësimit të personelit akademik nga studentët 2023-2024
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Politika institucionale për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies mbështetet në: Bashkëveprimin ndërmjet strukturave akademike dhe administrative, Zbatimin e strategjive të koordinuara për të forcuar standardet

vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	akademike. Për garantimin dhe zhvillimin e cilësisë, WBU ka ngritur dhe funksionalizuar: • Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, • Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Këto struktura: • Bashkërendojnë aktivitetet me fakultetet dhe departamentet, • Harmonizojnë veprimtaritë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, • Organizojnë takime të rregullta me njësitë akademike për diskutimin e progresit dhe zbatimin e strategjive të reja, në përputhje me nevojat e çdo njësie. NJSBC realizon: • Vlerësime periodike të performancës akademike dhe cilësisë së mësimdhënies, • Analizën e përmbajtjes së programeve të studimit përmes instrumenteve të cilësisë, • Përgatitjen dhe publikimin e raporteve të vlerësimit, të cilat përfundojnë me rekomandime të qarta për përmirësim. Përmbushja e rekomandimeve: • Realizohet përmes aktiviteteve dhe masave konkrete, të planifikuara sipas një kalendari vjetor, • Organizohen nga strukturat akademike dhe ndihmës-akademike të institucionit, • Ndryshimet dhe propozimet për përmirësimin e elementëve të programeve diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e njësive bazë dhe pasqyrohen në analizat vjetore. Nëpërmjet këtyre politikave dhe mekanizmave, Universiteti "Western Balkans" siguron që: • Cilësia e mësimdhënies të jetë në përmirësim të vazhdueshëm, • Programet akademike të përputhen me kërkesat bashkëkohore të tregut të punës dhe të kërkimit shkencor, • Studentët të pajisen me një përgatitje të avancuar, konkurruese dhe të përshtatshme për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Evidenca:
---	--



	- Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Vendimi për ngritjen e NJSBC - Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC - Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien - Plani i i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ për vitin akademik 2023-2024 - Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Paketa e instrumenteve të cilësisë. - Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC - Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU - Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU			
Konkluzione	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konkudon se: Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Njesite respective te WBU promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si edhe mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sistemi i vlerësimit të studentëve, kriteret dhe format e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore janë të përcaktuara në: • Rregulloren Themelore të WBU, Kreu XII, Nenet 89–99, • Rregulloren “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, • Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”. Këto dokumente sigurojnë një qasje të standardizuar dhe transparente për vlerësimin akademik të studentëve. Rregulloret përkatëse përfshijnë dispozita të detajuara për: • Notat, provimet dhe kalueshmërinë • Kriteret për kalimin në vitin pasardhës • Procedurat për përmirësimin e mesatares së përgjithshme • Përcaktimin e notës kaluese • Organizimin e sezonit të provimeve • Kushtet për pjesëmarrjen në provime • Afatet dhe organizimin e provimeve • Programin dhe vendin e zhvillimit të provimeve, si dhe provimet e riprovimeve (make-up) • Format e provimeve • Dokumentimin dhe administrimin e vlerësimeve • Procedurat për ankimin ndaj rezultateve të provimeve Ky kuadër garanton transparencë, objektivitet dhe trajtim të barabartë të studentëve gjatë procesit të vlerësimit. Çdo ndryshim i mundshëm në lidhje me kriteret apo procedurat e vlerësimit komunikohet në mënyrë të rregullt dhe transparente me studentët, duke siguruar që ata të jenë plotësisht të informuar gjatë gjithë procesit të studimeve. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Kreu 12, Nenet 89-100 - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Rregullorja e Programit të Studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e	Çdo syllabus në Universitetin “Western Balkans” (WBU) është hartuar në përputhje me: • Legjislacionin në fuqi, • Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit



vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	(MAS), • Standardet dhe praktikat më të mira të përcaktuara për arsimin e lartë. Çdo syllabus përmban të gjithë elementët informues të domosdoshëm për studentin, duke përfshirë: • Titullarin e lëndës/modulit dhe informacionin bazë të kontaktit, • Përshkrimin e metodologjive të përdorura në mësimdhënie dhe mësimnxënie, • Metodatat e vlerësimit dhe peshën specifike të secilit komponent të vlerësimit. Në javën e parë të çdo semestri: • Titullari i çdo lënde/moduli informon studentët për metodologjinë e testimit, • Prezantohen komponentët e vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore, • Sqarohet përqindja e peshës së çdo komponenti në vlerësimin total të lëndës. Kjo procedurë garanton që studentët të kenë një njohje të plotë mbi pritshmëritë akademike dhe kriteret e vlerësimit për secilën lëndë. Për të siguruar akses të vazhdueshëm dhe transparencë: Syllabuset, detyrimet akademike dhe mënyrat e vlerësimit ngarkohen në platformën SMART WBU, Paralelisht, ato publikohen edhe në Google Classroom për çdo lëndë/modul të programit. Studentët kanë mundësi të konsultojnë në çdo kohë përmbajtjen e syllabusit, objektivat formues, metodologjitë e përdorura dhe kriteret e vlerësimit, duke ndihmuar në orientimin dhe organizimin e studimeve të tyre. Evidenca: - Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjeksore”
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore të studentëve realizohet përmes formave të ndryshme, të dizajnuara për të ofruar: • Një vlerësim të drejtë dhe të plotë të njohurive të fituara, • Një mundësi të balancuar për të shfaqur aftësitë në forma të ndryshme, • Mbështetje për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës studentore. Studentët njihen me:




- Format e vlerësimit,
- Komponentët përbërës të vlerësimit,
- Peshën specifike të çdo komponenti në vlerësimin final,

që në javën e parë të zhvillimit të çdo lënde, përmes syllabusit të lëndës, i cili është gjithashtu i aksesueshëm në çdo kohë përmes platformës SMART WBU. Përzgjedhja e metodave të vlerësimit bëhet nga titullari i lëndës, në përputhje me: Rregulloret institucionale, Karakteristikat dhe natyrën specifike të lëndës/moduleve.

Metoda e Vlerësimit	Përshkrimi	Pesha në Vlerësimin Final (%)
Provimi i Ndërmjetëm	Teston njohuritë bazë të fituara deri në gjysmën e semestrit përmes pyetjeve teorike dhe/ose ushtrimeve praktike.	20%
Kuize (Quiz)	Vlerësime të shkurtra të njohurive gjatë semestrit, që shërbejnë për të kontrolluar progresin e vazhdueshëm.	10%
Detyra të Shtëpisë	Projekte ose ushtrime të caktuara për punë individuale, që konsolidojnë të kuptuarit teorik dhe praktik.	10%
Projekte dhe Prezantime	Punë individuale ose në grup, ku studentët aplikojnë konceptet e mësuara dhe prezantojnë rezultatet para kolegëve dhe stafit akademik.	15%
Pjesëmarrja Aktive dhe Aktivizimi	Vlerësimi i kontributit aktiv të studentëve në seminare, diskutime, laboratorë dhe aktivitete të tjera mësimore.	5%



	<table> <tr> <td>Provimi Final</td> <td>Testim gjithëpërfshirës i njohurive dhe aftësive të fituara gjatë gjithë semestrit, përmes pyetjeve me përgjigje të hapura, ushtrimeve praktike ose projekteve përfundimtare.</td> <td>40%</td> </tr> </table>	Provimi Final	Testim gjithëpërfshirës i njohurive dhe aftësive të fituara gjatë gjithë semestrit, përmes pyetjeve me përgjigje të hapura, ushtrimeve praktike ose projekteve përfundimtare.	40%
Provimi Final	Testim gjithëpërfshirës i njohurive dhe aftësive të fituara gjatë gjithë semestrit, përmes pyetjeve me përgjigje të hapura, ushtrimeve praktike ose projekteve përfundimtare.	40%		
	Ky model i strukturuar dhe fleksibël i vlerësimit garanton integritetin akademik dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale dhe akademike në vazhdimësi. Evidenca: - Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në Programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore”.			
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i formave dhe metodave të mësimdhënies realizohet nëpërmjet një sistemi të strukturuar monitorimi, pjesë integrale e Paketës së Instrumenteve të Cilësisë. Studentët kanë mundësinë të vlerësojnë: • Performancën e secilit pedagog për lëndët/modulet ku janë angazhuar, • Cilësinë dhe përmbajtjen e secilës lëndë të ndjekur. Pyetësorët e vlerësimit zhvillohen dy herë në vit akademik, në fund të çdo semestri, përpara fillimit të sezonit të provimeve. Studentët inkurajohen të plotësojnë: • Sondazhin për vlerësimin e pedagogut, • Sondazhin për vlerësimin e lëndës. Përveç pyetjeve të strukturuar të mbyllura, studentëve u jepet mundësia të japin komente të hapura për çështje shtesë, duke kontribuar në thellimin e analizës së performancës akademike. Bazuar në analizat e vlerësimit Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tjera përgjegjëse në WBU organizojnë: seminare ndërgjegjësuere dhe formuese, aktivitete trajnuese për personelin akademik dhe ndihmës-akademik, etj. Këto aktivitete synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve akademike, rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe ndihmojnë në përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare.			
	Evidenca: - Paketa e instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë - Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien			



Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Universiteti “Western Balkans” mbështet dhe inkurajon në mënyrë aktive përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mbështet realizimin e objektivave të zhvillimit profesional të stafit akademik. Në kuadër të metodologjisë së mësimdhënies të aplikuar në WBU, prezantimet e studentëve, projektet, detyrat praktike dhe puna laboratorike, të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, luajnë një rol kyç në: • Nxitjen e autonomisë dhe pavarësisë së studentëve në procesin e të mësuarit, • Promovimin e punës në grup dhe bashkëpunimit ndërstudentor, • Edukimin dhe zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe analitik, • Formimin e kompetencave të nevojshme për suksesin akademik dhe profesional. Gjatë gjithë këtij procesi, studentët përfitojnë nga: • Mbikëqyrja akademike e vazhdueshme, • Mbështetja pedagogjike e dedikuar nga ana e personelit akademik. Pedagogët luajnë rolin e mentorëve, duke: • Inkurajuar dialog të hapur dhe shkëmbim idesh, • Ofruar reagime konstruktive mbi progresin akademik të studentëve, • Ndihmuar studentët të ndërtojnë vetëbesim dhe të zhvillojnë qëndrueshmëri akademike. Ky mjedis bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës kontribuon në rritjen cilësore të eksperiencës mësimore dhe përgatit studentët për sfidat e ardhshme akademike dhe profesionale. Evidenca: - Angazhimi i personaliteteve në mësimdhënie - Praktikë e mbështetjes financiare për konferenca - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konkludon se Universiteti “Western Balkans” (WBU) ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të WBU dhe programet dhe syllabuset e lëndëve.</i> <i>Këto dokumente janë të publikuara dhe të aksesueshme për studentët, duke siguruar transparencë dhe njohje të plotë të standardeve të vlerësimit që në fillim të ndjekjes së lëndëve. Në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat</i>

	<i>formues dhe kërkesat e tregut të punës, përdoren metoda të ndryshme pedagogjike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Siç është evidentuar edhe në kriteret pararendëse, testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore realizohet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit akademik dhe kontribuon ndjeshëm në formimin e vlerësimit përfundimtar të studentit. Format dhe metodat e vlerësimit: • Janë të parashikuara dhe të detajuara në syllabuset përkatëse të çdo lënde/moduli, • Prezantohen nga titullari i lëndës/modulit gjatë javës së parë të mësimi, • Janë të aksesueshme për studentët në çdo moment përmes platformës Smart WBU. Procesi i vlerësimit bazohet në një qasje të kombinuar, që përfshin: • Aktivizimin e studentëve gjatë gjithë semestrit, • Provimet e ndërmjetme ("Midterm") të organizuara në javën e 8-të të semestrit, • Provimet përfundimtare të zhvilluara në javën e 16-të, • Projekte dhe detyra individuale, • Teste të shkurtra, • Preztime dhe punime laboratorike. Këto forma të vlerësimit mundësojnë që studenti të tregojë progresin e tij akademik në mënyrë graduale dhe të përforcojë aftësitë praktike e teorike të fituara. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi gjithëpërfshirës dhe të strukturuar, Universiteti "Western Balkans" garanton: • Rritjen e angazhimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, • Ofrimin e mundësive reale për demonstrimin e kompetencave akademike dhe praktike, • Sigurimin e një procesi vlerësimi transparent, objektiv dhe të ndërtuar mbi parimin e zhvillimit të

	vazhdueshëm të studentëve. Evidenca: - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Përdorimi i platformës Smart WBU mundëson: • Regjistrimin në kohë reale të rezultateve, • Një strukturë të objektivizuar të testimit dhe vlerësimit, • Ruajtjen e gjurmëve të çdo veprimi për qëllime sigurie dhe auditimi, • Lehtësimin e analizimit dhe raportimit të rezultateve të studentëve. Testimet organizohen në forma të ndryshme: • Provime me shkrim, • Provime me gojë, • Kombinime të të dyjave, sipas natyrës së lëndës. • Për garantimin e integritetit të procesit, tezat dhe fletët e provimit janë të pajisura me barcode unik, që mundëson sekretimin dhe identifikimin e sigurt të çdo flete provimi. Krijimi i barcodeve kryhet përmes sistemit Smart WBU. • Barcode përmban të dhëna bazë: numri i studentit, emri i provimit, data, ora, dhe të dhëna të tjera identifikuese. • Koordinatorët e departamenteve, administratorët e fakulteteve dhe personeli i IT-së monitorojnë prodhimin dhe aplikimin e barcodeve, si dhe administrimin e procesit të sekretimit të provimeve. Ky proces siguron një vlerësim objektiv, të pandikuar, dhe të dokumentuar në mënyrë të sigurt. Evidenca: - Udhëzimi për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i studentëve për secilën lëndë në Universitetin "Western Balkans" pasqyron përmbushjen e të gjitha detyrimeve akademike të parashikuara në kurrikulën përkatëse. Nota përfundimtare në një lëndë është rezultat i instrumenteve të vlerësimit gjatë semestrit, përfshirë: ○ Testime të ndërmjetme, ○ Provime gjysmë-finale, ○ Kuize dhe detyra shtëpie, ○ Projekte individuale apo në grup, ○ Seminare dhe pjesëmarrje aktive në grupe pune,

- o Punë laboratorike dhe ateli pune.

Si dhe nota e provimit përfundimtar, e cila ka peshën e saj specifike sipas syllabusit të lëndës. Të gjithë komponentët e vlerësimit regjistrohen në:

- Procesverbalin përfundimtar të lëndës,
- Regjistrin e notave,
- Regjistrin elektronik të platformës Smart WBU.

Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu përgjegjës në përfundim të vlerësimit të të gjithë komponentëve të lëndës. Vlerësimi përfundimtar realizohet sipas një sistemi me shtatë nivele pikësh, të përcaktuar si më poshtë:

Pikët	Nota Shqiptare	Nota ECTS
90 – 100	10	A
85 – 89	9	B
75 – 84	8	C
65 – 74	7	D
55 – 64	6	E
50 – 54	5	E
0 – 49	4 (jo kaluese)	F

Nota minimale kaluese është 5 sipas sistemit shqiptar dhe E sipas sistemit ECTS. Rezultati përfundimtar shprehet njëkohësisht me notë numerike, gërmë sipas sistemit ECTS dhe është i regjistruar në suplementin e diplomës. Përdorimi i këtyre simboleve rregullohet sipas përcaktimeve të detajuara në Rregulloret e WBU dhe aplikohet në përputhje me specifikat përkatëse për çdo rast akademik.

Evidenca:

- Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"
- Model Procesverbal vlerësimi i një lënde të caktuar
- Udhëzimi për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik
- Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Kreu 12, Neni 89

Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale

Në përputhje me standardet akademike të Universitetit "Western Balkans" dhe me parimet e transparencës në procesin mësimor, pas çdo:

shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	• Testimi të zhvilluar gjatë vitit akademik, • Seminari, • Provimi të ndërmjetëm (midterm), • Dorëzimi të detyrave të kursit apo projekteve, studentët informohen për vlerësimin e tyre nga pedagogu i lëndës. Ky proces vlerësohet si thelbësor për: • Thellimin e të kuptuarit të studentëve mbi progresin personal, • Ndihmimin në kapërcimin e vështirësive të hasura gjatë procesit të të nxënës, • Përgatitjen më të mirë për sfidat akademike të ardhshme. Pas zhvillimit të provimeve studentët kanë të drejtë të shqyrtojnë vlerësimin e dhënë dhe të diskutojnë me pedagogun në rast paqartësish. Afati maksimal për dorëzimin e procesverbalit dhe provimeve është jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e zhvillimit të provimit. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans",
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse akademike angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të parandaluar dhe shmangur çdo formë të plagjiaturës, kopjimit gjatë provimeve dhe shkeljeve të tjera akademike. Në këtë drejtim, institucioni ka vendosur dhe zbaton politika rigoroze që ndalojnë këto praktika, duke përdorur mjete dhe mekanizma të avancuara për kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë akademike. Në kuadër të projektit Erasmus+ CBHE "QA_SURE", Universiteti "Western Balkans" aplikon: • Softuerët antiplagjiaturë: <i>Turnitin</i> dhe <i>AI Detector</i>, • Sisteme mbikëqyrjeje në provime: Çdo provim ndërmjetëm dhe përfundimtar monitorohet nga pedagogu i lëndës dhe një vëzhgues i dytë (koleg akademik ose staf administrativ), • Lista e prezencës: Firmoset nga të dy mbikëqyrësit për garantimin e transparencës dhe integritetit të procesit. Për më tepër, çdo syllabus përmban një seksion të veçantë mbi etikën akademike dhe pasojat e shkeljeve, me të cilin studentët njihen që në javën e parë të fillimit të lëndës. Nëse konstatohet një rast i plagjiaturës, kopjimit ose thyerjes së rregullave të provimit: • Studenti ndërpret provimin në mënyrë të menjëhershme, • Përgatitet një procesverbal për parregullsi nga pedagogu dhe vëzhguesi,

	• Provimi i studentit i bashkëngjitet procesverbalit dhe vlerësohet automatikisht me 0 pikë. Këto masa synojnë të forcojnë një kulturë të integritetit akademik, të mbështesin zhvillimin e përgjegjshëm të studentëve dhe të ruajnë standardet më të larta të cilësisë në Universitetin "Western Balkans". Evidenca: - Projekti për quality assurance QA-SURE - Kodi i Etikës së Studentëve të Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Udhëzimi për procesin e sekretimit të provimeve gjatë vitit akademik - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekesore" - Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore", Neni 3 - Kurrikula e programit të e studimit të ciklit të parë "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore" - Evidenca për WBU Research Seminars
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e përftuara nga studentët pasqyrohen në: • Procesverbalin e vlerësimit, • Regjistrin e notave, • Regjistrin elektronik të platformës Smart WBU. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu i lëndës në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet pranë Sekretarisë Mësimore brenda një afati prej dy javësh nga përfundimi i sezonit të provimeve. Procesverbali duhet të jetë i saktë dhe pa korrigjime. Nuk lejohet shtimi i emrave të tjerë pas plotësimit dhe firmosjes. Procesverbali duhet të mbajë firmën e pedagogut të lëndës, dhe firmën e Koordinatorit të Departamentit përkatës. Një vlerësim i regjistruar mund të ndryshohet vetëm në rastet kur konstatohet një: • Gabim teknik gjatë regjistrimit në procesverbal, • Gabim gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin elektronik. Në këto raste: • Pedagogu përgjegjës duhet të paraqesë një vërtetim me shkrim që përshkruan qartë rrethanat e gabimit. • Kjo dokumentacion duhet të miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. • Ndryshimi i të dhënave pranohet brenda një afati maksimal prej tre ditësh nga momenti i konstatimit të gabimit. Evidenca:

	- Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Kreu 12, Neni 98
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Universiteti "Western Balkans" garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me rezultatet e vlerësimeve dhe për të kërkuar rishikimin e tyre. Procedura zhvillohet si më poshtë: • Sekretaria Mësimore e përcjell kërkesën përkatëse pranë Departamentit përgjegjës për rivlerësimin dhe shqyrtimin e vlerësimit. • Stafit akademik ballafaqon studentin me materialin e vlerësuar dhe jep shpjegimet përkatëse për vlerësimin e dhënë. • Nëse pas ballafaqimit studenti vijon të ketë mosmarrëveshje mbi vlerësimin, ai ka të drejtë, brenda afateve të përcaktuara, të paraqesë një kërkesë formale me shkrim pranë Departamentit për rishikim të vlerësimit të provimit. Universiteti siguron që procesi të zhvillohet në mënyrë transparente, të drejtë dhe në respekt të të drejtave të studentit për një trajtim të paanshëm dhe objektiv të ankesave të tyre. Evidenca: Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankesë, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë ose ankimim i paraqitur nga studenti për vlerësimin në një lëndë shqyrtohet nëpërmjet një procedure të strukturuar dhe transparente. Në përputhje me rregulloret në fuqi, shqyrtimi i ankesave realizohet në dy faza: • Fillimisht nga Komisioni i Vlerësimit • Më pas, nëse nevojitet, nga një Komision i Posaçëm i Rishikimit. Ankimi përqendrohet vetëm në gabime materiale dhe shqyrtohet nga një komision i ngritur me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës. Ky komision përbëhet nga tre anëtarë të stafit akademik, ku pedagogu i lëndës objekt i ankesës nuk mund të jetë pjesë e komisionit të rishikimit. Pas shqyrtimit, Komisioni merr një vendim përfundimtar për rezultatin e rishikimit. E gjithë procedura e shqyrtimit dhe rishikimit kryhet në mënyrë transparente, duke garantuar dokumentimin dhe arkivimin e çdo faze të procesit, për të mbrojtur integritetin e veprimtarisë akademike dhe të drejtën e studentëve për një trajtim të drejtë dhe të paanshëm. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Kreu 12, Neni 99

Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konkludon se: Studentët gëzojnë të drejtën të shohin fletët e provimit dhe të marrin shpjegime për vlerësimin nga pedagogu përkatës. Vlerësimi përfundimtar i lëndëve kryhet në përputhje të plotë me programet mësimore, syllabuset përkatëse dhe dispozitat ligjore dhe rregullatore të institucionit. Njësitë përgjegjëse akademike dhe personeli akademik respektojnë me rigorozitet standardet e integritetit akademik, duke ndërmarrë masa parandaluese kundër plagjiaturës, kopjimit në provime dhe në detyra të ndryshme, përmes përdorimit të mjeteve të specializuara të kontrollit dhe zbatimit të rregullave të etikës akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmes organizimit të kujdesshëm të planit mësimor dhe metodologjive të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës studentore, programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, në përputhje me objektivat formuese të përcaktuara në dokumentet përkatëse akademike. Ky angazhim është i formalizuar dhe i detajuar në: Rregulloren e Programit të Studimit “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, si dhe Kurrikulën përkatëse të programit, ku parashikohen qartë objektivat e të nxënësve dhe strukturimi akademik i veprimtarive formuese. Organizimi i veprimtarive formuese, të ndara në mënyrë logjike në grupe lëndësh: ○ Lëndë bazë, ○ Lëndë karakterizuese, ○ Lëndë ndërdisiplinore/integruese, ○ Lëndë plotësuese, ○ Detyrime përmbyllëse (projekti/diploma). Përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe materialeve didaktike, si dhe zbatimin e metodave moderne të mësimdhënies, që ndërthurin njohuritë teorike me aftësimin

	praktik profesional përmes projekteve, punës individuale dhe punës laboratorike. Në këtë mënyrë, programi kontribuon në formimin e specialistëve të aftë dhe konkurrues në fushën e inxhinierisë biomjekësore, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm personal dhe profesional të studentëve të tij. Evidenca: - Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore", Neni 3 - Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" në Universitetin "Western Balkans" (WBU) zhvillohet në gjuhën angleze, duke përdorur një literaturë të përzgjedhur dhe bashkëkohore, e cila është e disponueshme si në bibliotekën fizike të institucionit, ashtu edhe në platformat online ku WBU është i regjistruar dhe licencuar. Për realizimin sa më cilësor të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve një infrastrukturë teknologjike moderne, duke përfshirë mjetet më të avancuara të përdorura aktualisht në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë. Programi "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përfaqëson një mundësi akademike të spikatur për studentët që synojnë thellimin e njohurive në një fushë me potencial të lartë për inovacion, zhvillim teknologjik dhe aplikime kërkimore. Studentët pajisen jo vetëm me aftësi teknike të avancuara në fushën e inxhinierisë biomjekësore, por gjithashtu me aftësi ndërdisiplinore në: - o Teknologjinë e informacionit, - o Shkencat humane dhe sociale, - o Komunikim profesional dhe ndërveprim ndërkulturor, - o Njohuri të gjuhëve të huaja. Programi ofron një kurrikul gjithëpërfshirëse që integron: • Njohuri themelore në shkencat biologjike dhe inxhinierike, • Kurse të avancuara në teknologjitë më të fundit biomjekësore, si nanomjekësia, inxhinieria e indeve dhe ndërveprimi njeri-kompjuter, • Praktika laboratorike dhe projekte praktike për aplikimin e njohurive teorike në situata reale. Kjo qasje integruese, që ndërthur formimin teknik me zhvillimin e kompetencave sociale dhe etike, synon të formojë profesionistë të përgjegjshëm dhe të aftë për të kontribuar në sektorin biomjekësor, brenda dhe jashtë vendit,



	duke iu përgjigjur sfidave të tregut global të punës. Evidenca: - Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore" - Kurrikula e programit të e studimit të ciklit të parë "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore"
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë zhvillimit të lëndëve, personeli akademik orienton studentët në drejtim të zbatimit praktik të njohurive dhe aftësive të fituara, duke ofruar udhëzime specifike për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, të tilla si: • Provimet përfundimtare, • Projektet kërkimore, • Praktikat profesionale, • Detyrat individuale dhe temat praktike. Ky proces synon të fokusohet në rezultatet e pritshme të të nxënit, duke përgatitur studentët për sfidat profesionale dhe akademike që i presin në të ardhmen. Studentët, përveçse njihen me përmbajtjen akademike të lëndës, kanë mundësinë të kërkojnë trajtimin e tematikave të veçanta për të plotësuar objektivat e tyre profesionale. Këto kërkesa, sipas rastit, mund të reflektohen në syllabusin ekzistues të vitit akademik ose të trajtohen si aktivitete jashtësyllabusore. Në përfundim të çdo lënde, kompetencat e përftuara analizohen dhe vlerësohen në mënyrë sistematike: • Personeli akademik kryen diskutime me studentët mbi çështjet kryesore të trajtuara gjatë kursit, • Theksohen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zhvillohen më tej. Në përputhje me politikën institucionale të përmirësimit të vazhdueshëm, syllabuset e lëndëve i nënshtrohen një procesi të rregullt analize dhe rishikimi, bazuar në: • Vlerësimet e studentëve për pedagogët dhe lëndët, • Analizat dhe raportet vjetore të përgatitura nga Këshilli i Departamentit. Në përfundim të çdo viti akademik, në bazë të të dhënave të mbledhura, ndërmerren masa për përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së syllabuseve, në mënyrë që të sigurohet përshtatja e tyre me kërkesat akademike dhe nevojat e tregut të punës, duke filluar zbatimin e ndryshimeve në fillim të vitit akademik pasardhës. Evidenca: - Vizita me stafin - Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor ne Inxhinieri Biomjekesore"

	- Kurrikula e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Universiteti "Western Balkans" (WBU) ka investuar në ndërtimin e një infrastrukture laboratorike moderne dhe të pasur, në funksion të mbështetjes së metodave të mësimdhënies të përcaktuara në syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore". Kjo infrastrukturë, së bashku me angazhimin e personelit akademik të përzgjedhur me kujdes në përputhje me natyrën e lëndës dhe ekspertizën përkatëse, siguron një mjedis interaktiv dhe bashkëpunues, ku nxitet puna në grup, zhvillimi i ideve inovative dhe shprehja e lirë e mendimeve të studentëve. Në kuadër të realizimit të planit mësimor, studentët ndjekin praktikat profesionale në institucione publike dhe kompani private, të caktuara nga universiteti, nën mbikëqyrjen e një pedagogu të ngarkuar nga WBU dhe një përfaqësuesi të institucionit pritës. Praktikrat profesionale janë pjesë integrale e programit dhe vlerësohen me notë, në përputhje me rregulloret akademike të universitetit. Studentët janë të detyruar të respektojnë rregullat dhe disiplinën e institucioneve pritëse gjatë periudhës së praktikës. Në mbështetje të zhvillimit të njohurive praktike, WBU ka implementuar programin EPIC (Education – Practice Integrated Curriculum), i cili u ofron studentëve mundësi për të ndjekur praktika të paguara në institucionet partnere. Studentët me rezultate të larta akademike, të verifikuara deri në momentin e aplikimit, përzgjidhen për të marrë pjesë në këtë program. Për më tepër, studentët e programit janë aktivisht të përfshirë në projekte kërkimore dhe tema diplome nën drejtimin e stafit akademik. Zyra e Kërkimit në WBU ka ngritur një njësi të dedikuar për mbështetjen e studentëve ekselentë në kërkimin shkencor, duke organizuar aktivitete dhe duke i informuar rregullisht për mundësitë e përfshirjes në projekte dhe iniciativa kërkimore. Në funksion të zgjerimit të përvojës akademike dhe profesionale të studentëve dhe stafit akademik, WBU bashkëpunon me institucione të tjera vendase dhe ndërkombëtare për të rritur mundësitë e mobilitetit. Mobiliteti realizohet në formën e: • Projekteve të përbashkëta kërkimore, • Praktikave profesionale, • Vizitave studimore në institucione partnere. Pjesëmarrja në këto mobilitete ndërkombëtare i ofron studentëve një përvojë të pasur dhe të larmishme edukative, duke zgjeruar horizontet e tyre akademike dhe duke i pajisur me aftësi të reja profesionale të domosdoshme për sfidat e

	tregut global të punës. Evidenca: - Manuali i praktikës profesionale për programin të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" - Rregullorja Themelore e WBU, Neni 75 - Manual i Praktikave EPIC - Përfshirja e studentëve të programit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" në projekte kërkimore - Lista e studentëve pjesë e mobiliteteve
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë kuadër, një praktikë e konsoliduar është organizimi i Leksioneve të Hapura, të cilat mbahen përgjatë gjithë vitit akademik në përputhje me një kalendar të miratuar më parë. Këto aktivitete njihen ndryshe edhe si pjesë e iniciativës "WBU Research Seminars", që është integruar në kuadër të Paketës së Instrumenteve të Cilësisë së universitetit. WBU Research Seminars synon: • Të forcojë lidhjen mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, • Të nxisë përfshirjen aktive të studentëve, veçanërisht të studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë "Bachelor" dhe atyre të ciklit të dytë "Master Shkencor", • Të promovojë dialogun akademik mbi temat më aktuale të inovacionit dhe shkencës bashkëkohore, • Të krijojë një hapësirë ndërvepruese midis personelit akademik, studentëve dhe aktorëve të industrisë. Këto seminare dhe leksione të hapura shërbejnë si platforma ideale për përditësimin e njohurive, diskutimin e ideve inovative dhe rritjen e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve të WBU. Evidenca: - Evidenca për WBU Research Seminars - Vizita ne institucion
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konkludon se programi i studimit garanton thellimin e njohurive akademike dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të specializuara të studentëve. Mësimdhënia në program bazohet në qasje kompetencash, duke i mundësuar studentëve të aplikojnë njohuritë e marra përmes punës në laboratorë, praktikave profesionale dhe aktiviteteve kërkimore. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, organizon në mënyrë të rregullt leksione të hapura dhe seminare mbi zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji, brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke e pasuruar procesin mësimor dhe

	duke forcuar ndërveprimin akademik midis studentëve dhe pedagogëve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Universiteti “Western Balkans” ka hartuar dhe implementuar një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse të studentëve, duke siguruar transparencë dhe akses të gjerë në informacion përmes disa kanaleve zyrtare: faqja e internetit e universitetit, komunikimi i drejtpërdrejtë midis studentëve dhe këshilltarëve akademikë, si dhe përmes platformës SMART WBU, ku informacioni përditësohet në kohë reale në llogaritë individuale të studentëve. Kurrikulat e të gjitha programeve të studimit janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit “Western Balkans”, duke i mundësuar studentëve të informohen qartë që në fazën e regjistrimit mbi përmbajtjen e programeve dhe detyrimet përmbyllëse, përfshirë edhe zhvillimin dhe mbrojtjen e diplomës si një lëndë më vete. Në Rregulloren e Programit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, konkretisht në nenet 4, 9 dhe 10, si dhe në Kurrikulën e programit, janë përcaktuar qartë detyrimet përmbyllëse të studentëve, duke përfshirë kryerjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, e cila vlerësohet me 7 ECTS. Modalitetet për realizimin e detyrimeve përmbyllëse në të gjitha ciklet e studimit janë të përcaktuara gjithashtu në: • Statutin e Universitetit “Western Balkans” (Neni 86 dhe Nenet 89–90), • Rregulloren Themelore të WBU (Nenet 84–86 dhe Kreu 14, Nenet 105–109), • Rregulloren për Programet e Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor”, • dhe rregulloret e veçanta të programeve të studimit. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të programit përkatës të studimit përpara procedurës së diplomimit përfundimtar. Në përputhje me vendimin e Senatit Akademik të Universitetit “Western Balkans”,

	studentët e programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përfundojnë studimet e tyre me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome. Evidenca: - Rregullorja e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 4, 9 dhe 10 - Kurrikula e Programit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Statuti i Universitetit "Western Balkans", Nenet 86, 89 - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Nenet 105-109 - Rregullorja për programet e studimit të parë dhe ciklit të dytë" - Vendimi Nr. 2. i Senatit Akademik për punimet e diplomave në "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse të Universitetit "Western Balkans" dhe personeli akademik angazhohen aktivisht për të asistuar studentët në përmbylljen e detyrimeve përfundimtare, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme për realizimin me sukses të tyre. Institucioni ka hartuar dhe miratuar një udhëzues të posaçëm për strukturën e hartimit të tezës së diplomës, i cili i vihet në dispozicion studentëve në mënyrë të qartë dhe transparente. Ky udhëzues shoqërohet me caktimin e një udhëheqësi akademik, që mbështet dhe monitoron studentin gjatë gjithë zhvillimit të punës së diplomës, përgjatë semestrit të gjashtë, në përputhje me kurrikulën dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, Koordinator i Programit, Këshilltari Akademik, Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Udhëheqësit e temave të diplomës luajnë një rol aktiv në: • Dhënien e informacioneve të nevojshme, • Udhëzimin e vazhdueshëm për metodologjinë e punës kërkimore, • Mbështetjen në sigurimin e burimeve akademike dhe materialeve të specializuara, • Ndjekjen e ecursisë së punës së studentëve dhe përgatitjen e tyre për provimin e përgjithshëm të formimit profesional ose mbrojtjen e temës së diplomës. Kjo qasje garanton një proces të strukturuar dhe të mbështetur për realizimin e detyrimeve përfundimtare, duke ndihmuar studentët të përmbyllin me sukses objektivat akademike dhe profesionale të programit të tyre të studimit. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit "Western Balkans", Neni 85



Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për vitin akademik 2024-2025, nuk do të zhvillohet provim final, sipas vendimit të Senatit Akademik. <i>Evidenca:</i> <i>Vendimi Nr. 2. i Senatit Akademik për punimet e diplomave në "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekesore"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës luan një rol thelbësor në orientimin dhe mbështetjen e studentëve në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës. Ai/ajo: • Asiston studentin në përzgjedhjen e temës së punimit në përputhje me objektivat akademike dhe udhëzuesit e miratuar institucionalë. • Ndihmon në përgatitjen dhe përpunimin e rezultateve, si dhe në hartimin e punimit përfundimtar. • Siguron cilësinë shkencore dhe akademike të punimit dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve për paraqitjen përpara Komisionit të Mbrojtjes së Diplomës. Modalitetet që lidhen me përzgjedhjen e temës, udhëheqësit, detyrimet dhe afatet janë përcaktuar në Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" dhe në Udhëzuesin për Përgatitjen e Punimit të Diplomës. Përveç stafit të brendshëm akademik, si udhëheqës mund të angazhohen edhe përfaqësues të institucioneve partnere apo të sektorit të biznesit, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregulloret përkatëse. • Tema e diplomës duhet të jetë një punim individual i studentit. • Pa miratimin me shkrim të udhëheqësit akademik, punimi nuk mund të paraqitet për mbrojtje. • Studenti është i detyruar të dorëzojë në departament tre kopje të punimit së bashku me miratimin e udhëheqësit, të paktën 30 ditë përpara datës së shpallur për mbrojtjen. <i>Evidenca:</i> - <i>Vendimi Nr. 2. i Senatit Akademik për punimet e diplomave në "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekesore"</i> - <i>Udhëzim për përgatitjen e punimit të tezes së diplomës</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në	Studentët e programeve të ciklit të parë në Universitetin "Western Balkans" (WBU) kanë mundësi të kryejnë hulumtime dhe analiza të dhënash si në mjediset e brendshme të institucionit, ashtu edhe në ato të institucioneve partnere.



mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Këto aktivitete zhvillohen nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e personelit akademik, veçanërisht udhëheqësve të tezave. Në këtë kuadër, WBU ka investuar në ndërtimin dhe pajisjen e një infrastrukture laboratorike moderne, e pajisur me teknologjinë më të avancuar, në funksion të aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), laboratorët mësimorë dhe kërkimorë, biblioteka dhe hapësirat e tjera ndihmëse janë të hapura për përdorim nga studentët edhe jashtë orarit të rregullt të mësimi, me qëllim realizimin e praktikave mësimore, zhvillimin e projekteve akademike dhe nismave kërkimore. Përveç infrastrukturës së brendshme, një pjesë e konsiderueshme e matjeve, analizave dhe eksperimenteve mund të realizohen edhe në laboratorët e institucioneve partnere, me të cilat WBU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si: • Grupi i Spitaleve Amerikane, • International Hygea Hospital SH.A, • Cambridge Clinical Laboratories, si dhe të tjera institucione të profilit shëndetësor dhe kërkimor, në varësi të fushës së studimit. Kjo qasje integruese siguron zhvillimin e aftësive praktike dhe kërkimore të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale dhe akademike të së ardhmes. Evidenca: - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Cambridge Clinical Laboratories
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e punimit të diplomës për programet e ciklit të parë "Bachelor" përbën një komponent thelbësor të kurrikulës akademike dhe trajtohet si një lëndë e veçantë brenda planit mësimor. Punimi i diplomës vlerësohet me notë, njësoj si lëndët e tjera të programit të studimit, dhe vlerësimi kryhet në përputhje me: • Sistemin Kombëtar Shqiptar të Vlerësimit, • Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), • Sistemin Amerikan të Vlerësimit, të cilët janë të zbatuar në institucion. Detyrimet, komponentët e vlerësimit dhe mënyra e realizimit të punimit të diplomës përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të detajuar në syllabus-in e lëndës "Temë Diplome", i cili u prezantohet studentëve dhe është i aksesueshëm përmes platformës SMART WBU.

	Evidenca: - Syllabus i lëndës "Temë diplome" për programin e Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti i programit të ciklit të parë "Bachelor" ka të drejtë të paraqitet për mbrojtjen e temës së diplomës vetëm pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet akademike të përcaktuara në planin e studimit. Në rast të kundërt, studenti duhet të përmbushë detyrimet e mbetura gjatë semestrit pasardhës dhe mund të diplomohet vetëm pasi të ketë përfunduar me sukses të gjitha kërkesat akademike. Sipas përcaktimeve të Nenit 89 të Rregullores Themelore të Universitetit "Western Balkans", për t'u diplomuar, studenti duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të vlerësimeve jo më pak se 7.0 (shtatë). Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha kërkesat akademike pajisen me diplomën përkatëse të studimeve, në përputhje me dispozitat e Nenit 86 të Rregullores Themelore të WBU. Diploma përbën dokument zyrtar të institucionit dhe lëshohet me shkrim të qartë dhe bojë teknike, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e të diplomuarit, gradën dhe titullin shkencor të rektorit dhe dekanit, të cilat shoqërohen me vulën zyrtare të universitetit. Diploma dhe suplementi i diplomës përgatiten dhe lëshohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Tërheqja e tyre kryhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe regjistrohet në librin përkatës të evidencës së diplomave. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 86 - Model diplome
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Universiteti garanton administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të studentëve, në formë fizike dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni siguron gjithashtu ofrimin e informacionit të kërkuar rast pas rasti, duke respektuar standardet e mbrojtjes së të dhënave personale. Dokumentacioni i studentëve ruhet sipas dispozitave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe në përputhje me Nenit 46 të Rregullores Themelore të WBU. Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës është përgjegjëse për arkivimin, administrimin dhe përdorimin efektiv të dokumenteve të institucionit dhe të studentëve. Në kuadër të ruajtjes së dokumentacionit, WBU disponon një bazë të dhënash të përditësuar, e cila përfshin: • Regjistrimet e studentëve, • Numrat e matrikullimit, • Vlerësimet akademike dhe performancën në studime,

	• Diplomat dhe suplementet përkatëse. Roli i Sekretarisë Mësimore Sekretaria Mësimore, në zbatim të Nenit 31 të Rregullores për Organizimin Administrativ të WBU, është njësia përgjegjëse për: • Organizimin, monitorimin dhe arkivimin e regjistrimeve dhe dokumenteve të studentëve, • Mbajtjen e regjistrit bazë të të dhënave të studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të diplomuar, • Menaxhimin e regjistrit për diplomat dhe suplementet përkatëse. Të dhënat e studentëve ruhen dhe përpunohen duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Proceset e ruajtjes dhe përpunimit kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave dhe respektimin e privatësisë së studentëve. Dixhitalizimi dhe Menaxhimi Elektronik i të Dhënave Përmes platformës SMART WBU, institucioni ka dixhitalizuar administrimin e dokumentacionit të studentëve, duke mundësuar aksesin e kontrolluar dhe të sigurt të të dhënave akademike. Mbledhja dhe analizimi i statistikave realizohet nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, duke siguruar monitorim dhe raportim të saktë për proceset akademike dhe administrative. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 46 - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 122-123 - Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale - Kontrata për SMART WBU - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se FETI ka hartuar dhe zbatuar një rregullore të posaçme për organizimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të punimit të diplomës. Në Rregulloren e Programit të Studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" përcaktohet qartë: Pragu i notës mesatare të nevojshme që i jep të drejtën studentit për përgatitjen e punimit të diplomës. Procedurat dhe udhëzimet për realizimin e suksesshëm të detyrimeve përmbyllëse. Universiteti "Western Balkans" garanton ruajtjen e dokumentacionit akademik të studentëve në formë fizike dhe elektronike, administrimin e të dhënave në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, ofrimin e informacionit të dokumentuar për



	<i>studentët kur kërkohet, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e brendshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se institucioni ka kushtuar vëmendje përputhjes ndërmjet fushës kërkimore të personelit akademik dhe disiplinave që ata mbulojnë në programin e studimit “Bachelor” në Inxhinieri Biomjekësore. Personeli akademik i angazhuar në këtë program rezulton të jetë i kualifikuar dhe kompetent, si në aspektin shkencor, ashtu edhe në aftësitë pedagogjike, duke përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies me në qendër studentin. Gjithashtu, u vërejt që si personeli efektiv me kohë të plotë, ashtu edhe ai me kontratë të pjesshme, si dhe personeli ndihmës akademik, janë përzgjedhur në përputhje me kriteret ligjore dhe me një logjikë funksionale lidhur me fushat që mbulojnë. Vlerësohet pozitivisht fakti që përzgjedhja e stafit është bërë në bazë të ekspertizës përkatëse dhe kontributit që secili mund të japë në realizimin cilësor të programit. Në kuadër të politikës së “brain gain”, është evident një përpjekje e qëndrueshme për të integruar në stafin akademik individë të diplomuar apo doktoruar jashtë vendit. Referuar të dhënave të marra mbas vizitës në institucion, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike është me kualifikimin si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	2	-
Prof. Asoc.	1	-	1	-	1	1
Dr./PhD.	5	3	6	3	11	3
Msc.	7	2	5	1	8	-
Totali	13	5	12	4	22	4

Nga sa më sipër rrzulton që personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, është në përputhje me parashikimet ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), ku personeli akademik, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

Sipas të dhënave të paraqitura, 33% e stafit akademik të institucionit dhe rreth 55% e stafit të angazhuar në këtë program kanë përfunduar studimet në institucione të huaja, çka përbën një vlerë të shtuar në aspektin e ndërkombëtarizimit dhe cilësisë së mësimdhënies.

Shqetësim për t'u adresuar është fakti se nga shqyrtimi i syllabuseve, janë evidentuar në shumicën e rasteve, ku titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Dr", në kundërshtim me pika 3, neni 59, i Ligjit 80/2015.

GVJ rekomandon që të merren masa që titullarët e lëndëve të jenë në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi.

Evidenca:
Personeli akademik i diplomuar jashtë vendit
Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.
Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Aneks. Tabelat Përmbledhëse. Tabelat 1 dhe 2)
Evidenca 2.6 Syllabuset e lendeve;

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistat e zhvilluara, konstatohet se institucioni respekton kornizën ligjore në fuqi lidhur me ngarkesën mësimore të personelit akademik me kohë të plotë. Në programin e ciklit të parë "Bachelor" në Inxhinieri Biomjekësore, të gjithë titullarët e lëndëve zotërojnë gradën shkencore "Doktor" ose mbajnë titullin
---	--

“Profesor”, çka tregon për një nivel të lartë kualifikimi të stafit akademik që garanton cilësinë e procesit mësimor.

Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 marrë mbas vizitës në institucion) jepet në vijim dhe është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	585	465	120	80% / 20 %
2023-2024	960	840	120	87% / 13 %
2024-2025	2010	1830	180	91% / 9 %

Ngarkesa mësimore për secilin anëtar të stafit përcaktohet sipas udhëzimeve të brendshme të institucionit, të harmonizuara me ligjin dhe aktet nënligjore, duke marrë në konsideratë edhe përfshirjen në projekte kërkimore dhe angazhimet administrative. Për personelin akademik (përfshirë funksionet drejtuese si Rektor, Zëvendësrektor dhe Dekan), ngarkesa minimale javore është 8 orë mësimore, ndërsa për personelin me kohë të pjesshme është e përcaktuar në 120 orë vjetore. Gjithashtu, institucioni mbështet dhe inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik në mobilitete ndërkombëtare, projekte kërkimore dhe veprimtari të tjera shkencore, duke reflektuar këtë mbështetje përmes lehtësimit të ngarkesës mësimore dhe administrative në rastet përkatëse. Kjo qasje kontribuon në zhvillimin profesional të stafit dhe në rritjen e cilësisë akademike të programit.

Evidenca:

- Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 6.1-6.3 dhe 7)
- Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor ne Inxhinieri Biomjeksore” gjatë vitit akademik 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025 (Aneks. Tabelat Përmbledhëse, Tabela 4)
- Udhëzim për ngarkesën mësimore të personelit akademik në Universitetin “Western Balkans”
- Përcaktimi i objektivave të kërkimit shkencor



Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar DVV, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në Inxhinieri Biomjeksore dhe Departamentit Bioshkencave dhe Inxhinierisë. Punësimi i stafit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Evidenca: - Politika e zhvillimit të stafit akademik të Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë - Lista e stafit akademik sipas njësive bazë - Kontrata e punës së personelit akademik - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital S.H.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital S.H.A - Kontrata e ruajtjes fizike - Akti higjeno-sanitar - Akti i mbrojtjes nga zjarri
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	RVB dhe dokumentacioni i DVV paraqet qartë procedure e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë përcakton kriteret të cilat përcillen dhe miratohen nga Drejtuesi i saj, më pas përcillen në Rektorat. Praktika e punësimit në WBU, përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit <i>ad hoc</i> që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në fund personeli pajiset me kontratën individuale. Evidenca: - Statuti i Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit - Linku për publikimin e vendeve të lira të punës - Procedura e punësimit të stafit - Kontrata e punës së personelit akademik - Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <i>Evidenca 4.13. Praktika e punësimit në WBU;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës	Gjatë vlerësimit u konstatua se programi "Inxhinieri Biomjeksore" mbështetet nga personel ndihmës me profil të përshtatshëm profesional, i angazhuar në realizimin e veprimtarive praktike dhe kërkimore në laboratorë. Struktura dhe përbërja e këtij personeli i përgjigjet kërkesave të programit dhe siguron funksionimin efikas të mjediseve didaktike. Gjithashtu, organizimi administrativ në nivel fakulteti kontribuon në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar në mbështetjen e procesit mësimor dhe praktik. Evidenca:



specifike të programit të studimit.	- Rregullorja mbi organizimin akademik - Lista e personelit asistent lektor, ndihmës akademik/administrativ i angazhuar për realizimin e programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Evidenca 1.14. Rregullorja mbi organizimin akademik të Universitetit "Western Balkans", Neni 32 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, Nenet 21-23 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullorja e Programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" Biomjekësore"
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga analiza e dokumentacionit dhe intervistat me aktorët përkatës, rezultojnë se Universiteti "Western Balkans" ka ngritur një sistem funksional dhe të dokumentuar të menaxhimit të personelit akademik dhe ndihmës të përfshirë në realizimin e programeve të studimit, përfshirë edhe programin "Inxhinieri Biomjekësore". Institucioni demonstroi një qasje të konsoliduar në menaxhimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin "Inxhinieri Biomjekësore", në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për çdo vit akademik, Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh, përpunon dhe përditëson informacionin e detajuar mbi stafin akademik, ndihmës dhe administrativ, si dhe për përgjegjësin e programit. Këto të dhëna përfshijnë angazhimin individual për çdo semestër, detyrat përkatëse dhe çdo ndryshim që ndodh gjatë vitit akademik. Evidentimi i stafit realizohet përmes një sistemi të brendshëm të organizuar dhe të aksesueshëm vetëm nga personeli i autorizuar, në përputhje me standardet e konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit. Këto praktika tregojnë se institucioni zotëron kapacitete funksionale për të garantuar integritetin dhe transparencën e të dhënave të stafit, duke kontribuar në organizimin efikas të programit të studimit dhe në garantimin e cilësisë së burimeve njerëzore të përfshira në të. Evidenca: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans"
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e	Universiteti "Western Balkans" ka zhvilluar një politikë bashkëpunimi të qëndrueshme dhe funksionale me institucione akademike, kompani dhe njësi të sektorit privat, që kontribuojnë drejtpërdrejt në përfshirjen e studentëve të programit "Inxhinieri Biomjekësore" në veprimtari praktike, punë kërkimore dhe zhvillim diplomash. Marrëveshjet

mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtaritë tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	ndërinstitucionale sigurojnë angazhimin të personelit të jashtëm me përvojë profesionale në fushën përkatëse, duke garantuar mbikëqyrje dhe instruktim të specializuar gjatë praktikës profesionale dhe përgatitjes së temave të diplomës. Instruktimi i studentëve realizohet në bashkëpunim me stafit të brendshëm akademik dhe ekspertëve të fushës, të cilët përzgjidhen në funksion të profilit të temës dhe natyrës së veprimtarisë praktike. Ky model mbështetet në struktura vendimmarrëse të qarta dhe të dokumentuara, ku njësitë bazë propozojnë temat e diplomës dhe përbërjen e komisioneve, ndërsa miratimi final jepet nga organet drejtuese të fakultetit. Kjo praktikë garanton transparencë, integritet akademik dhe përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale. Përfshirja e përfaqësuesve të industrisë dhe institucioneve të punës si mbikëqyrës praktikash dhe udhëheqës diplomash përfaqëson një vlerë të shtuar për programin, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve dhe në përgatitjen e tyre për integrim të suksesshëm në tregun e punës. Evidenca: - Lista e institucioneve akademike partnere - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 26, pikat p dhe q, Neni 52, pika e dhe n - Lista e temave të diplomave 2024-2025
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Universiteti “Western Balkans” ka krijuar një model të institucionalizuar dhe të monitoruar për zhvillimin e praktikave profesionale, veçanërisht në programet që kërkojnë aftësi të avancuara teknike dhe ndërdisiplinare, si “Inxhinieri Biomjekësore”. Marrëveshjet dypalëshe me institucione pritëse të profilit të lartë, si American Hospital SH.A, International Hygea Hospital SH.A dhe Cambridge Clinical Laboratories, garantojnë angazhimin aktiv të personelit mbikëqyrës nga institucionet pritëse në të gjitha etapat e praktikës. Dosja individuale e praktikës përfshin raportin e studentit, vlerësimin nga mbikëqyrësi i jashtëm dhe rezultatet përkatëse, të cilat ndikojnë në notën përfundimtare të modulit të praktikës si pjesë integrale e vlerësimit akademik. Praktikat zhvillohen në grupe të vogla, duke mundësuar ndihmë të drejtpërdrejtë dhe ndërveprim të vazhdueshëm me mbikëqyrësin në ambientin pritës. Kjo qasje siguron jo vetëm cilësi në realizimin e objektivave të praktikës, por edhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve në kushte reale pune. Gjithashtu, vlen të theksohet programi



	EPIC (Education Practice – Integrated Curriculum), i cili institucionalizon lidhjen mes teorisë dhe praktikës në një format të integruar, duke përfshirë trajnime, projekte dhe praktika profesionale me vlerësim të strukturuar dhe pjesëmarrje aktive të partnerëve të jashtëm. Evidenca: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 73, 102 dhe 103 - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe Shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Cambrige Clinical Laboratories - Manuali i praktikës profesionale për programin të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" - Marrëveshja e bashkëpunimit të WBU me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe shoqërinë International Hygea Hospital SH.A - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 73, 102 dhe 103			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" ka ndërtuar një strukturë funksionale dhe të qëndrueshme për menaxhimin e personelit akademik, ndihmës dhe administrativ, në përputhje me kornizën ligjore kombëtare dhe me aktet e brendshme rregullative. Politikat e zhvillimit të stafit përfshijnë rekrutimin transparent, promovimin mbi baza meritokracie dhe kujdesin për mirëqenien e punonjësve përmes përfitimeve shtesë dhe marrëveshjeve shëndetësore. Strukturimi i personelit ndihmës akademik dhe administrativ është në funksion të objektivave akademike dhe mbështetjes së veprimtarisë kërkimore dhe mësimore. Zyra e Burimeve Njerëzore ka rol qendror në menaxhimin e ciklit të plotë të punësimit dhe zhvillimit të stafit, duke garantuar dokumentim, përditësim dhe trajnim të vazhdueshëm. <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni të marrë masa që titullarët e lëndëve të jenë në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se Universiteti “Western Balkans” demonstroi një strukturë infrastrukturore të konsoliduar, që përputhet me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe me nevojat specifike të zhvillimit të veprimtarisë mësimore, në raport me numrin e studentëve dhe natyrën e programeve të studimit. Mjediset mësimore dhe ndihmëse janë të organizuara brenda një kampusi universitar me tre godina funksionale, të cilat përfshijnë hapësira të specializuara për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe administrim. Struktura fizike përfshin 27 auditorë dhe 27 laboratorë didaktikë, të pajisur për zhvillimin e praktikave sipas karakteristikave të programeve, duke garantuar mjedise të përshtatshme për çdo modul të planifikuar. Gjithashtu, pranë infrastrukturës ndodhen salla për konferenca dhe aktivitete studentore, ambiente sociale dhe sportive, si dhe shërbime mbështetëse që rrisin cilësinë e përvojës studentore. Mjediset janë të standardizuara për nga ndriçimi, ajrosja, siguria dhe aksesueshmëria, duke përfshirë elementë si shkallë emergjence dhe ashensorë funksionalë. Zyrat për stafin akademik dhe administrativ janë të mjaftueshme në numër (40 zyra), ndërkohë që janë përmbushur standardet higjieno-sanitare në të gjitha godinat. Evidencat: - Fragmenti i Hartës Kadastrale të WBU - Planimetria e Kampusit Universitar - Kontrata e qerasë së godinave dhe certifikata e pronësisë - Kontratë sipërmarrje punimesh - Akti higjieno-sanitar - Akti i mbrojtjes nga zjarri
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore	Universiteti “Western Balkans” ofron ambiente mësimore dhe laboratorike të pajisura me teknologji bashkëkohore, përfshirë tabela inteligjente dhe pajisje të informacionit dhe komunikimit, që mbështesin metodologjitë moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mjediset janë ergonomike, me ndriçim natyror dhe sisteme të ventilimit dhe klimatizimit, që sigurojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit akademik gjatë gjithë vitit. Laboratorët janë të pajisur me instrumente të specializuara dhe përdoren nën mbikëqyrjen e personelit të kualifikuar, duke garantuar praktikë të sigurt dhe efektive. Po ashtu, zyrat e stafit akademik dhe administrativ janë të pajisura për të siguruar kushte pune komode dhe funksionale. Kjo



të mësimdhënies-mësimnxënies.	infrastrukturë teknologjike dhe ambientale kontribuon në zhvillimin e një procesi mësimor të integruar, teorik dhe praktik. Evidencat: - Plan shpërndarja e Smart Boards nëpër klasa - Model Inventar i zyrës së personelit akademik
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga verifikimi i dokumentacionit, vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe intervistave me përfaqësues institucionalë, konstatohet se infrastruktura laboratorike e universitetit është në përputhje të mirë me kërkesat për zhvillimin e komponentëve praktikë të programeve të studimit. Numri dhe larmia e laboratorëve të ngritur mbulojnë një gamë të gjerë të fushave të studimit dhe janë të pajisur me aparatura funksionale dhe bashkëkohore, që i shërbejnë zbatimit të moduleve në aspektin teorik dhe praktik. Prania e manualeve specifike për përdorimin e laboratorëve dhe masat e zbatuara për sigurinë dhe menaxhimin e mbetjeve tregojnë për standardizim të brendshëm dhe përkujdesje për sigurinë dhe aspektet mjedisore. Aksesueshmëria për studentët, përfshirja e stafit të specializuar në menaxhimin e këtyre mjedisëve, si dhe mbështetja infrastrukturore teknike dhe logjistike, krijojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave praktike. Në këtë kuadër, vlerësohet se standardet përkatëse për infrastrukturën praktike të programeve të studimit janë të përmbushura në mënyrë të kënaqshme dhe mbështesin realizimin e objektivave formues të planifikuara në kurrikulë. Evidencat: - Lista e laboratorëve të WBU - Inventar laborator - Manualët e Laboratorëve - Marrëveshja për evadimin e mbetjeve laboratorike
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vëzhgimi në terren dhe dokumentacioni i paraqitur, rezulton se institucioni ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në ndërtimin dhe funksionalizimin e laboratorëve të teknologjisë së informacionit, në përputhje me natyrën e programeve të studimit që ofron. Prania e tre laboratorëve të specializuar në fusha si intelijenca artificiale, siguria kibernetike dhe inxhinieria software, të pajisur me infrastrukturë moderne dhe programe profesionale, përbën një tregues pozitiv të angazhimit për zhvillimin e komponentëve praktikë në mësimdhënie.



	Gjithashtu, përdorimi i teknologjisë në funksion të administrimit institucional dhe mësimdhënies – përmes platformës SMART, pajisjes së sallave me smartboards, aksesit në internet dhe burimeve digjitale – tregon për një integrim të mirë të teknologjisë në funksion të cilësisë akademike. Laboratori i Realitetit Virtual përfaqëson një element inovativ që zgjeron mundësitë ndërdisiplinore dhe kontribuon në krijimin e përvojave të avancuara mësimore. Pajisja dhe trajnimi i stafit akademik dhe administrativ me mjete TIK përforcon funksionalitetin dhe ndërveprimin digjital në institucion. Në tërësi, konstatohet se infrastruktura teknologjike dhe përdorimi i saj përmbush standardet përkatëse, duke mbështetur zhvillimin profesional të studentëve dhe mbarëvajtjen e proceseve institucionale. Evidencat: - Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit Smart-WBU - Kontrata për shërbimi - Lista e laboratorëve të WBU - Lista e aseteve teknologjike - Dokumenti i abonimit në JSTOR - Akses në Research4Life - Model Inventar i zyrës së personelit akademik - Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU në internetit			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" paraqet një infrastrukturë të zhvilluar dhe të mirëorganizuar, në përputhje me natyrën dhe kërkesat e programeve të tij të studimit. Ambientet mësimore, laboratorët dhe hapësirat e dedikuara për personelin dhe studentët janë të pajisura me mjete bashkëkohore dhe ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit akademik dhe praktik. Në tërësi, infrastruktura dhe logjistika e ofruar nga institucioni vlerësohet si e përshtatshme dhe në përputhje me standardet e arsimit të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga verifikimi në terren, rezulton se institucioni ka ndërmarrë masa të qarta për të garantuar literaturën bazë dhe ndihmëse në përputhje me natyrën dhe gjuhën e programeve të studimit që ofron. Përdorimi i literaturës në dy formate – fizike dhe digjitale – si dhe qasja në burime ndërkombëtare të njohura, përbën një praktikë të konsoliduar që mbështet në mënyrë efektive procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Vërehet një përpjekje për përditësim të rregullt të literaturës në fillim të çdo viti akademik, si dhe orientim drejt burimeve të standardeve të larta ndërkombëtare, çka përmbush pritshmëritë lidhur me cilësinë, aktualitetin dhe relevancën e materialeve studimore. Për më tepër, respektimi i gjuhës së programit për literaturën e vënë në dispozicion është në përputhje me kërkesat standarde dhe ndihmon në sigurimin e një përvoje të përshtatshme akademike për studentët. Në tërësi, përmbushen kërkesat për garantimin e literaturës së nevojshme dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të programeve të studimit. Evidencat: - Dokumenti i abonimit në JSTORE - Akses në Research4Life - Lista e librave (Fondi i Bibliotekës) - Lista e lëndëve të kurrikulës mësimore të programit të studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore"
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se institucioni ka strukturuar një mekanizëm funksional për menaxhimin dhe përditësimin e literaturës, në përputhje me kërkesat standarde të cilësisë në arsimin e lartë. Zyra përkatëse pranë bibliotekës, në bashkëpunim me personelin akademik dhe njësitë mësimore, kryen përditësimet të rregullta të literaturës dhe siguron qasje në burime të besueshme dhe të përditësuara ndërkombëtare. Raportimi i periodik i përditësimeve dhe mekanizmat e monitorimit të procesit të pasurimit të fondit të bibliotekës përmes blerjeve, dhurimeve apo abonimeve online tregojnë për një angazhim të qëndrueshëm institucional për të garantuar literaturën më të fundit dhe në përputhje me nevojat reale të programeve të studimit. Përfshirja e stafit akademik në këtë proces përmes përditësimit të syllabus-eve përforcon më tej këtë praktikë të mirë. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans - Lista e librave (Fondi i Bibliotekës) - Dokumenti i abonimit në JSTORE

	- Akses në Research4Life - Rregullorja e Bibliotekës - Praktika e kërkesës për pasurimin e fondit të bibliotekës
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe informacionin e ofruar, konstatohet se Universiteti "Western Balkans" ka ngritur një bibliotekë funksionale akademike që ofron akses të gjerë dhe të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin në një gamë të gjerë burimesh mësimore dhe kërkimore. Këto përfshijnë burime të shtypura fizike, burime elektronike dhe burime online të aksesueshme përmes platformës së bibliotekës dhe rrjetit të institucionit. Sistemi i hyrjes dhe përdorimit të burimeve është i organizuar dhe ndjek standarde të përcaktuara, duke siguruar akses të decentralizuar përmes autentifikimit individual. Po ashtu, ofrohet asistencë nga stafi i bibliotekës, çka ndihmon në orientimin e përdoruesve për shfrytëzimin e duhur të materialeve në funksion të objektivave mësimore dhe kërkimore. Në përputhje me standardet përkatëse, rezultojnë se biblioteka universitare garanton përdorim të barabartë të burimeve nga të gjithë studentët dhe krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e procesit mësimor, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Evidenca: - Rregullorja e Bibliotekës
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në përputhje me standardet e kërkuara, rezultojnë se Biblioteka e Universitetit "Western Balkans" është e pajisur me një fond të konsiderueshëm materialesh fizike dhe digjitale. Ajo ofron tekste bazë, literaturë ndihmëse dhe revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja, në përputhje me natyrën dhe specifikat e moduleve mësimore në të gjitha programet e ofruara nga institucioni. Përmbajtja e fondit pasqyron qartë një qasje të kujdesshme ndaj përputhjes me kurrikulën, duke u shpërndarë në mënyrë të balancuar sipas fushave të studimit, si mjekësi, inxhinieri, ekonomi, teknologji, shkenca humane, gjuhë dhe letërsi. Kjo e bën bibliotekën një burim të domosdoshëm dhe mbështetës për zhvillimin akademik të studentëve dhe për realizimin efektiv të objektivave të çdo programi studimi. Në këtë kuadër, mund të konstatohet se biblioteka universitare përmbush me efektivitet kërkesat për përmbajtjen dhe diversitetin e fondit bibliografik, duke garantuar akses të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për



	studentët në funksion të përvetësimit të njohurive dhe kompetencave akademike. Evidencat: - Lista e librave (Fondi i Bibliotekës)
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e Universitetit “Western Balkans” siguron një qasje të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë përdoruesit—studentë, staf akademik dhe administrativ—në të gjitha burimet që ofron, si ato fizike, ashtu edhe ato elektronike dhe online. Kjo qasje është e garantuar përmes një infrastrukture të përshtatur teknologjikut dhe të organizuar administrativisht, që lejon përdorimin e burimeve në ambientet e institucionit, si dhe në mënyrë të decentralizuar përmes autentifikimeve elektronike. Aksesimi i burimeve online jashtë ambienteve të institucionit mundësohet në mënyrë të sigurt përmes sistemit të verifikimit të përdoruesve, çka i mundëson çdo student të përfitojë në mënyrë të barabartë nga materialet dhe shërbimet, pavarësisht vendndodhjes së tij. Gjithashtu, rregullat që garantojnë përdorimin korrekt dhe etik të burimeve janë të qarta, të miratuara dhe lehtësisht të aksesueshme online. Në këtë mënyrë, konstatohet se janë krijuar kushtet e nevojshme për të garantuar akses të drejtë dhe të barabartë për të gjithë studentët në bibliotekën e institucionit dhe në burimet digjitale përkatëse, në përputhje me standardet që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm akademik dhe barazinë në arsim. Evidencat: - Rregullorja e Bibliotekës - Rregullat e Bibliotekës në Universitetin Western Balkans - Rregullat e Bibliotekës në Universitetin Western Balkans
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa	Biblioteka e Universitetit “Western Balkans” ofron një mjedis të përshtatshëm dhe të pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike moderne, që sigurojnë akses të pakufizuar për të gjithë studentët.



kufizim për të gjithë studentët.	Hapësirat e bibliotekës janë të pajisura me kompjutera të lidhur në rrjetin e institucionit, përmes të cilëve mundësohet qasja e plotë në burimet elektronike. Njëkohësisht, qasja në këto burime është e mundur edhe nga jashtë kampusit, përmes autentifikimit në Pikën Qendrore të Regjistrimit, duke respektuar marrëveshjet e licencimit dhe ligjin për të drejtën e autorit. Përveç infrastrukturës teknologjike, biblioteka ka në dispozicion edhe staf të trajnuar, i cili asiston përdoruesit në kërkimin dhe përdorimin e burimeve fizike dhe digjitale. Të gjitha këto elemente krijojnë një ambient të favorshëm për kërkimin shkencor dhe zhvillimin akademik të studentëve, pa asnjë kufizim në përdorim. Evidencat: - Rregullorja e Bibliotekës
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e Universitetit “Western Balkans” ofron shërbime të përshtatura me nevojat e studentëve dhe të procesit mësimor. Orari i funksionimit fizik i bibliotekës, nga ora 08:30 deri në 16:30, përputhet me zhvillimin e mësimi dhe është bërë publik në mjediset e bibliotekës dhe në faqen zyrtare të institucionit, duke garantuar transparencë dhe akses të lehtë për të gjithë përdoruesit. Fondi digjital i bibliotekës është i aksesueshëm 24/7, përmes platformës “SMART-WBU” (https://wbu.easy-web.cloud/), gjë që u mundëson studentëve dhe personelit akademik të kenë qasje në burimet elektronike pa kufizime kohore apo fizike. Biblioteka ofron gjithashtu mundësi huazimi të burimeve fizike, akses falas në internet, si dhe rezervim të hapësirave për studim në një mjedis që ka kapacitet mbi 100 vende uljeje dhe mbi 260 anëtarë aktivë, duke përmbushur nevojat sipas numrit të studentëve dhe kapaciteteve të infrastrukturës. Kjo strukturë e organizuar dhe fleksibile bën që biblioteka të funksionojë si një pikë kyçe mbështetëse për jetën akademike të studentëve dhe stafit në WBU. Evidencat: - Rregullat e Bibliotekës në Universitetin Western Balkans - Rregullorja e Bibliotekës
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës	Biblioteka e Universitetit Western Balkans zbaton një proces të rregullt dhe të detajuar monitorimi dhe raportimi mbi fondin e saj. Biblioteka ndjek në mënyrë të vazhdueshme dhe informon në kohë reale personelin akademik, njësitë bazë



dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	dhe ato kryesore përgjegjëse për programet e studimit, lidhur me prurjet e reja të fondit, si fizik ashtu edhe online. Në bashkëpunim me strukturat përkatëse të programeve të studimit, ajo monitoron cilësinë e fondit fizik dhe online, duke përfshirë titujt kryesorë që mbështesin zhvillimin e lëndëve të programit. Raportimi përfshin përditësimin e fondit me botime të reja, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, përdorimin e sallave të studimit, si dhe efektivitetin e përpjekjeve për pasurimin e burimeve. Biblioteka merr parasysh edhe kërkesat për tituj të rinj dhe ndjek performancën e personelit akademik në lidhje me përdorimin e literaturës. Priorja është të pasurohet fondi me botime të fundit nga shtëpi botuese prestigjioze ndërkombëtare, si Springer, Taylor and Francis, Willis, etj., duke garantuar cilësi dhe relevancë. Ky bashkëpunim i ngushtë dhe procesi i monitorimit garanton që fondi i bibliotekës të jetë i përshtatshëm, i freskët dhe i orientuar drejt nevojave të programeve të studimit dhe komunitetit akademik. Evidencat: - Praktikë për informimin e personelit akademik për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës/ Raporti vjetor i bibliotekës së WBU 2022-2023.			
	<i>Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se Universiteti "Western Balkans" garanton një infrastrukturë të mirëorganizuar bibliografike, me literaturë bashkëkohore, të aksesueshme fizikisht dhe në format digjital. Politikat për përditësimin e burimeve dhe bashkëpunimi me databaza ndërkombëtare sigurojnë mbështetje cilësore për procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Ky komponent vlerësohet në përputhje me standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti Western Balkans (WBU) përmbush në mënyrë të plotë Kriterin 1 duke përdorur një sistem të avancuar të menaxhimit të informacionit për studentët dhe aktivitetet e tyre akademike, i cili është i integruar në platformën SMART WBU: - SMART WBU siguron informatizimin dhe digjitalizimin e dokumentacionit dhe proceseve të lidhura me studentët, duke përfshirë regjistrimin, monitorimin e aktivitetit akademik, vlerësimet, transkriptet dhe dokumentacionin për diplomim. - Menaxhimi i të dhënave është i organizuar dhe i përcaktuar qartë në bazë të statutit të universitetit dhe rregulloreve përkatëse, duke respektuar normat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimin e konfidencialitetit. - Zyra e Sekretarisë Mësimore është përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe arkivimin e të gjitha të dhënave që lidhen me studentët, duke ruajtur regjistrin bazë dhe dokumentacionin për çdo fazë të studimeve të tyre. - Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës menaxhon ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve institucionale në format fizik dhe elektronik, duke siguruar qasje të organizuar dhe të kontrolluar. Sistemi lejon akses dhe përpunim të informacionit nga regjistrimi deri në diplomim, si dhe ruajtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky sistem i menaxhimit bën që WBU të ketë një administrim efikas, të sigurt dhe transparent të të dhënave studentore gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 4 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 122 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 79 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 46 - Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 122-123 - Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Universiteti Western Balkans përmes një sistemi të brendshëm të menaxhimit që administron në mënyrë efektive



administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programeve të studimit: Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit, duke përfshirë edhe informacionin për lëvizjet brenda departamenteve sipas nevojave të fakulteteve dhe fushës së mësimdhënies. Sistemi administron të dhënat për të gjithë personelin e angazhuar në programet e studimit, duke përfshirë detajet e angazhimit të çdo anëtarit për çdo semestër dhe vit akademik. Ky menaxhim i mirëorganizuar garanton një administrim të saktë dhe të plotë të burimeve njerëzore në përputhje me nevojat e fakulteteve dhe kërkesat institucionale. Në këtë mënyrë, WBU siguron një sistem të strukturuar dhe transparent të menaxhimit të personelit që mbështet realizimin cilësor të programeve akademike. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 32. - Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Universiteti Western Balkans ofron një sistem menaxhimi që siguron: • Akses të dedikuar dhe të hapur në informacionet dhe dokumentet për të gjithë personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, përfshirë ciklin e parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore". • Të dhënat publike të programit, si emërtimi, kurrikula, departamenti dhe fakulteti përgjegjës, personeli akademik që ofron programin, etj., janë të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit, duke garantuar transparencë dhe qasje të lehtë për interesuarit, qofshin studentë apo jo. • Ky akses sigurohet duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë mënyrë, WBU promovon transparencën dhe aksesin e informacionit për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin arsimor dhe publikun e gjerë. Evidencat:



	- Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Universiteti Western Balkans siguron një sistem menaxhimi modern dhe gjithëpërfshirës, ku: Platforma SMART-WBU integron module të ndryshme që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni midis personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve. Studentët, përmes llogarive të tyre personale, kanë akses në informacion të detajuar mbi programin e studimit, përfshirë sylabuset, vlerësimin e vazhduar, prezencën, komunikimin me këshilltarët akademikë dhe lidhje me sekretarinë mësimore. Të gjithë anëtarët e komunitetit universitar pajisen me adresa zyrtare elektronike për komunikim të brendshëm përmes platformës SMART-WBU, duke mundësuar ndërveprim të drejtpërdrejtë mbi procesin mësimor dhe aktivitete të tjera institucionale. Institucioni siguron orientim dhe mbështetje për studentët e rinj dhe gjatë gjithë vitit akademik përmes Zyrës së Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, si dhe përmes këshilltarëve akademikë që monitorojnë vijueshmërinë dhe suksesin akademik të studentëve. WBU publikon vazhdimisht udhëzues të detajuar (guidën e studentit) dhe informacione të përditësuara në faqen e internetit për të mbështetur informimin dhe komunikimin efektiv. Ky sistem garanton një komunikim të shpejtë, transparent dhe gjithëpërfshirës në përrputhje me nevojat dhe kërkesat e procesit mësimor dhe administrativ. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 43 - Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/organizimi i aktiviteteve informuese - Guida e studentit - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Neni 6.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna	Universiteti Western Balkans përmes sistemit të tij të menaxhimit: • Siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ për të gjithë personelin dhe strukturat e universitetit. • Lehtëson raportime individuale periodike nga personeli akademik dhe administrativ, të cilat

në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	dorëzohen pranë departamenteve përkatëse dhe autoriteteve drejtuese të universitetit. • Përdor platformën e avancuar SMART-WBU (https://wbu.easy-web.cloud/, https://smart.wbu.edu.al/) si një mjet kyç për monitorimin dhe raportimin në kohë reale. • Mundëson akses të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në të dhëna të sakta dhe të përditësuara për organet drejtuese, duke përmirësuar efektivitetin e vendimmarrjes dhe transparencën institucionale. Ky sistem modern garanton një menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm të aktiviteteve akademike dhe administrative brenda institucionit. <i>Evidencat:</i> platforma "SMART-WBU" https://WBU.easy-ëeb.cloud/, https://smart.WBU.edu.al/
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	WBU siguron: • Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, përfshirë programin e ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", si edhe personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme, janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të universitetit. • Këto informacione janë të disponueshme në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe (https://wbu.edu.al/sq/program/biomedical-engineering) dhe tjetra gjuha angleze (https://wbu.edu.al/en/program/biomedical-engineering). Kjo ndihmon në transparencë, akses të lehtë për audienca të ndryshme dhe promovim ndërkombëtar të programeve të studimit të universitetit.
Konkluzione	<i>Universiteti "Western Balkans" ka ngritur një sistem të integruar digjital menaxhimi (SMART-WBU), i cili siguron administrim efikas dhe transparent të proceseve akademike dhe administrative. Platforma u ofron studentëve dhe stafit akses të strukturuar në informacion, vlerësime dhe komunikim institucional.</i> <i>Monitorimi dhe raportimi kryhen në kohë reale, ndërsa përmes publikimeve dygjuhëshe, institucioni garanton transparencë</i>



	dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë në arsimin e lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Universiteti "Western Balkans" harton çdo vit raportin financiar të kostove, i cili përfshin pasqyrat e hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke reflektuar kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit. Ky raport është pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së institucionit, i cili analizon në mënyrë të detajuar veprimtarinë akademike dhe financiare, dhe miratohet nga organet drejtuese si Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Në raport paraqiten gjithashtu pagat e personelit, shpenzimet operative, grantet e huaja të përfituara dhe kontratat e lidhura me shërbime për mbarëvajtjen institucionale. Pas miratimit, raporti i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Plani financiar për mbështetjen e programeve të studimit hartohet për të paktën një cikël të plotë studimi, duke siguruar një menaxhim të qëndrueshëm financiar dhe burimet e nevojshme për funksionimin efektiv të programeve akademike. Evidencat: - Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023 / 2023-2024 - Buxheti vjetor i WBU për vitin 2023 - Statuti i WBU, Neni 113
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të	Buxheti i Universitetit "Western Balkans" është një dokument i strukturuar dhe i detajuar, i cili hartohet duke marrë në konsideratë projektet e paraqitura, pritshmëritë për realizimin e buxhetit të vitit përkatës, si dhe përditësimet në strukturën organizative, numrin e punonjësve, programet e studimit, numrin e studentëve dhe nivelin e financimit.

programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Çdo njësi që ka nevojë për furnizime apo materiale plotëson formularin standard të “Kërkesë për Furnizim / Pajisje me Materiale” dhe e paraqet atë Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative, e cila kontrollon përshtatshmërinë e kërkesës me limitet e buxhetit para miratimit. Plani i financimit për njësitë bazë përgjegjëse për programet e studimit përfshin financimin e burimeve njerëzore të angazhuara në realizimin e programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programeve të studimit dhe projekteve. Menaxhimi administrativ, financiar, ekonomik dhe i aseteve të institucionit është përgjegjësi e Bordit të Administrimit, sipas Statutit dhe rregulloreve të brendshme të universitetit. Strukturat paraqesin një herë në vit kërkesat dhe propozimet e tyre, të cilat përfshihen në parashikimin financiar të buxhetit. Projekti i buxhetit diskutohet në mbledhjen e përbashkët të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Universiteti përcakton nivelin e pagesës për ngarkesën suplementare të personelit akademik. Si institucion privat, Universiteti ka vetërregullim lidhur me procedurat për blerjet dhe nuk është i detyruar të ndjekë dispozitat ligjore shtetërore për tenderat, duke pasur lirinë të vendosë nëse do të aplikojë tender apo jo, në mënyrë të plotë ose të pjesshme. Evidencat: - Buxheti vjetor i WBU për vitin 2023 - Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative, Neni 5 - Statuti i WBU, Nenet 39-40 - Rregullorja themelore e WBU, Neni 9 - Rregullorja e Bordit të Administrimit - Udhëzimi për ngarkesën mësimore në Universitetin Western Balkans - Rregullorja e Zyrës së Prokurimeve dhe Shërbimeve Administrative
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti “Western Balkans” ndjek një politikë të rreptë kontrolli buxhetor dhe financiar. Ai kryen auditime periodike të brendshme për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Përveç auditimit të brendshëm, në përputhje me Nenin 118 të Statutit të WBU, parashikohet edhe realizimi i auditimit të jashtëm, sipas legjislacionit në fuqi.



	Evidencat: - Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023 - Statuti i Universitetit WesternWestern Balkans, Neni 118
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Administrator i fakultetit (njësisë kryesore) është përgjegjës për administrimin financiar dhe administrativ të fakultetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë financiare, si dhe për plotësimin e kërkesave për nevoja akademike, administrative dhe financiare. Ai gjithashtu ndjek organizimin e konferencave dhe seminareve për programet e fakultetit. Institucioni siguron raportimin deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraprak. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë përmes një strukture të qartë organizative dhe procedurave të konsoliduara të menaxhimit financiar. Në përputhje me standardet e këtij kriteri, universiteti siguron që burimet financiare të jenë të mjaftueshme për funksionimin normal dhe cilësor të programeve të studimit, duke përfshirë mbulimin e shpenzimeve për burimet njerëzore, mirëmbajtjen e infrastrukturës, përmirësimin e literaturës dhe aksesin në burime digjitale. Plani financiar përcaktohet dhe vlerësohet periodikisht nga strukturat përkatëse, përfshirë Bordin e Administrimit, i cili ka rol mbikëqyrës në përdorimin e fondeve dhe rishikimin e buxhetit. Monitorimi i vazhdueshëm i ecurisë buxhetore dhe mekanizmat e rialokimit të fondeve i mundësojnë institucionit të reagojë në mënyrë fleksibile ndaj çdo ndryshimi që mund të ndikojë në ecurinë e programeve. Në rastet kur evidentohen nevoja për përmirësime ose situata specifike që kërkojnë ndërhyrje, institucioni planifikon veprime të posaçme si pjesë e strategjisë së tij për diversifikimin e financimeve dhe ruajtjen e stabilitetit afatgjatë të programeve të studimit, në përputhje të plotë me kërkesat e këtij kriteri. Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 4, 5 Evidenca 4.40. Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023 - Statuti i Universitetit WesternWestern Balkans, Neni 118 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 50

	- Rregullorja e Bordit të Administrimit - Raporti Vjetor institucional për vitin akademik 2022-2023 / 2023-2024 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 36			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" ka një sistem të qartë dhe të strukturuar të menaxhimit financiar dhe administrativ, ku administratori i fakultetit përgjigjet për funksionimin e mirë të fakultetit, ndërsa Bordi i Administrimit siguron qëndrueshmëri financiare dhe miraton rregulloret për përdorimin e burimeve. Ai monitoron dhe rishikon buxhetin në mënyrë periodike për të përmbushur nevojat institucionale në përputhje me ligjet dhe standardet kombëtare. Zyra e Financës ka rol kyç në përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, duke siguruar përdorim efektiv të burimeve për realizimin e veprimtarive akademike dhe administrative. Gjithashtu, transparenca financiare ruhet përmes publikimit të Raportit Vjetor Institucional dhe arkivimit të tij në formë fizike dhe elektronike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me	Institucioni harton dhe zbaton në mënyrë të plotë politika dhe procedura që rregullojnë çdo fazë të ciklit akademik të studentëve, nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e brendshme rregullatore. Procesi i pranimit në programet e ciklit të parë dhe të integruara mbështetet mbi përfundimin me sukses të arsimit të mesëm dhe respektimin e kriterit të notës mesatare, siç përcaktohet çdo vit

legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që institucioni aplikon edhe kritere shtesë të publikuara në kohë nga strukturat përkatëse. Për programet e ciklit të dytë, kriteret e pranimit përcaktohen dhe miratohen nga njësitë përkatëse dhe Senati Akademik, duke siguruar një proces përzgjedhjeje të drejtë dhe të dokumentuar. Politikat e ndjekura nga universiteti përfshijnë gjithashtu vlerësimin akademik të studentëve përmes një sistemi të përcaktuar notimi, progresin nga një vit në tjetrin sipas krediteve të fituara, si dhe procedurat e diplomimit, të cilat janë të qarta, të dokumentuara dhe transparente. Përfundimi i suksesshëm i një programi studimi çon në pajisjen e studentit me një diplomë zyrtare, të lëshuar sipas standardeve institucionale dhe në përputhje me aktet rregullatore. Këto elementë dëshmojnë se institucioni i ka të zbatuara politikat dhe procedurat që garantojnë një trajektore të plotë dhe të strukturuar të ciklit akademik të studentëve. Evidencat: - <i>Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 54-55</i> - <i>Miratimi i kritereve të pranimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimit</i> - <i>Evidenca per WBU Research Seminars</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Universiteti "Western Balkans" zbaton politika të qarta dhe transparente që rregullojnë gjithë ciklin akademik të studentit, nga momenti i pranimit deri në përfundimin e studimeve. Pranimi i studentëve në të gjitha ciklet e studimit bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e brendshme të institucionit, duke garantuar trajtim të barabartë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët, pavarësisht prejardhjes apo statusit të tyre. Për studentët e huaj janë hartuar procedura të dedikuara, të cilat përfshijnë kriteret e pranimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrat e aplikimit, të cilat publikohen dhe përditësohen rregullisht në faqen zyrtare të institucionit. Rritja progresive e numrit të studentëve ndërkombëtarë tregon për qartësinë dhe efektivitetin e këtyre procedurave. Pas pranimit, çdo student përfiton të njëjtat të drejta dhe trajtohet në mënyrë të barabartë, siç parashikohet edhe në marrëveshjen e lidhur mes studentit dhe universitetit. Përcaktimi i kuotave nga departamentet përkatëse dhe miratimi nga Bordi i Administrimit sigurojnë një menaxhim të balancuar dhe të qëndrueshëm të kapaciteteve institucionale në funksion të ofrimit të një arsimi cilësor.



	Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 91, 95, 104 dhe 105 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 67, 68, 70 dhe 71 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Universiteti "Western Balkans" zbaton praktika të standardizuara dhe transparente për procesin e pranimi në programet e studimit, të cilat përditësohen dhe bëhen publike çdo vit akademik. Institucioni ka të drejtë të propozojë kriteret specifike për çdo program studimi apo specialitet, të cilat pasqyrohen qartë në dokumentacionin përkatës të publikuar për aplikantët. Këto kriteret dhe procedura janë të përfshira në aktet normative të universitetit, si Statuti, Rregullorja Themelore dhe rregulloret specifike për programet e studimit. Kjo qasje garanton qartësi dhe drejtësi në përzgjedhjen e kandidatëve dhe ndihmon në ruajtjen e cilësisë së studentëve të pranuar. Institucioni bashkëpunon ngushtë me strukturat kombëtare përgjegjëse për procesin e maturës shtetërore dhe sistemin UAlbania, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, procedurat parashikojnë dhe mundësojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj, përmes kriterëve të veçanta që janë të përcaktuara dhe të aksesueshme publikisht. Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 83, 87, 93 dhe 94 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 54-59
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Universiteti "Western Balkans" siguron një qasje të qartë dhe të standardizuar për të gjitha fazat e ciklit akademik të studentëve, nga regjistrimi fillestar deri në diplomim. Të gjitha procedurat dhe rregullat që lidhen me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve në programet e ciklit të parë, ciklit të dytë dhe ato të integruara janë të përcaktuara në aktet rregullative të institucionit dhe janë të aksesueshme publikisht. Gjithashtu, institucionit ka parashikuar në dokumentacionin e tij të brendshëm mënyrat për realizimin e transferimeve dhe njohjen e krediteve apo të studimeve të kryera në institucione të tjera, brenda ose jashtë vendit, duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë studentët. Proceset e vlerësimit të përparimit akademik dhe të diplomimit janë të mirëstrukturuara dhe të informuara qysh në fillim të studimeve, si pjesë e orientimit akademik dhe përmes syllabusit të çdo lënde. Për më tepër, mbështetja e

	vazhdueshme që u ofrohet studentëve nga këshilltarët akademikë dhe stafi drejtues i programeve siguron që çdo informacion të jetë i qasshëm dhe i kuptueshëm në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë ciklit të studimeve. Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 83, 87, 92 dhe 94 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 54-59 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 67, 68, 70 dhe 71 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/organizimi i aktiviteteve informuese
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti "Western Balkans" garanton transparencë dhe akses të plotë në informacionin që lidhet me organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit që ai ofron. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni publikon në mënyrë të qartë dhe të strukturuar kërkesat që duhen plotësuar për regjistrim në çdo program studimi, duke përfshirë si elementët e përgjithshëm, ashtu edhe ato të veçantë për secilin cikël apo profil. Ky informacion përfshihet në dokumentacionin zyrtar të universitetit dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit, duke u vënë në dispozicion të të gjithë të interesuarve. Kjo qasje mundëson orientimin e saktë të kandidatëve dhe garanton parime të barazisë dhe të drejtës së informimit për të gjithë aplikantët, si edhe për studentët aktualë. Evidencat: - Kriteret e pranimit të studentëve në programin Cikli I "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Evidenca 6. Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Evidenca 1.15. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 43 - Evidenca 1.15. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 42 - Evidenca 2.1. Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Nenet 5 dhe 15 - Evidenca 1.15. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 41 - Evidenca 4.36. Guida e studentit - Evidenca 5.5. Kuotat e parashikuara për studentët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuar

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Universiteti “Western Balkans” mbështet dhe promovon qasjen gjithëpërfshirëse në arsimin e lartë për të gjithë kategoritë e studentëve, duke përfshirë ata me aftësi të veçanta, studentët që i përkasin pakicave kombëtare apo grupeve të marginalizuara. Për këtë qëllim, janë përcaktuar kuota të veçanta pranimi dhe organizohen periodikisht trajnime dhe seminare për ndërgjegjësimin e komunitetit universitar mbi përfshirjen dhe barazinë.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe pedagogjike, duke krijuar ambiente të përshtatshme për lëvizshmërinë dhe pjesëmarrjen e plotë të studentëve me aftësi ndryshe. Rampa ndihmëse në hyrje, ashensorë funksionalë dhe nyje higjieno-sanitare të dedikuara janë tashmë pjesë e standardeve të zbatueshme në mjediset universitare.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në funksion të ndërkombëtarizimit dhe për të garantuar qasje të barabartë për studentët nga vende të tjera, Universiteti “Western Balkans” zhvillon dhe publikon çdo vit informacion të detajuar mbi procedurat e pranimin për kandidatët ndërkombëtarë. Ky informacion promovohet përmes platformës zyrtare online të universitetit dhe në evente ndërkombëtare ku WBU merr pjesë. Procesi i pranimin të studentëve të huaj mbështetet nga struktura të dedikuara si Zyra e Marketingut dhe Pranimeve dhe Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, të cilat ofrojnë informacion të plotë mbi programet akademike, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe mbi jetën kulturore dhe sociale në Shqipëri. Në përputhje me misionin e tij për të mbështetur shtresat në nevojë dhe për të nxitur cilësinë në arsimin e lartë, WBU zbaton politika të posaçme ndihme dhe bursa për studentë të talentuar, maturan të nga zona të largëta apo më pak të zhvilluara, si dhe për ata që ndodhen në kushte të vështira ekonomike. Llojet e bursave, procedurat e përzgjedhjes dhe mënyra e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren për Bursat dhe menaxhohen nga Zyra për Bursat pranë Dekanatit të Studentëve. Falë bashkëpunimeve me institucione partnere si American Hospitals Group, International Hygeia Hospital, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe organizata të tjera ndërkombëtare, studentëve ju janë ofruar bursa ekselence, mbështetje institucionale dhe mundësi të veçanta për përfshirje akademike. Vetëm gjatë dy viteve të para të funksionimit, mbi 250 studentë kanë përfituar forma të ndryshme mbështetjeje financiare përmes këtij programi.



	Evidencat: - Kuotat e parashikuara për studentët me afësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuar - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 54-55 - Procedura e pranimit të studentëve të huaj - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 43 - Lista e institucioneve akademike partnere - Marrëveshja me perspektivat e reja për bursat - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 45 - Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Western Balkans - Numri i studentëve përfitues të bursave për periudhën 2022-2025			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" ka zhvilluar një sistem të mirëorganizuar dhe transparent për mbështetjen financiare dhe sociale të studentëve, duke ofruar një gamë të gjerë bursash dhe ndihmash për studentët në nevojë, përfshirë ato nga komunitetet e marginalizuara dhe maturantët nga zona specifike të vendit. Përmes bashkëpunimeve me institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale, WBU siguron burime shtesë për bursa ekselence dhe ndihma institucionale. Zyra e Bursave në Dekanatin e Studentëve garanton një proces të drejtë dhe të strukturuar për akordimin e bursave, i cili bazohet në kritere të qarta dhe monitorohet vazhdimisht. Kjo politikë kontribuon në krijimin e një ambienti gjithëpërfshirës dhe mbështetës, duke siguruar mundësi të barabarta për studentët dhe duke rritur cilësinë e arsimit në universitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të	Universiteti "Western Balkans" siguron informacion të plotë dhe të detajuar lidhur me procedurat dhe kërkesat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit

hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	akademik në tjetrin. Sipas Statutit të WBU, sasia mesatare e krediteve që një student me kohë të plotë duhet të grumbullojë gjatë një viti akademik është 60 kredite, që përkohë me 1500 orë pune. Kalimi në vitin pasardhës bëhet vetëm pasi studenti të ketë përmbushur detyrimet e vitit të mëparshëm, në përputhje me Rregulloren Themelore të WBU, Rregulloren për Programet e Studimit të Ciklit të Parë Bachelor, si dhe me rregulloret e veçanta të programeve studimore të universitetit. Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 84, Pika 3 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 90 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Nenet 20-23 - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 6
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti "Western Balkans" siguron që studentët të jenë të informuar qartë për mënyrat dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve apo studimeve që kanë bërë më parë, qoftë brenda apo jashtë vendit. Transferimi i krediteve dhe njohja e studimeve nga institucione të tjera bëhen sipas rregullave të përcaktuara në dokumentet zyrtare të universitetit, të cilat janë të aksesueshme për çdo student. Çdo student që kërkon të transferohet apo të vazhdojë studimet në një program të WBU merr informacion të detajuar që në momentin e paraqitjes së aplikimit, për hapat që duhet të ndjekë dhe kriteret që duhet të plotësojë për njohjen e studimeve të mëparshme. Për këtë proces, formohet një komision i veçantë në nivel departamenti, i cili shqyrton dokumentacionin dhe vendos në përputhje me kurrikulën dhe objektivat e programi. Evidencat: - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 91, 95, 104 dhe 105 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 67, 68, 70 dhe 71 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë" - Rregullore për njohjen dhe transferimin e studimeve
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të	Në Universitetin "Western Balkans", sistemi i vlerësimit të studentëve dhe mënyrat e testimit janë të përcaktuara qartë në dokumentet zyrtare të institucionit, si Rregullorja Themelore dhe rregulloret specifike për programet e ciklit të parë. Në këto dokumente përcaktohen aspektet kryesore të vlerësimit, si notat, provimet dhe kalueshmëria, mundësitë për përmirësimin



studentëve në programin e studimit.	e mesatares, afatet dhe format e provimeve, si dhe e drejta për ankesa mbi rezultatet. Studentët njoftohen me këto kritere dhe mënyra vlerësimi që në javën e parë të mësimit, përmes syllabusit të çdo lënde, ku përshkruhet edhe mënyra sesi do të realizohet testimi i njohurive dhe aftësive të tyre. Në fillim të çdo lënde, titullari i saj prezanton metodologjinë e testimit dhe vlerësimit, duke siguruar që studentët të jenë të informuar dhe të përgatitur për procesin e vlerësimit gjatë gjithë ciklit akademik. Evidencat: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Nenet 89-99 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë"
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Universiteti "Western Balkans" siguron që studentët të jenë të informuar qartë për procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit. Sipas Rregullores Themelore, studenti që ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike mund të marrë pjesë në mbrojtjen e diplomës, ndërsa ata që nuk i kanë përmbyllur mund t'i plotësojnë në semestrin pasardhës. Detyrimet përmbyllëse janë pjesë e kurrikulës dhe të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Studentët mbështeten nga drejtuesit e njësive akademike, koordinatorët dhe këshilltarët akademikë gjatë këtij procesi, ndërsa për punimin e tezës së masterit, caktimi i udhëheqësit shkencor siguron asistencë të vazhdueshme. Evidencat: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 90 - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 86, Nenet 89-90 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 84-86, 105-109 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Nenet 13-17 dhe Neni 19 - Syllabus i lëndës "Temë diplome" për programin të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Biomjekësore" - Udhëzim për përgatitjen e punimit të tezës së diplomës
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të	Universiteti "Western Balkans" ka ngritur struktura të dedikuara për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimin të Studentëve merret me promovimin e universitetit në të gjitha nivelet, duke përgatitur dhe përditësuar materialet



posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	prezantuese dhe informacionin në web dhe rrjetet sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn). Kjo zyrë është gjithashtu përgjegjëse për prezantimin e WBU në panairë brenda dhe jashtë vendit dhe për furnizimin e kandidatëve me informacione të detajuara mbi programet, tarifat, bursat dhe rregulloret. Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve organizon javën orientuese në fillim të çdo viti akademik dhe vazhdon të ofrojë mbështetje gjatë gjithë vitit, duke ndihmuar studentët për një përvojë të suksesshme akademike. Këshilltarët akademikë të njëjësive bazë mbikëqyrin vijueshmërinë dhe përparimin e studentëve. Bashkëpunimi mes dy zyrave siguron informimin e plotë dhe këshillimin e karrierës për studentët e ardhshëm. Për më tepër, gjatë vitit akademik organizohen ditë të hapura informimi, ndërsa të dhënat mbi ofertën akademike, kurrikulat, tarifat dhe bursat janë gjithmonë të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit dhe rrjetet sociale. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans , Neni 33 - Guida e studentit - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans , Neni 43 - Raport mbi veprimtarinë e Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimit të Studentëve për vitin akademik 2022-2023 / 2023-2024 - Ditët e informimit brenda institucionit për studentët/organizimi i aktiviteteve informuese		
Konkluzione	Universiteti “Western Balkans” ka struktura të organizuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve të rinj dhe të ardhshëm. Përmes Zyrës së Komunikimit dhe Pranimit, promovon ofertën akademike në mënyrë efektive, duke përdorur materiale prezantuese, panairë dhe platforma digjitale. Zyra e Orientimit siguron mbështetje për përshtatjen me jetën universitare dhe bashkëpunon me njësitë akademike për suksesin e studentëve. Aktivitetet informuese të hapura dhe komunikimi i vazhdueshëm dëshmojnë përkushtimin e WBU për përmirësimin e përvojës studentore.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e programeve të Universitetit “Western Balkans” marrin informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit që zgjedhin, që nga momenti i aplikimit. Këto të dhëna janë të disponueshme në kurrikulat e programeve, të cilat janë publike dhe mund t’i aksesojnë lehtësisht në faqen zyrtare të universitetit në shqip dhe anglisht. Informacioni u sigurohet studentëve edhe në formë fizike gjatë regjistrimit, përmes Sekretarisë Mësimore, koordinators së programit apo strukturave të tjera përkatëse. Detajet mbi organizimin e studimeve, gjuhën e mësimdhënies dhe vitin akademik janë të përcaktuara në dokumentet institucionale të universitetit. Çdo program ka të emëruar një këshilltar akademik që mbështet studentët gjatë gjithë studimeve. Këshilltari ndihmon studentët në regjistrimin e lëndëve dhe i orienton për të gjitha çështjet që lidhen me përparimin akademik. Evidencat: - Procedura e regjistrimit të studentëve - Statuti i Universitetit Western Balkans, Nenet 82-86 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 50 - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”, Neni 6 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 60 - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë” - Model formulari i zgjedhjes së lëndëve
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e regjistruar në programet e WBU marrin të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet mësimore. Që në regjistrim, ata pajisen me Guidën e Studentit, ku gjenden të dhëna të përgjithshme mbi institucionin, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet. Këshilltarët akademikë ndihmojnë studentët në njohjen e planit mësimor dhe zgjedhjen e lëndëve për çdo semestër. Planet mësimore dhe syllabus-et janë të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit në shqip dhe anglisht, si dhe prezantohen nga pedagogët që në javën e parë të semestrit. Syllabuset përmbajnë informacion të detajuar për secilën



	lëndë, përfshirë orët, kreditë ECTS, temat, literaturën dhe mënyrën e vlerësimit. Për më tepër, platforma SMART WBU u mundëson studentëve akses të plotë në të gjitha këto informacione, duke përfshirë materialet didaktike dhe vlerësimet. Informacioni mund t'u jepet edhe në formë fizike nga sekretaria, koordinatorët apo departamentet. Mbështetja për studentët vazhdon gjatë gjithë vitit akademik, ndërsa këshilltarët akademikë ndjekin përparimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Evidencat: - <i>Guida e studentit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët e WBU informohen që në fillim për mundësitë e punësimit për secilin program studimi. Për të mbështetur integrimin e tyre në tregun e punës, Zyra e Planifikimit të Karrierës, nën Dekanatin e Studentëve, ofron këshillim të vazhdueshëm dhe lidhje me institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes këshilltarëve të karrierës, studentët marrin trajnime profesionale për përgatitjen e CV-së, letër motivimi, intervista pune dhe tema të tjera të rëndësishme. Zyra organizon takime individuale dhe grupe këshillimore, si dhe evente si Career Workshop dhe Career Fair. Një mundësi e veçantë për studentët janë praktikant dhe njohuritë përmes programit EPIC, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri. Gjithashtu, WBU ka themeluar Zyrën e të Diplomuarve (Alumni Office), që lidh universitetin me ish-studentët dhe ndjek zhvillimin e tyre në tregun e punës, duke organizuar seminare, workshope dhe evente për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe komunitar. Evidencat: - <i>Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 47</i> - <i>Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës</i> - <i>Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 48</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Studentëve të WBU u sigurohet informacion i plotë dhe i përditësuar mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, si dhe mbi infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse. Të gjithë studentët dhe stafi kanë adresë zyrtare elektronike për komunikim të brendshëm. Ky informacion jepet përmes Guidës së Studentit, platformës SMART WBU, faqes zyrtare të internetit, komunikimit me këshilltarët akademikë, koordinatorin e programit dhe departamentin përkatës.

shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Platforma SMART WBU ofron akses të plotë në të dhëna mbi programin, materialet didaktike, vlerësimet dhe mbarëvajtjen akademike. Koordinator i programit dhe këshilltarët akademikë informojnë dhe mbështesin studentët që në fillim të studimeve. Gjithashtu, oraret dhe takimet për këshillime me pedagogët janë të organizuara për çdo program. Evidencat: - <i>Praktika e informimit të studentëve nga këshilltari akademik</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	SMART WBU është platforma kryesore ku studentët mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, në shqip dhe anglisht, përmes llogarive personale të lidhura me sistemin e brendshëm të informacionit. Për programin “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”, informacioni është i disponueshëm në faqen zyrtare të universitetit në dy gjuhë (https://wbu.edu.al/sq/program/biomedical-engineering dhe https://wbu.edu.al/en/program/biomedical-engineering), në platformën SMART WBU (https://smart.wbu.edu.al/) dhe Google Classroom. Të gjitha këto burime janë lehtësisht të aksesueshme edhe në distancë. Evidencat: - https://WBU.edu.al/sq/program/biomedical-engineering - https://WBU.edu.al/en/program/biomedical-engineering,
Konkluzione	Universiteti “Western Balkans” ka krijuar një infrastrukturë të fuqishme dhe të integruar për informimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë procesit arsimor. Nëpërmjet platformës SMART WBU, faqes zyrtare, Google Classroom dhe komunikimit elektronik, studentët kanë akses të vazhdueshëm dhe të detajuar mbi programet e studimit, planifikimin akademik, materialet mësimore dhe vlerësimet. Informacioni është i disponueshëm në dy gjuhë dhe në formate të ndryshme, duke garantuar transparencë dhe lehtësinë e përdorimit për të gjithë studentët, përfshirë edhe ato në distancë. Roli i këshilltarëve akademikë dhe koordinimit me departamentet siguron mbështetje të vazhdueshme akademike dhe orientim profesional, duke kontribuar në suksesin dhe integrimin e studentëve në tregun e punës. Ky sistem efektiv komunikimi dhe informimi përforcon cilësinë e përgjithshme të procesit arsimor në WBU.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Universiteti “Western Balkans” ruan dhe përditëson vazhdimisht të dhënat mbi studentët që ndjekin programet e studimit, që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim, si dhe informacione për punësimin e tyre pas diplomimit. Në programin “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” aktualisht janë regjistruar studentë si më poshtë: • Viti akademik 2022- 2023 12 studentë; • Viti akademik 2023- 2024 4 studentë; • Viti akademik 2024- 2025 8 studentë; Performanca e studentëve analizohet çdo vit nga departamenti dhe përfshihet në raportet vjetore për të ndihmuar në përmirësimin e programit. Evidencat: - Lista e studentëve të programit të studimit Cikli i “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore” 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Universiteti “Western Balkans”, së bashku me strukturat përgjegjëse si Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë dhe Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, mbledh dhe përditëson statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, rrugëtimin e tyre deri në diplomim, si edhe tërheqjet, largimet para përfundimit të programit dhe mosrealizimin e vitit akademik. Sekretaria mësimore ndjek me kujdes secilin student nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat e mbledhura paraqiten në mënyrë statistikore në raportet vjetore të njësive bazë dhe në nivel institucional.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të	Mbledhja dhe përpunimi i statistikave mbi studentët realizohet nga Sekretaria Mësimore, sipas Neneve dhe Rregullores së organizimit administrativ. Sekretaria është përgjegjëse për

brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	regjistrimin, monitorimin dhe arkivimin e të gjitha të dhënave, dokumenteve dhe transkripteve lidhur me studentët. Për këtë qëllim, WBU ka implementuar platformën dixhitale SMART WBU (https://smart.wbu.edu.al/), ku dokumentacioni i studentëve organizohet dhe administrohet në mënyrë të centralizuar, sipas njësive prodhuese. Të gjitha informacionet janë të sigurt dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar kur kërkohet. Universiteti disponon një bazë të dhënash të plotë për regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimeve, të dhëna për programin dhe planin mësimor, kreditet e studimeve, si dhe vlerësimet akademike dhe dokumentacionin e diplomave dhe suplementit të tyre. Këto të dhëna ruhen dhe administrohen nga dekanati dhe njësitë bazë, dhe janë gjithashtu të publikuara online dhe të aksesueshme në SMART WBU. Evidencat: - Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Neni 3 - Kontrata për SMART WBU
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Universiteti “Western Balkans” kryen, përveç auditimit financiar, edhe kontrole periodike – auditime të brendshme mbi veprimtarinë e njësive përgjegjëse për menaxhimin, si sekretaritë mësimore dhe sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit. Këto auditime kanë për qëllim verifikimin e përputhshmërisë dhe zbatueshmërisë me ligjet dhe aktet e brendshme të institucionit, si dhe vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre. Çdo auditim periodik përfundohet me një raport, i cili i vihet në dispozicion strukturave drejtuese të universitetit për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e situatës, në rast se konstatohen probleme. Evidencat: - Evidenca 4.40. Raporti i auditimit të brendshëm të WBU 2023
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim	Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Inxhinierisë, si njësia përgjegjëse për programin e “Inxhinierisë Biomjekësore”, bashkëpunon ngushtë me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Alumni-t për të përgatitur raporte periodike analitike. Këto raporte përfshijnë analizën e profilin të studentëve në momentin e pranimin dhe në përfundim të studimeve, si dhe vlerësimin e cilësisë së punësimit të tyre pas diplomimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik, ndërsa Zyra e Alumni-t, si lidhja kryesore


të përmirësimit të këtyre treguesve.	midis universitetit dhe të diplomuarve, ka në plan të ndjekë nga afër zhvillimet e tyre profesionale dhe vazhdimësinë në studime të mëtejshme. Të dhënat e përpunuara prezantohen në raportet vjetore të departamentit dhe përdoren si bazë për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe për të marrë masat e nevojshme për të rritur cilësinë e programit. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 3. - Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Neni 3. - Informacion mbi të dhënat në hyrje, për vitin akademik 2022-2023, 2023-2024 dhe për Semestrin e parë të vitit akademik 2024-2025, për studentët e programit të studimit Cikli i Parë "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 48. - Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit (Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Inxhinierisë) për vitin akademik 2023-2024.			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" ka ngritur një sistem të integruar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi studentët, përparimin e tyre dhe gjurmimin e punësimit pas diplomimit. Bashkëpunimi ndërmjet njësive përkatëse dhe përdorimi i platformës SMART WBU sigurojnë monitorim të vazhdueshëm dhe cilësor të programeve. Auditimet e brendshme dhe raportet analitike mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen e ofertës akademike me nevojat e tregut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Universiteti "Western Balkans" ka krijuar një strukturë të mirëorganizuar që nxit përfshirjen aktive të studentëve në jetën institucionale dhe proceset vendimmarrëse. Përmes rregullave

dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit	të brendshme, studentëve u garantohen të drejta për organizim në këshilla studentore dhe përfaqësim në organet e universitetit, si Senati Akademik dhe komisionet fakultare e institucionale. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në këto organe, si dhe në njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, siguron që zëri i tyre të dëgjohet dhe të ketë ndikim në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese. Përveç kësaj, përmes Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore, universiteti mbështet dhe inkurajon aktivitetet akademike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive të studentëve, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe të pasur me mundësi për zhvillim jashtë auditorë. Ky angazhim i shumëfishtë i studentëve kontribuon në forcimin e një komuniteti aktiv dhe të përfshirë në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës akademike dhe institucionale. Evidencat: - Rregullorja Themelore e WBU, Neni 110 - Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik - Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale - Emërimi i studentit në NJSBC - Praktika e Zgjedhjeve e Këshillit Studentor - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 46 - Raporti i aktiviteteve të Klubeve Studentore 2022-2023 dhe 2023-2024
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Universiteti "Western Balkans" ka vendosur një mekanizëm funksional për përfshirjen aktive dhe reale të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Këshilli Studentor, si një organ i pavarur dhe demokratikisht i zgjedhur, përfaqëson interesat e studentëve pa asnjë lloj diskriminimi dhe ka rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve që prekin komunitetin studentor. Ky këshill siguron që zëri i studentëve të dëgjohet në mënyrë konkrete dhe me ndikim të matshëm në vendimmarrjet që lidhen me strukturat mësimore dhe ato të shërbimeve. Kryetari i Këshillit Studentor është anëtar aktiv në organet kolegjiale vendimmarrëse, duke kontribuar në diskutime dhe duke paraqitur propozime të bazuara në nevojat dhe mendimet e përfuara drejtpërdrejt nga studentët. Gjithashtu, rregulloret e brendshme të universitetit e përcaktojnë qartë rolin dhe përgjegjësitë e Këshillit Studentor, duke e kufizuar veprimtarinë e tij vetëm në fushën e arsimit dhe zhvillimit studentor, pa përfshirje në çështje politike apo ekonomike jashtë institucionit. Kjo qasje siguron një përfshirje




	të drejtëpërdrejtë, transparente dhe të efektshme të studentëve në jetën akademike dhe institucionale. Evidencat: - Ngritja, funksionimi dhe përbërja e këshillit studentor - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 49.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Universiteti "Western Balkans" ka krijuar mekanizma të qëndrueshëm për përfshirjen aktive të studentëve në procesin e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Në këtë kuadër, studentët janë të përfshirë në mënyrë të rregullt dhe sistematike në hartimin, rishikimin dhe përshtatjen e programeve përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit, si mbledhje të përbashkëta në departament, pyetësorë, grupe fokusimi dhe kanale të tjera të komunikimit. Pjesëmarrja e studentëve në këto procese konsiderohet thelbësore për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes akademike. Ata japin vlerësime për performancën e pedagogëve, përmbajtjen e lëndëve, si dhe për të gjithë programin, jo vetëm gjatë studimeve, por edhe pas përfundimit të tyre, përmes vlerësimeve të planifikuara që pasqyrojnë edhe ndikimin e programeve në tregun e punës. Ky proces përfshin një bashkëpunim të ngushtë midis njësive përgjegjëse për programin, stafit akademik dhe administrativ, si dhe përfaqësuesve të studentëve. Përfaqësuesit e studentëve ftohen rregullisht në takime për të shprehur mendimet dhe sugjerimet e komunitetit studentor, duke siguruar që opinioni i tyre të merret parasysh në vendimet përkatëse. Në këtë mënyrë, universiteti promovon një dialog të hapur dhe konstruktiv, duke e bërë përfshirjen e studentëve një pjesë thelbësore të zhvillimit akademik dhe cilësor. Evidencat: - Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësine Bazë
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e	Universiteti "Western Balkans" ka vendosur procedura të qarta dhe transparente për procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, duke garantuar drejtësi dhe barazi për të gjithë studentët. Rregullat për organizimin e provimeve dhe mënyrën e ankimit të rezultateve janë të dokumentuara dhe të disponueshme për studentët përmes rregulloreve zyrtare të publikuara në faqen institucionale. Studentët kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre mbi ndershmërinë dhe korrektësinë e procesit të vlerësimit, duke përfshirë të drejtën për të apeluar rezultatet e provimeve, për të

institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	kërkuar rishikim apo reflektim të tyre nga ana e njësive akademike apo pedagogëve përgjegjës. Për më tepër, pedagogët janë të detyruar që në fillim të çdo semestri të publikojnë sistemin e vlerësimit për secilën lëndë, duke ofruar kështu një transparencë të plotë për mënyrën e vlerësimit. Rezultatet e arritura nga studentët regjistrohen dhe publikohen në faqet personale të tyre brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik, duke mundësuar akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë. Në rast ankesash mbi rezultatet e provimeve, studenti ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve. Kjo ankesë shqyrtohet nga një komision i pavarur prej tre anëtarësh, i emëruar nga Këshilli i Departamentit përkatës, ku pedagogu i lëndës nuk merr pjesë, për të siguruar një proces të drejtë dhe objektiv. Vendimi përfundimtar njoftohet studentit brenda një periudhe 15-ditore nga data e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Ky mekanizëm mbështet një ambient akademik ku transparenca dhe drejtësia janë vlerat kryesore në procesin e vlerësimit. Evidencat: - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Neni 23 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë", Neni 28			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" angazhon studentët në mënyrë aktive dhe të organizuar në jetën institucionale dhe proceset vendimmarrëse, përmes përfaqësimit në organet kolegjiale dhe Këshillit Studentor. Studentët marrin pjesë në sigurimin e cilësisë përmes vlerësimeve periodike dhe mekanizmave të miratuar për provime dhe ankesa. Këto procese, të mbështetura nga rregullore të dokumentuara dhe të monitoruara, pasqyrojnë një kulturë institucionale që e konsideron pjesëmarrjen studentore si thelbësore për cilësinë dhe transparencën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Universiteti Western Balkans ka ndërtuar një sistem të mirë-organizuar për menaxhimin e informacionit dhe shërbimeve për studentët, i cili mbështetet në teknologji moderne. Ky sistem siguron administrimin e të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, duke respektuar rregulloret dhe ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Dokumentacioni i studentëve ruhet në formë fizike dhe elektronike, ndërsa zyra përkatëse përgjegjëse siguron arkivimin dhe menaxhimin efektiv të tyre. Njësitë administrative mbledhin dhe përpunojnë statistikave studentore në mënyrë të organizuar dhe sipas procedurave të paracaktuara. Platforma SMART WBU përmirëson dixhitalizimin dhe aksesin në dokumentacion, duke garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e informacionit. Kjo siguron një menaxhim efikas dhe të besueshëm të shërbimeve për studentët në Universitetin Western Balkans. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 4 - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 122 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 79 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans" - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 46 - Evidenca 1.15. Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 35 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 31 - Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore - Kontrata për SMART WBU - Statuti i Universitetit "Western Balkans", Nenet 122-123 - Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve	Universiteti Western Balkans ka krijuar një sistem të mirëorganizuar për orientimin, informimin dhe këshillimin e studentëve gjatë gjithë procesit mësimor. Ky sistem përfshin shërbime elektronike për dhënien e informacionit dhe komunikimin me studentët, si dhe mbështetje nga strukturat ndihmëse akademike dhe administrative.



dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, në kuadër të Dekanatit të Studentëve, siguron publikimin dhe përditësimin e informacionit mbi ofertën akademike, rregulloret dhe aktivitetet e universitetit. Po ashtu, Zyrat e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve ofrojnë asistencë të vazhdueshme për studentët, duke i ndihmuar ata të kuptojnë dhe respektojnë politikat dhe procedurat e universitetit, si dhe duke i mbështetur në nevojat e tyre akademike dhe sociale. Për studentët e huaj, ekzistojnë shërbime shtesë që i ndihmojnë gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke ofruar informacion mbi kulturën dhe jetën në vend, dhe duke organizuar aktivitete integruese. Informacioni i rëndësishëm për studentët publikohet në faqen zyrtare të universitetit dhe në kanalet sociale, ndërsa komunikimi akademik mbështetet edhe përmes platformave digjitale si SMART WBU dhe Google Classroom. Gjithashtu, studentët mund të kontaktojnë drejtpërdrejt përmes adresës elektronike të universitetit ose përmes Dekanit të Studentëve. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 33 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit "Western Balkans", Neni 43
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Universiteti Western Balkans ofron shërbim të vazhdueshëm dhe të specializuar për këshillimin e karrierës për studentët. Në kuadër të Dekanatit të Studentëve funksionon Zyra e Planifikimit të Karrierës, e cila i orienton studentët gjatë dhe pas studimeve, duke krijuar lidhje me institucione publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'i ndihmuar ata në integrimin në tregun e punës. Këshilltarët e karrierës mbështesin studentët në hartimin e dokumenteve për aplikim (CV, letra motivuese), përgatitjen për intervista dhe organizojnë takime individuale apo grupe këshillimi. Po ashtu, Zyra organizon evente si workshop-e dhe panairë karriere, dhe mbështet aplikimin praktik të njohurive përmes programit EPIC, i cili përfshin studentët me rezultate të larta akademike. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 42 - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans, Neni 47 - Praktika e një rasti këshillimi karriere nga Zyra e Planifikimit të Karrierës

	- Lista e studentëve përfitues të programit EPIC 2022-2023 dhe 2023-2024, me praktikë të paguar, pranë institucioneve partnere			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Universiteti Western Balkans ka themeluar Zyrën e Diplomuarve (Alumni Office), e cila mbështet lidhjen midis universitetit dhe të diplomuarve. Kjo zyrë ndjek pas diplomimit studentët, mbledh dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre, dhe i bën këto informacione të disponueshme për studentët aktualë, si dhe për organet dhe autoritetet drejtuese përkatëse. Për më tepër, Zyra organizon aktivitete dhe evente që synojnë zhvillimin e vazhdueshëm dhe forcimin e rrjetit profesional mes të diplomuarve dhe universitetit. Evidencat: - Rregullorja mbi organizimin administrativ të Universitetit Western Balkans , Neni 48			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë studimeve dhe pas diplomimit, përmes zyrave të dedikuara dhe platformave elektronike. Studentët informohen dhe këshillohen mbi rregulloret, jetën akademike dhe integrimin në tregun e punës. Zyra e Planifikimit të Karrierës organizon trajnime dhe evente si "Career Fair" dhe EPIC, ndërsa Zyra e Alumni-t ndjek punësimin e të diplomuarve, duke kontribuar në përmirësimin e programeve dhe përafrimin me kërkesat e tregut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti Western Balkans i jep shumë rëndësi përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, duke iu përgjigjur diversitetit dhe nevojave të ndryshme të studentëve. Procesi mësimor përbëhet nga kombinimi i leksioneve, punëve laboratorike, praktikave mësimore, seminareve, vizitave studimore në terren, testeve të shkurtra, detyrave individuale dhe projekteve, të cilat janë të përcaktuara në programin e secilës lëndë ose modul. Kjo qasje siguron arritjen e objektivave të programeve të studimit dhe zhvillimin e kompetencave të studentëve në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për të mbështetur këtë proces, WBU ofron trajnime të vazhdueshme për personelin akademik dhe ndihmës akademik, me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike dhe përafrimin me rezultatet e pritshme të të nxënit. Në auditorët e universitetit janë instaluar pajisje teknologjike moderne, si Smartboard-et, për përdorimin e të cilave stafi është trajnuar posaçërisht. Politikat institucionale përfshijnë programe kualifikimi dhe zhvillimi profesional të stafit akademik, të organizuara sipas nevojave të identifikuara në fillim të çdo viti akademik, si dhe trajnime të specializuara me studiues dhe akademikë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto masa sigurojnë që personeli të jetë i përgatitur dhe i aftë për të ofruar mësim cilësor dhe efektiv, duke garantuar një mjedis të favorshëm për të nxënit dhe zhvillimin profesional të studentëve. Evidencat: - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 75, pikat 4-6 - Rregullorja "Për programet e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave" - Rregullorja e Programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore", Neni 6 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Biomjekësore" - Lista e trajnimeve të zhvilluara për vitin akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor - Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU - Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART WBU - Pyetësor për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Paketa e instrumentave të cilësisë - Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë	Universiteti Western Balkans ka krijuar mekanizma të efektshëm për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Ky proces udhëhiqet nga Komisioni i



periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Përshpreh për Garantimin e Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas rregullores së universitetit, këto struktura zhvillojnë vlerësime të rregullta mbi performancën akademike dhe metodologjitë mësimore, duke përdorur instrumente të ndryshme të matjes së cilësisë. Pas vlerësimeve, raportohen rezultatet dhe nxirren rekomandime që zbatohen nga strukturat akademike dhe ndihmëse brenda një kalendari vjetor. Ndryshimet në programet e studimit diskutohen dhe miratohen nga njësitë bazë akademike dhe nga Senati Akademik, i cili garanton cilësinë në përputhje me standardet shtetërore. Evidencat: - Statuti i WBU, Neni 3.1 - Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përshpreh për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përshpreh për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Vendimi për ngritjen e NJSBC - Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC - Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2023-2024 - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 111
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Universiteti “Western Balkans” i kushton rëndësi vlerësimit të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, ku përfshihen studentët aktualë, ata që diplomohen dhe të diplomuarit. Studentët plotësojnë pyetësorë në fund të çdo semestri për të vlerësuar pedagogët dhe përmbajtjen e lëndëve. Këto të dhëna përdoren nga organet drejtuese për të përmirësuar procesin mësimor. Studentët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesa për rezultatet e provimeve brenda një jave nga publikimi i tyre, duke e bërë këtë me shkrim pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Ankesa shqyrtohet nga një komision prej tre anëtarësh, ku pedagogët e lëndës nuk marrin pjesë. Vendimi i komisionit njoftohet brenda 15 ditëve. Evidencat: - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët - Raporti i vlerësimit të personelit akademik nga studentët 2023-2024 - Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans, Neni 46 - Rregullorja “Për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë”



Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Politika dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë në Universitetin “Western Balkans” janë transparente dhe të aksesueshme për publikun. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka një rubrikë të dedikuar në faqen zyrtare të universitetit (https://iqau.wbu.edu.al/sq/documents-2022-2023), ku publikohen raportet vjetore dhe rezultatet e vlerësimeve të mësimdhënies. Këto raporte përmbajnë edhe rekomandime për përmirësime, të cilat ndiqen nga strukturat e tjera të universitetit përmes planeve të veprimit. Universiteti organizon aktivitete periodike me personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët për të rritur ndërgjegjësimin dhe përkushtimin ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve. Njësitë bazë mbajnë të dhëna të rregullta mbi performancën akademike dhe kërkimin shkencor të stafit, duke përdorur formularë vetëvlerësimi. Evidencat: - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Rast i planit të masave të ndërmarra nga institucioni bazuar në raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC - Rast i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë - Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Universiteti “Western Balkans” ka politika të qarta për promovimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një dokument udhëzues, “Guida e stafit”, orienton veprimtarinë akademike brenda institucionit. Në bazë të performancës së lartë akademike dhe rregulloreve të brendshme, stafi ka të drejtë të përzgjidhet për promovim brenda njësive bazë dhe kryesore. Universiteti ofron mbështetje financiare për publikime dhe pjesëmarrje në aktivitete kërkimore, si dhe për projekte me financim kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar asistencë administrative dhe akademike gjatë procesit të aplikimit. Për lehtësimin e integritetit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, në fillim të çdo viti akademik organizohen ditë orientuese dhe trajnime, ku prezantohen struktura, detyrat dhe objektivat e universitetit. WBU gjithashtu mbështet personelin për avancimin e kualifikimeve, brenda dhe jashtë vendit, duke nxitë zhvillimin profesional dhe cilësinë e mësimdhënies. Evidencat: - Guida e Stafit

	- Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit - Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor - Praktikë e mbështetjes financiare të personelit në pjesëmarrje në konferenca - Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2023-2024 dhe planifikimi i ri vjetor - Praktikë e mbështetjes financiare të personelit për pjesëmarrje në konferenca - Model aplikimi për projekt (AKKSHI & QU-SURE)			
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ, duke zbatuar politika të qarta dhe transparente. Institucioni mbështet promovimin dhe kualifikimin e stafit përmes financimeve për kërkime, publikime dhe pjesëmarrje në trajnime. Aktivitetet orientuese dhe formimet periodike kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit, duke ndërtuar një mjedis akademik dinamik dhe inovativ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti "Western Balkans" ka si qëllim të sigurojë standarde të larta në mësimdhënie, kërkim dhe angazhim shoqëror. Për këtë arsye, është krijuar një sistem i brendshëm për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë. Brenda universitetit funksionon një komision i dedikuar që merret me zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë. Ky komision punon ngushtë me njësi të veçantë, që monitoron vazhdimisht performancën e stafit akademik dhe ndihmësakademik, si dhe përfshirjen e studentëve në këtë proces. Kjo njësi ka përbërje të përzier, që përfshin përfaqësues nga fakultetet, studentë dhe ekspertë të jashtëm, në mënyrë që të sigurohet një vlerësim sa më i drejtë dhe gjithëpërfshirës. Përmes këtij sistemi, universiteti bën përpjekje të

	vazhdueshme për të mbajtur dhe përmirësuar cilësinë në të gjitha aspektet e tij akademike dhe organizative. Evidencat: - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Emërimi i studentit në NJSBC - Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Vendimi për ngritjen e NJSBC - Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti “Western Balkans” synon të arrijë standarde të larta në mësimdhënie, kërkim dhe kontribut shoqëror, prandaj ka krijuar një sistem gjithëpërfshirës për sigurimin e cilësisë. Ky sistem bashkërendon aktivitetet e ndryshme për të vlerësuar dhe përmirësuar proceset akademike dhe programet e studimit. Në këtë proces përfshihen jo vetëm strukturat akademike dhe stafi, por edhe studentët, të cilët japin opinionet e tyre përmes pyetësorëve dhe marrin pjesë në diskutime dhe organe vendimmarrëse. Po ashtu, në punën e zhvillimit dhe rishikimit të programeve përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me njohuritë dhe përvojën e tyre. Pas çdo vlerësimi, hartohen raporte që bëhen publike, dhe mbi bazën e tyre organizohen aktivitete dhe masa konkrete për përmirësimin e cilësisë. Për më tepër, përfshirja e studentëve dhe strukturave të tyre në këtë proces është një mënyrë e drejtpërdrejtë dhe e vazhdueshme për të siguruar që cilësia e mësimdhënies dhe programeve të studimit të jetë gjithmonë në nivelet më të mira. Në fund, Senati Akademik mban përgjegjësi për garantimin dhe ndjekjen e të gjithë këtij procesi, duke u siguruar që universiteti të përmbushë standardet shtetërore të cilësisë. Evidencat: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja - Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët - Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 31 - Pjesëmarrja e studentëve në organet kolegjiale - Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC - Plani i aktiviteteve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2023-2024

	- Rast i një veprimtarie të organizuar për informim dhe ndërgjegjësim për sigurimin e cilësisë - Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Statuti i Universitetit Western Balkans, Neni 111
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti “Western Balkans” ka fokus të qartë në garantimin e cilësisë si pjesë kyçe të vizionit dhe misionit të tij, duke synuar të ndikojë pozitivisht në shoqëri përmes inovacionit dhe përgatitjes së profesionistëve të së ardhmes, si për tregun lokal, ashtu edhe atë rajonal dhe global. Në kuadër të kësaj përkushtimi, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka zhvilluar një paketë të instrumenteve të ndryshme për vlerësim, të cilat përdoren në mënyrë periodike për të monitoruar performancën në fusha të ndryshme, si mësimdhënia, kërkimi shkencor, burimet njerëzore, infrastruktura dhe aktivitetet shoqërore e kulturore. Pas çdo cikli vlerësimi, hartohen raporte me rezultatet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat bëhen publike dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e masave të nevojshme për përmirësim. Përmirësimi i programeve bazohet edhe në analiza të të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e studentëve dhe faktorë të tjerë relevantë, duke garantuar që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm. Sa i përket sigurimit të jashtëm të cilësisë, WBU përdor vlerësime të jashtme përmes akreditimeve dhe krahasimeve me standarde ndërkombëtare, duke qenë se institucioni është në fazat e para të zhvillimit të tij dhe proceset e vlerësimit nga studentët në prag të diplomimit dhe nga punëdhënësit do të përfshihen në vitet në vijim. Evidencat: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Lista e aktiviteteve trajnuese të realizuara sipas rekomandimeve të NJSBC - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët - Formulari i vlerësimit të programit nga studentët që diplomohen. <i>Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, f. 31</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën	Universiteti “Western Balkans” përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ndjek rregullisht performancën e stafit akademik dhe merr masa për përmirësim apo promovim, bazuar në një sistem të mirëstrukturuar vlerësimi. Ky sistem përfshin instrumente të ndryshme që synojnë të matin në mënyrë objektive punën në mësimdhënie dhe kërkim, pjesëmarrjen në aktivitetet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe elementë të tjerë të rëndësishëm. Vlerësimi realizohet nëpërmjet disa mënyrash: përmes pyetësorëve të studentëve, vlerësimit nga kolegët dhe nga

promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	drejtuesit e departamenteve, si dhe me procesin e vetëvlerësimit nga vetë personeli akademik. Të dhënat e mbledhura përdoren në analizën vjetore dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje në nivel departamenti dhe universiteti. Studentët kanë mundësinë të japin vlerësimet e tyre dy herë në vit, në mënyrë anonime dhe të sigurt, dhe rezultatet i bëhen të ditura stafit përkatës. Kjo ndihmon në pasqyrimin real të gjendjes dhe identifikimin e fushave ku mund të ketë nevojë për përmirësim. Bazuar në këta tregues, universiteti nxit dhe promovon personelin me performancë të shkëlqyer akademike, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në Rregulloren për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e stafit akademik. Për të mbështetur zhvillimin profesional, WBU ofron orientime të detajuara në fillim të çdo viti akademik për integrimin dhe informimin e stafit, si dhe mundësi për avancim kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit. Personeli gjithashtu mbështetet në aplikimet për projekte kërkimore me financim kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfituar nga asistencë administrative dhe materiale që lehtësojnë procesin. Evidencat: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët - Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik - Raporti i vlerësimit nga studentët për personelin akademik 2023-2024 - Rregullorja mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit - Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor - Lista e trajnimeve të zhvilluar për stafin gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe planifikimi i ri vjetor - Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca - Model aplikimi për projekt (AKKSHI& QU-SURE)			
Konkluzione	Universiteti “Western Balkans” ka ndërtuar një sistem të strukturuar për vlerësimin dhe zhvillimin e stafit akademik, i cili garanton transparencë dhe objektivitet përmes instrumenteve standarde dhe përfshirjes së studentëve, kolegëve dhe drejtuesve. Procesi lidhet ngushtë me promovimin dhe avancimin profesional, duke u mbështetur në rezultatet dhe përmbushjen e standardeve institucionale. Përmes trajnimeve, mbështetjes për projekte dhe mundësive për kualifikim brenda dhe jashtë vendit, institucioni forcon kapacitetet e stafit dhe promovon cilësi të lartë në mësimdhënie dhe kërkim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Universiteti “Western Balkans” ka ndërtuar një strukturë funksionale dhe të dokumentuar për shqyrtimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit të ciklit të dytë. Këto procese zbatojnë në mënyrë sistematike mekanizma vlerësimi të brendshëm, të cilët ndihmojnë në identifikimin e arritjeve, sfidave dhe potencialeve për përmirësim. Procesi përfshin ndërveprimin e njësive bazë dhe kryesore, Njësish të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Cilësisë si dhe strukturave të tjera akademike e administrative. Vlerësimet zhvillohen në mënyrë periodike dhe mbështeten në një paketë të plotë instrumentash që përfshijnë: vlerësimet semestrale të studentëve për stafin akademik, feedback-un e studentëve në prag diplomimi, opinionin e të diplomuarve, vlerësimin nga kolegët dhe përgjegjësit e departamenteve, si edhe vetëvlerësimin e personelit akademik. Këto instrumenta sigurojnë një panoramë të gjerë dhe të thelluar mbi performancën e programit, si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në atë organizativ e përmbajtësor. Rezultatet analizohen dhe raportohen në mënyrë të rregullt, duke u bërë të aksesueshme për strukturat vendimmarrëse të institucionit. Në rastet kur konstatohet nevoja për ndërhyrje përmirësuese, ndërmerren masa konkrete për përditësimin e përmbajtjes kurrikulare, metodave të mësimdhënies apo mbështetjes akademike për studentët. Evidencat: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Formulari i vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen - Formular për vlerësimin e personelit akademik nga kolegët - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e	Universiteti “Western Balkans” siguron mbikëqyrjen e vazhdueshme të cilësisë përmes raporteve të rregullta që përfshijnë objektivat e vendosura, rezultatet e arritura, praktikat e suksesshme dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje. Këto raporte përpilohen në bazë të një sërë instrumentesh vlerësimi



praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	që përfshijnë opinione nga studentët, kolegët, drejtuesit akademikë dhe vetë stafi. Të dhënat e mbledhura përdoren jo vetëm për të identifikuar dobësitë, por edhe për të vlerësuar dhe nxitur performancën e lartë, përmes mbështetjes në kërkim, promovimit në karrierë dhe përfitimit nga skema të dedikuara motivimi. Po ashtu, studentët me rezultate të larta inkurajohen përmes bursave në bashkëpunim me partnerët institucionalë. Rezultatet dhe masat e ndërmarra i raportohen strukturave drejtuese, duke garantuar që çdo vendimmarrje të mbështetet në evidencë dhe analiza konkrete. Evidencat: - <i>Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> - <i>Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik</i> - <i>Raporti i vlerësimit të personelit akademik nga studentët 2023-2024</i> - <i>Rregullorja mbi punësimin promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit</i> - <i>Udhëzimi mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor</i> - <i>Rregullorja e bursave mbi zbritjen e tarifës vjetore të Universitetit Western Balkans</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në funksion të mbikëqyrjes së cilësisë dhe funksionimit të përgjithshëm të programit të studimit, Universiteti “Western Balkans” aplikon një sërë metodash të drejtpërdrejta dhe të dokumentuara, të cilat janë pjesë integrale e paketës institucionale të instrumenteve të cilësisë. Këto metoda përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, përdorimin e teknikave të përshtatshme didaktike, vlerësimin e kurrikulës dhe të mësuarit, si dhe analiza të detyrave dhe provimeve të studentëve. Një ndër elementët kyç të këtij vlerësimi është pyetësori periodik që plotësohet nga studentët për performancën e stafit akademik, i cili përfshin komponentë të ndryshëm që lidhen me procesin mësimor dhe përvojën e tyre në auditor. Ky vlerësim zhvillohet dy herë gjatë vitit akademik dhe, që prej vitit 2023–2024, realizohet në mënyrë të strukturuar dhe anonime përmes platformës SMART WBU. Të dhënat e grumbulluara përpunohen dhe paraqiten në raportin përkatës, i cili i komunikohet stafit për të reflektuar mbi aspektet pozitive dhe ato që kërkojnë përmirësim. Secilit pedagog i vihet në dispozicion një raport individual, në mënyrë konfidenciale, pas përfundimit të sezonit të provimeve, duke respektuar standardet e transparencës dhe etikës akademike. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për marrjen e masave për përmirësim, si dhe për nxitjen e praktikave të suksesshme në mësimdhënie dhe mësimnxënie.



	Evidencat: - <i>Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> - <i>Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Për të siguruar një vlerësim sa më të plotë dhe objektiv të programit të studimit, Universiteti “Western Balkans” mbështetet jo vetëm në instrumentet e drejtpërdrejta, por edhe në një sërë metodash të tërthorta vlerësimi. Këto përfshijnë sondazhe dhe intervista me studentë në prag diplomimi, të diplomuar (alumni), personel akademik e administrativ, si dhe me përfaqësues të institucioneve dhe punëdhënësve që bashkëpunojnë në zbatimin e programit. Studentët e programit “Bachelor” në Inxhinieri Biomjekësore, në përfundim të ciklit të studimeve, plotësojnë pyetësorë të strukturuar për të dhënë mendimin e tyre mbi përmbajtjen, cilësinë dhe dobishmërinë e programit. Po ashtu, është parashikuar që alumni të japin feedback tre vjet pas diplomimit, duke reflektuar mbi përputhshmërinë e përgatitjes akademike me kërkesat e tregut të punës. Megjithëse ky program është ende në vitin e tretë të zbatimit, vlerësimi i plotë i tij nga alumni dhe partnerët e jashtëm do të pasojë në ciklin e ardhshëm, sipas parashikimeve të politikave të brendshme të cilësisë. Vlerësimet e mbledhura analizohen në takime të hapura të departamentit dhe fakultetit, ku diskutohen propozime për përmirësim, të cilat më pas shqyrtohen për miratim nga strukturat përkatëse drejtuese të universitetit. Çdo rishikim i kurrikulës dokumentohet në mënyrë të rregullt dhe në dy gjuhë, duke siguruar transparencë dhe standardizim. Evidencat: - <i>Formulari i vlerësimit të programit të studimit nga studentët që diplomohen</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti “Western Balkans” ka krijuar një sistem gjithëpërfshirës për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke mbledhur të dhëna nga studentët, alumni, stafi dhe partnerët e industrisë. Sistemi siguron monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të programeve përmes analizave të dokumentuara dhe diskutimeve brenda strukturave akademike. Masat e ndërmarra pasqyrojnë angazhimin për përshtatjen e programeve me nevojat e tregut dhe ofrimin e arsimit cilësor e të qëndrueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti "Western Balkans" ka përcaktuar qartë, në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në këtë kuadër, janë ngritur struktura të posaçme si Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me njësitë akademike dhe administrative të institucionit. Në përbërje të këtyre strukturave marrin pjesë jo vetëm përfaqësues të personelit akademik, por edhe studentë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët japin kontributin e tyre në analizën dhe zhvillimin cilësor të programeve. Këto aktorë përfshihen në mënyrë të strukturuar në vlerësimet periodike dhe në hartimin e planeve të përmirësimit. Raportet që gjeneron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të publikuara dhe të aksesueshme për publikun e brendshëm, duke mundësuar transparencë dhe përfshirje në vendimmarrje. Ato diskutohen rregullisht në takimet e departamenteve dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e veprimeve për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Evidencat: - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Universiteti "Western Balkans" ka të përcaktuara qartë politikat, strukturat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e tij të brendshme. Çdo strukturë dhe aktor i përfshirë, nga personeli akademik dhe administrativ deri te studentët dhe partnerët e jashtëm, ka përgjegjësi të qarta dhe detyra konkrete për garantimin e cilësisë në programet e studimit.

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Ky komision bashkëpunon ngushtë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka rol zbatues dhe monitorues. NJSBC kryen vlerësime periodike për performancën akademike, vlerësimin e studentëve dhe të stafit, si dhe identifikon nevojat për përmirësim, duke përdorur instrumentet e përcaktuara në paketën e cilësisë. Kjo njësi përbëhet nga përfaqësues të fakulteteve, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm, të cilët garantojnë një përfshirje gjithëpërfshirëse dhe profesionale në proceset e sigurimit të cilësisë. Evidencat: - Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Vendimi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit - Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, Universiteti “Western Balkans” përfshin të gjitha njësitë akademike dhe përfaqësuesit e studentëve, sipas politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë. Përfshirja garanton njësinë bazë, Departamentin e Shkencave Ekonomike dhe Financës, si dhe Fakultetin e Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, si përgjegjës kryesor për programet e studimit. Në këtë proces marrin pjesë personeli akademik, ndihmësakademik, administrativ, si dhe studentët në të gjitha programet respektive. Personeli akademik dhe ndihmësakademik vetëvlerësohet dhe vlerësohet nga studentët, kolegët dhe përgjegjësi i departamentit. Më tej, përgjegjësi i departamentit vlerësohet nga personeli dhe Dekani, ndërsa Dekani vlerësohet nga Senati Akademik. Kjo strukturë siguron përfshirje të gjerë dhe një proces të gjithanshëm vlerësimi dhe sigurimi cilësie. Departamenti përmbush standardet e cilësisë në hartimin dhe implementimin e programeve, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm për kurrikulën dhe literaturën. Përfaqësuesi i studentëve merr pjesë në mbledhjet e njësisë për të



	transmetuar opinionet e studentëve dhe për të kontribuar në përmirësimin e programeve. Gjithashtu, në kuadër të planit vjetor të NJSBC, monitorohet cilësia e shërbimeve dhe infrastrukturës përmes pyetësorëve të vlerësimit nga personeli akademik, administrativ dhe studentët. Rezultatet përpunohen në raporte vjetore me rekomandime përkatëse. Evidencat: - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik - Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja - Praktikë mbledhjeje me pjesëmarrës përfaqësuesin e klasës (Senatorin) e programit të studimit në Njësinë Bazë - Raporti i vlerësimit të institucionit nga personeli për vitin akademik 2022-2023 / 2023-2024 - Paketa e Instrumentave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit përfshihen njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programet, personeli akademik, ndihmës-akademik, administrativ, si dhe studentët në të gjitha programet përkatëse. Përfaqësuesit nga secila njësi kryesore, studentët dhe ekspertët e jashtëm janë pjesë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), duke garantuar përfaqësimin e interesave dhe përfshirjen gjithëpërfshirëse. Në kuadër të instrumenteve të cilësisë, personeli akademik dhe ndihmësakademik vetëvlerësohet dhe vlerësohet nga studentët, kolegët dhe përgjegjësit e departamenteve. Përgjegjësi i departamentit vlerësohet nga personeli akademik dhe Dekani, ndërsa Dekani vlerësohet nga Senati Akademik, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Departamentet raportojnë periodikisht mbi cilësinë e mësimdhënies, kurrikulës dhe performancës së studentëve në njësinë kryesore, e cila më pas paraqet një raport vjetor për organet kompetente dhe shqyrton propozimet për programe të reja. Gjatë gjithë proceseve ciklike të vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo formë diskriminimi apo pabarazie. Kjo arrihet përmes pyetësorëve anonimë, përpunimit rigoroz të të dhënave dhe shpërndarjes individuale dhe të sigurt të rezultateve. Evidencat: - Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik - Raporti i punës kërkimore-shkencore i Departamentit të Teknologjisë dhe Biznesit (Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Inxhinierisë) për vitin akademik 2023-2024

	- Raporti i punës kërkimore-shkencore i Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Biznesit (FETI) vitin akademik 2023-2024 - Propozim për hapje të programeve të reja - Raporti i vlerësimit të personelit akademik nga studentët 2023-2024
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përfshin përfaqësues nga njësiti kryesore të institucionit, përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm, duke garantuar përfaqësimin gjithëpërfshirës të grupeve të interesit dhe vlerësuesve me kompetenca të specializuara. Ekspertët e jashtëm, me përvojë të konsiderueshme, kontribuojnë me mendime dhe ekspertizë të vlefshme për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Përveç anëtarësimit në NJSBC, institucioni kontraktton dhe angazhon bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm të tjerë, të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejta me programin e studimit dhe mund të ofrojnë kontribut profesional në hartimin dhe përditësimin e kurrikulave, shqyrtimin e literaturës dhe propozimet për zhvillimin e programeve të reja. Kjo përfshirje e ekspertëve të jashtëm siguron që programet e studimit i përgjigjen standardeve të cilësisë dhe vazhdimisht përmirësohen në përputhje me kërkesat akademike dhe të tregut. Evidencat: - Angazhimi i ekspertit të jashtëm në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë - Propozim për hapje të programeve të reja - Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në hartimin e programeve të reja
Konkluzione	Në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë, Universiteti "Western Balkans" ka ngritur një strukturë funksionale dhe gjithëpërfshirëse që përfshin njësiti akademike, studentët dhe ekspertë të jashtëm. Përmes Komisionit të Përhershëm dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatohen politika dhe procedura të qarta për vlerësimin e programeve. Procesi është transparent, anonim dhe i mbështetur në instrumente të besueshme. Bashkëpunimi me ekspertë të fushës ndihmon në përshtatjen e programeve me nevojat e tregut dhe standardet ndërkombëtare, ndërsa raportimi periodik nxit përmirësimin e vazhdueshëm dhe përgjegjshmërinë institucionale.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria e Universitetit "Western Balkans" (WBU) udhëhiqet nga Plan i Strategjik i Zhvillimit 2023-2030, i cili është në përputhje me misionin e institucionit dhe synon ngritjen e WBU-së si një institucion i gjeneratës së katërt, lider në Shqipëri, rajon dhe më gjerë në fushat e tij të fokusimit. Institucioni garanton transparencë në veprimtarinë e tij për personelin, studentët dhe palët e interesuara, duke zbatuar politika dhe procedura të qarta dhe të hapura për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Politikat dhe procedurat janë hartuar nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, si dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat monitorojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht programet e studimit. Raportet e prodhuara nga këto strukturë publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të WBU-së. Pas përpunimit të të dhënave, strukturat drejtuese akademike dhe administrative japin rekomandime konkrete që ndiqen dhe zbatohen nga njësitë akademike, ndihmës-akademike dhe administrative për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Evidencat: - Strategjia e zhvillimit të WBU për periudhën 2023-2030 - Raporti i vlerësimit të personelit akademik nga studentët 2023-2024

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	“WBU”, publikon rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit duke respektuar plotësisht lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezultatet përfshihen në raporte të përgatitura nga strukturat përkatëse, të cilat u bëhen me dije personelit akademik dhe janë të aksesueshme për palët e interesuara, duke garantuar transparencë në proces. Vlerësimet individuale për anëtarët e stafit akademik komunikohen në mënyrë konfidenciale dhe private, në mënyrë që të shmangen çdo lloj keqpërdorimi apo keqpërdorimi të të dhënave. Kjo praktikë siguron një balancë të duhur midis transparencës së procesit dhe respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të personelit. Evidencat: - Kodi i Etikës për Stafin Akademik dhe Administrativ WBU - Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Universiteti “Western Balkans” i kushton vëmendje të veçantë përdorimit të rezultateve të vlerësimeve si bazë për veprime konkrete për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në këtë kuadër, pas çdo rishikimi, institucionet përgjegjëse identifikojnë dobësitë dhe sfidat që dalin nga procesi i vlerësimit dhe zhvillojnë një plan veprimi të qartë, me masa të synuara për tejkalimin e tyre. Përmirësimi i vazhdueshëm konsiderohet si pjesë e pandashme e kulturës akademike, ndaj universiteti organizon aktivitete të ndryshme trajnime dhe zhvillimi profesional për stafin akademik dhe ndihmës akademik, duke promovuar përdorimin e metodave bashkëkohore dhe teknologjive të reja në mësimdhënie dhe kërkim. Ky proces planifikohet dhe përshtatet sipas nevojave të identifikuara gjatë vitit akademik, duke siguruar që personeli të jetë gjithmonë i përgatitur për të përmbushur kërkesat dhe standardet më të larta. Në këtë mënyrë, Universiteti garanton jo vetëm monitorimin, por edhe zhvillimin dhe avancimin sistematik të cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron. Evidencat: - Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2023-2024 - Trajnime të organizuara online mbi përdorimin e SMART WBU - Udhëzues i sistemit të menaxhimit të informacionit SMART WBU - Pyetësor për vlerësimin e nevojave për trajnime nga personeli akademik dhe administrativ. Paketa e instrumenteve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.



Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni përkushtohet që të monitorojë dhe të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive që lidhen me cilësinë e programeve të studimit. Për këtë qëllim, në fillim të çdo viti akademik organizohen aktivitete orientuese që synojnë njohjen e strukturës organizative dhe roleve të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto aktivitete ndihmojnë në përmirësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet njësive të ndryshme dhe kontribuojnë në një menaxhim më të mirë të proceseve të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, ato ofrojnë mundësinë për të reflektuar mbi rezultatet e vlerësimeve të mëparshme dhe për të përcaktuar hapat e nevojshëm për përmirësim në programet e studimit. Evidencat: - Paketa e trajnimeve të organizuara për kurrikulën dhe mësimdhënien
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti "Western Balkans" organizon rregullisht aktivitete me personelin dhe studentët për të informuar dhe ndërgjegjësuar mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. Në fillim të çdo viti akademik mbledhen nevojat për trajnime të stafit dhe hartohet plani i zhvillimit profesional, duke angazhuar ekspertë vendas dhe të huaj. Përmes takimeve dhe forumeve të hapura inkurajohet dialogu dhe shkëmbimi i ideve midis stafit dhe ekspertëve. Universiteti mbështet avancimin profesional të personelit dhe promovon pjesëmarrjen në aktivitete kulturore dhe sociale që forcojnë komunitetin universitar. Studentët janë të përfshirë aktivisht në proceset e sigurimit të cilësisë dhe në jetën akademike e kulturore të institucionit. Evidencat: - Takimet e zhvilluara me maturantë në WBU - Promovimi i Universitetit "Western Balkans" në panairin e organizuar nga MAS - Organizimi i Samitit të Inovacionit të Ballkanit Perëndimor - Kalendar i mbledhjeve i organeve kolegjiale - Lista e plotë dhe raporti i trajnimeve 2023-2024 - Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca
Konkluzione	Universiteti "Western Balkans" angazhohet në mënyrë të qëndrueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në përputhje me Planin Strategjik 2023-2030 dhe standardet



	akademike. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës dhe transparent, me përfshirjen e stafit, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm. Përmes trajnimeve, orientimeve dhe bashkëpunimit me aktorë vendas e ndërkombëtarë, institucioni forcon kapacitetet profesionale dhe promovon një kulturë cilësie. Kjo qasje konsistente kontribuon në përmirësimin e mësimdhënies, kërkimit dhe imazhit institucional të WBU-së.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Biomjekësore”

a. Pikat e forta:

- Karakteri unik dhe ndërkombëtar i programit.** Programi i studimit është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe ndër të paktët në rajon, duke ofruar një perspektivë të qartë zhvillimi në fushën e inxhinierisë biomjekësore. Ai zhvillohet tërësisht në gjuhën angleze, çka mundëson përfshirjen e studentëve ndërkombëtarë dhe rrit ndjeshëm dimensionin global të formimit akademik;
- Qasja ndërdisiplinore dhe formimi i integruar.** Struktura e programit përfshin një ndërthurje të harmonizuar midis shkencave inxhinierike, biologjisë dhe teknologjisë, duke ofruar një bazë të fortë teorike dhe praktike. Kjo qasje e integruar i pajis studentët me njohuri të avancuara në fushat ndërdisiplinore të shëndetësisë dhe inxhinierisë;
- Fokus në përgatitjen praktike dhe orientimin drejt industries.** Programi përfshin module të fokusuara në zhvillimin e aftësive praktike dhe të transferueshme për sektorin industrial. Studentët angazhohen në laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore dhe në projekte të lidhura drejtpërdrejt me nevojat e tregut;
- Integrimi me tregun e punës dhe zhvillimi i karrierës.** Përmes partneriteteve me kompani dhe industri në fushën e pajisjeve mjekësore, rehabilitimit dhe diagnostikimit, studentët marrin pjesë në praktika profesionale dhe projekte të aplikueshme që rrisin ndjeshëm punësueshmërinë e tyre. Programi siguron një përgatitje të shkëlqyer për tregun e punës në Shqipëri dhe jashtë saj, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë, teknologjisë mjekësore dhe kërkimit shkencor;

b. Pikat e dobëta;

- 1.** Konstatohet në shumicën e rasteve të titullarëve të lëndëve me gradë shkencore “Doktor”;
(*Standarti IV.1, kriteri 1*)


Rekomandime

- 1.** Titullarët e angazhuar në hartimin e syllabuseve të lëndëve mësimore duhet t’i përkasin kategorisë “Profesor,” në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, me qëllim që të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe në përmbushjen e detyrimeve ligjore për një kornizë akademike cilësore në programin e studimit;

Evaluation Conclusions for the First Cycle Study Program “Bachelor” in “Biomedical Engineering”

a. Strengths:

- 1. Unique and International Character of the Program.** This study program is the only one of its kind in Albania and among the few in the region, offering a clear development perspective in the field of biomedical engineering. The program is delivered entirely in English, enabling participation from international students and significantly enhancing the global dimension of academic training;
- 2. Interdisciplinary Approach and Integrated Education.** The program structure features a well-balanced integration of engineering sciences, biology, and technology, offering students a solid theoretical and practical foundation. This interdisciplinary approach equips students with advanced knowledge in the intersecting fields of health sciences and engineering;
- 3. Emphasis on Practical Preparation and Industry Orientation.** The curriculum includes modules focused on the development of practical and transferable skills relevant to the industrial sector. Students engage in laboratories equipped with contemporary technology and participate in projects directly aligned with market needs;
- 4. Integration with the Labor Market and Career Development.** Through partnerships with companies and industries operating in the fields of medical devices, rehabilitation, and diagnostics, students undertake professional internships and applied projects that significantly increase their employability. The program ensures excellent preparation for the labor market in Albania and beyond, particularly in healthcare, medical technology, and scientific research sectors;



b. Weaknesses:

1. It is observed in most cases that the heads of courses have the scientific degree "Doctor";
(*Standard IV.1, criterion 1*)

Recommendations

Heads of departments engaged in the drafting of course syllabi must belong to the category "Professor," in accordance with Law 80/2015 on Higher Education, in order to help ensure the high quality of teaching and fulfill legal obligations for a qualitative academic framework in the study program;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

